

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

EDUKATA NË MIQËSI
Imam Gazali

Prishtinë 2016

Titulli i origjinalit
Ihjaw Ulumid-din
(Ringjallja e diturive fetare)

Kitâbu âdâbi'l-ulfet
Imam Gazali

Përgatiti dhe përktheu
Is-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

Lektor:
Artan Sadiku

Përgatitja kompjuterike:
İlhan Bölükbaşı

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	5
VLERA E MIQËSISË DHE VËLLAZËRISË, KUSHTET E TYRE, GRADAT DHE DOBITË.....	7
VLERA E LARTË E MIQËSISË DHE VËLLAZËRISË	7
URREJTJA PËR RIZANË E ALLAHUT	35
CILËSITË E NEVOJSHME TE PERSONI ME TË CILIN DËSHIRON TË SHOQËROHESH	47
MBI RREGULLAT E VËLLAZËRISË DHE SHOQËRIMIT	57
E DREJTA E PARË	57
E DREJTA E TRETË.....	67
E DREJTA E KATËRT	80
E DREJTA E PESTË	89
E DREJTA E GJASHTË	98
PËRFUNDIMI I KAPITULLIT TË DYTË.....	116
... e mposhtin zemërimin (3-Al 'Imran: 134)	199
Mejmuni tha:	199
- E mposhta zemërimin. Shërbëtorja përsëri citoi:.....	199

Me emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!

PARATHËNIE

Falënderimi (hamd) i takon vetëm Allahut i Cili u dhuroi robërve të Tij hijeshi të posaçme gjithandej, e ata të mos e kenë merituar, i Cili u afroi zemrat ashtu që, duke iu falënderuar bereqeteve të Tij, u bënë vëllezër. Ua largoi nga gjokset e tyre të ligën, andaj janë në këtë botë shokë dhe vëllezër, e në botën tjetër bashkudhëtarë dhe të afërt.

I dërgojmë selame Muhammedit s.a.v.s. - të zgjedhurit të Allahut Teala, familjes së tij, dhe shokëve të tij që i shkuan pas dhe e morën për shembull në të folur, në vepra, në drejtësi dhe në ibadete.

Pas kësaj dije se: dashuria ndaj tjetrit për rizanë e Allahut dhe vëllazëria në rrugë të fesë janë ndër vlerat më të larta në afrim Allahut, dhe janë prej ibadeteve më të bukura. Por, kjo ka disa kushte. Shokë llogariten ata që duhen për Allahun duke respektuar këto kushte. Gjithashtu, ka disa të drejta të cilat duhet respektuar nga të dyja palët, në mënyrë që të arrihet vëllazëria. Vetëm me respektimin e këtyre kushteve njeriu gjithnjë e më shumë i afrohet Allahut dhe, duke ruajtur këto kushte - arrin grada të larta.

Thelbin e këtij libri do ta sqarojmë përmes tre kapitujve:

1) Vlera e miqësisë dhe vëllazërisë, kushtet e tyre, gradat dhe dobitë;

2) Rregullat e vëllazërisë dhe shoqërimit;

3) Obligimet karshi myslimanit, të afërmve, fqinjëve dhe udhëheqësit, si dhe mënyra e komunikimit me njerëzit.

Kapitulli i Parë

VLERA E MIQËSISË DHE VËLLAZËRISË, KUSHTET E TYRE, GRADAT DHE DOBITË

VLERA E LARTË E MIQËSISË DHE VËLLAZËRISË

Dije se miqësia është fryt i ahlakut të bukur, ndërsa ndarja është përfundim i vesit të keq. Ahlaku i mirë kërkon dashuri, afërsi dhe pajtueshmëri të ndërsjellë. Edukimi i keq, në anën tjetër, sjell urrejtje, zili dhe mospajtim të ndërsjellë. Përderisa ajo që e jep frytin është e dobishme, edhe vet fryti është i dobishëm. Në fe është mirë e njohur vlera e ahlakut (moralit të mirë). Pikërisht me ahlak të bukur, Allahu Teala e lavdëron Muhammedin a.s., duke i thënë:

“Vërtetë, ti je në një shkallë të lartë të ahlakut (moralit).” 68-Kalem: 4

Ndërsa Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Devotshmëria dhe ahlaku i bukur më së shumti do t’i ndihmojë njerëzit për të hyrë në Xhenet.”¹

Usame bin Shurejk r.a., ka pyetur:

- *Na thuaj, o i Dërguari i Allahut, çka është ajo më e mira që i është dhënë njeriut, e Resulallahu s.a.v.s. u përgjigj:*

- **Ahlaku i bukur.**²

¹ Tirmidhiu dhe Hakimi nga Ebu Hurejre r.a.

² Hadith sahih, shënuar nga Ibn Maxhe.

Resulallahu thotë:

“Jam dërguar që të plotësoj bukuritë e ahlakut.”³

Gjithashtu thotë:

“Ajo që do të peshojë më së shumti (në ditën e Gjykimit) do të jetë ahlaku i bukur”⁴,

e në një hadith tjetër thotë:

“Allahu nuk do t’i japë njeriut pamje dhe ahlak të bukur, e më pas me të ta ushqejë zjarrin.”⁵

Resulallahu s.a.v.s. i ka thënë Ebu Hurejres:

- **O Ebu Hurejre, mundohu të jesh me ahlak të bukur, në çka Ebu Hurejrer.a., e pyeti:**

- *E, çka është ahlaku i bukur o Resul i Allahut?* e

Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- **Mbaje lidhjen me personin që ka këputur lidhjen me ty, falja atij që ka ushtruar dhunë mbi ty, dhe jepi atij që nuk të ka dhënë ty.**⁶

Padyshim përfundimi i ahlakut të bukur është miqësia dhe shoqëria. Nuk është fshehtësi që fryt i sjelljes së mirë është afërsia, kurse fryt i ndërprerjes së lidhjes – vetmia. Kur pema është e bukur, edhe fryti i saj është i bukur. E si mos të jetë kështu kur miqësia dhe afërsia, e veçanërisht miqësitë e krijuara me dashurinë e Allahut, të lidhura në fe dhe devotshmëri – lavdërohen shumë në ajete, hadithe dhe nga dijetarët e mëdhenjë të Islamit.

³ Ahmedi, Bejhekiu dhe Hakimi nga Ebu Hurejre r.a.

⁴ Ebu Davudi dhe Tirmidhiu nga Ebu Derda r.a. Tirmidhiu thotë që është sahih.

⁵ Hadithin e shënon Ibn Adijj, Taberani në veprën *‘Mekarimi-Ahlak’* dhe *‘Evsat’*, si dhe Bejheki në veprën *‘Shuabu’l- Iman’*, nga Ebu Hurejre r.a..

⁶ Bejheki në veprën *‘Shuabu’l- Iman’*, nga Hasani.

AJETET NË KËTË ÇËSHTJE

Allahu Teala e thekson dhuratën e Tij dhënë njerëzve duke treguar vlerën e afërsisë:

“Sikur të shpenzoje tërë pasurinë që gjendet në Tokë, nuk do të mund t’i bashkoje zemrat e tyre, por Allahu i bashkoi ato.” 8-Enfal: 63

“...Në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër.”

3-Ali Imran: 103

Allahu Teala e ndalon përçarjen, andaj urdhëron:

“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë.” 3-Al’Imran: 103

HADITHET

Muhammedi s.a.v.s. ka thënë:

“Prej jush, më së afërmi meje do të jetë ai me ahlakun më të mirë, i butë, që bashkon dhe shoqërohet.”⁷, dhe:

“Besimtari është i afërt me të tjerët, dhe të tjerët janë të afërt me të. Nuk ka dobi në atë që nuk bashkon dhe nuk shoqërohet.”⁸

⁷ Taberani në *‘Mekarim-i Ahlak’*, në transmetim të Xhabirit r.a..

⁸ Ahmedi dhe Taberani nga Sehla ibn Sa’di r.a., dhe Hakimi nga Ebu Hurejre r.a. dhe thotë se hadithi është sahih.

Duke lavdëruar vëllazërinë në fe, Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Atij që Allahu ia do të mirën, i jep shok të mirë e të devotshëm, nëse harron diçka - shoku do t’ia përkujtojë, e nëse kujtohet - do t’i ndihmojë.”⁹

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Dy vëllezër që duhen për Allahun, kur takohen janë si dy duar që pastrojnë njëra-tjetrën. Kur takohen dy besimtarë, Allahu Teala përmes njërës i sjell dobi tjetrit.”¹⁰

Duke inkurajuar në vëllazëri, Resulallahu thotë:

“Atë që, për Allahun e pranon një person si vëlla, Allahu do ta lartësojë në Xhenet në gradë të tillë që nuk do ta arrinte me asnjë vepër.”¹¹

Ebu Idris el-Havelani i tha Muadh b. Xhebel’it r.a:

- *Të dua për Allahun, në çka Muadhi iu përgjigj:*

- *Gëzohu, përsëri po të them, gëzohu! Kam dëgjuar*

Resulallahun s.a.v.s. të thotë:

- **Në Ditën e Gjykimit disa njerëzve do t’u vendosen ulëse përreth Arshit. Fytyrat do t’i kenë të ndriçuara si Hëna e plotë. Derisa njerëzit të jenë në tmerr, ata nuk do të tmerrohen, derisa njerëzit të jenë të frikësuar, ata nuk do të frikësohen. Ata janë vërtet miq të Allahut (Evlija); ata që as do të frikësohen e as do të pikëllohen’, në çka dikush pyeti:**

- *Kush janë ata njerëz, O Resulallah?, e Muhammedi*

s.a.v.s. u përgjigj:

- **Janë ata që duhen mes vete për Allahun.”¹²**

⁹ Ebu Davud nga Aishe r.a. dhe është i njohur verzioni ku flitet për udhëheqësin (emirin).

¹⁰ Sulemi në veprën *‘Adabu’s-Sohbe’*, dhe Ebu Mansur Dejlami në *‘Musnedi Firdevs’*, nga Enesi r.a..

¹¹ Ibn Ebi’ d Dunja në librin *‘Kitabu’l-Ihvan’*, nga Enesi r.a..

Me një hadith tjetër, Resulallahu s.a.v.s. thotë:

- **Rreth Arshit ekzistojnë ulëse nga drita. Në to janë njerëz me rroba nga drita, me fytyra nga drita, nuk janë as peygamberë as shehidë, e ua kanë lakminë edhe peygamberët edhe shehidët.**

- *Kur u pyet se kush janë ata, Resulallahu s.a.v.s tha:*

- **Ata janë që duhen për Allahun, që rrinë me njëri-tjetrin për Allahun, dhe që vizitojnë njëri-tjetrin për Allahun.**¹³

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Nga dy persona që duhen për Allahun, tek Allahu më i dashuri është ai që do më shumë tjetrin.”¹⁴

Është thënë që nëse dy shokë duhen për Allahun dhe grada e njërit është më e lartë edhe shoku ngritët në gradën e tij – si fëmijët kur shoqërohen nga prindërit - sepse, kur vëllazëria bëhet për Allahun, nuk është më pak e vlefshme se sa vëllazëria nga gjaku. Prandaj në ajet është thënë:

“E ata që vetë besuan, e edhe pasardhësit e tyre ishin me besim, Ne atyre do t’ua shoqërojmë pasardhësit e tyre dhe asgjë nuk u pakësojmë nga veprat e tyre (prindërve).”

52-et-Tur: 21

Resulallahu s.a.v.s. na tregon:

“Allahu Teala thotë: ‘Dashurinë Time e meritojnë ata që vizitojnë njëri-tjetrin për Mua. Dashuria Ime u takon atyre që duhen për Mua. Dashuria Ime është për ata që i dhurojnë njëri-tjetrit për Mua. Dhe Dashurinë Time e kanë fituar ata që ndihmohen mes vete për Mua’.”¹⁵

¹² Hadith sahih sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit, shënuar nga Ahmedi dhe Hakimi, transmetuar nga Ebu Hurejre r.a.

¹³ Nesai në veprën e tij *‘Suneni-Kubra’*, nga Ebu Hurejre r.a..

¹⁴ Ibn Hibban dhe Hakimi, transmetuar nga. Enesi r.a..

¹⁵ Ahmedi nga Amr b. Unejs r.a., dhe Ubade b. es-Samit r.a. edhe Hakimi në veprën e tij *‘Mustedrek’*.

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Vërtet në Ditën e Gjykimit Allahu Teala do të thotë: Ku janë ata që për Madhështinë Time e donin njëri-tjetrin? Sot, kur nuk gjendet asnjë hije, Unë ata do t’i strehoj në hijen e rahmetit Tim.”¹⁶

Gjithashtu, Resulallahu s.a.v.s. shpjegon:

“Shtatë lloj njerëzish do t’i marr Allahu nën hijen e Arshit, në ditën kur nuk do të ketë hije tjetër:

- udhëheqësin e drejtë,
- të riun që e kaloi rininë në ibadet,
- atë që e ka zemrën e lidhur për xhami: kur del nga ajo – asaj i kthehet,
- dy persona që mes vete duhen për Allahun – e kështu takohen dhe ndahen,
- personin i cili në vetmi përmend Allahun (bën dhikër) dhe fillon të qajë,
- personin të cilin e thërret gruaja e pasur dhe e bukur për ziná, e ai i thotë: ‘i frikësohem Allahut!’, dhe
- personin i cili jep sadaká me nder, dhe këtë e fsheh, dhe atë në atë mënyrë që dora e majtë nuk di çka jep dora e djathtë.”¹⁷

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Nuk do të ndodh që një person të niset në vizitë tjetrit për rizanë e Allahut, i përmalluar, duke pritur me padurim për ta parë, e të mos e thërras meleku nga mbrapa duke i thënë: ‘Qofsh i lumtur, të qoftë rrugë e mbarë, dhe të urojmë Xhenetin!”¹⁸

¹⁶ E shënon Muslimi.

¹⁷ Buhariu edhe Muslimi, nga Ebu Hurejre r.a..

¹⁸ Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe nga Ebu Hurejre r.a , e shënon edhe Ibn Adijj nga Enesi r.a..

Resulallahu s.a.v.s tregon:

- Ai që viziton një vëlla mysliman për rizanë e Allahut, në rrugën e tij Allahu vendos një melek. Meleku pyet njeriun:

- *Ku shkon?* Njeriu thotë:

- *Në atë vend është një vëlla imi mysliman, do ta vizitoj.*

Meleku i thotë:

- *Ti je duke shkuar te ai sepse është i afërmi yt. Njeriu mohon. Meleku i thotë:*

- *Ai të ka ndihmuar ty, dhe ti je duke shkuar për falënderim. Njeriu thotë:*

- *Jo. Unë atë e dua vetëm për rizanë e Allahut, dhe për këtë do ta vizitoj. Meleku i thotë:*

- *Unë të jam dërguar ty prej Allahut. Unë erdha të të jap lajmin se ashtu si e do ti atë njeri, ashtu edhe Allahu ty të do.”¹⁹*

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Lidhja më e fortë e besimit është që njeriu edhe të dojë edhe të urrejë për Allahun.”²⁰

Nga kjo del përfundimi që njeriu duhet të ketë miq dhe vëllezër të cilët i do për Allahun, por edhe armiq të cilët i urren, njëjtë për Allahun. Transmetohet se Allahu Teala i shpalli njërit prej Pejgamberëve të tij:

“*Me ngurrimin tënd ndaj kësaj bote ke shpejtuar rehatinë tënde, e me izolimin tënd për Mua, je bërë i ndershëm te Unë. A je miqësuar me dikë për Mua? A je armiqësuar me dikë për Mua?*”

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Allahu im, mos bëj që keqbërësi të më bëjë ndonjë të mirë, e që unë ta dua.”²¹

¹⁹ Muslimi nga Ebu Hureje r.a.

²⁰ Ahmedi nga Bera ibn Azib r.a.. E shënon edhe Haraiti në veprën ‘*Mekarimui-Ahlak*’. nga ibn Mesud r.a.

Transmetohet se Allahu Teala i shpalli Isasë a.s.:

“Po të më bësh ibadet sa të gjithë banorët e qiejve dhe tokës, e të mos urresh për Mua, kurrfarë dobie nuk do të kesh.”

Isa alejhisselam ka thënë:

- *Përfitoni dashurinë e Allahut duke përbuzur gjynahet, afrojuni Allahut duke u larguar nga to, kërkoni kënaqësinë (rizanë) e Allahut përmes zemërimit ndaj tyre. Kur u pyet se me kë të jemi, Isa a.s. u përgjigj:*

- *Të jeni me atë që, kur e shihni ju bën të kujtoni Allahun, fjalët e tij ju shtojnë ibadetet, dhe ju inkurajojnë në veprime për botën tjetër.*

Nga gjeneratat e mëparshme përcillet që Allahu Teala i shpalli Musait alejhisselam:

“O biri i Imranit – Musa, rri zgjuar dhe kërkë mik! E cilido mik që nuk të inkurajon në dashurinë Time, ai të është armik.”

Allahu Teala i shpalli Davudit alejhisselam.:

- **O Davud, pse të shoh të vetmuar, të tërhequr nga njerëzit?** Davudi a.s. u përgjigj:

- *Rabbi im, për rizanë Tënde u largova nga njerëzit. Në këtë, Allahu Teala i tha:*

- **O Davud, rri i zgjuar! Kërkë shokët, e me atë që nuk më do Mua dhe nuk të përshtatet ty, mos u shoqëro. Sepse i tilli është armiku yt, ta ngurtëson zemrën dhe të largon nga Unë.**

Transmetohet për Davudin a.s. të ketë thënë:

- *O Rabbi im, si të më duan të gjithë njerëzit, e të mos pengojnë lidhjen time me Ty?* Allahu Teala i tha:

²¹ Hadithi gjendet në librin para këtij.

- Ndaj njerëzve sillu sipas aftësisë së tyre, kurse mos u ndaj prej mirësisë mes Meje e teje. E në versionin tjetër:

- Ndaj njerëzve të dynjallëkut sillu përshtatshëm rregullave të sjelljes së dynjallëkut, kurse ndaj njerëzve të ahiretit sillu përshtatshëm edukatës së ahiretit.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Më i dashur tek Allahu është ai që afron dhe bashkon. Më i papëlqyer tek Allahu është ngatërrestari, që ndanë dy vëllezër.”²² Dhe me një hadith tjetër:

“Allahu ka krijuar një melek, gjysma e atij meleku është nga zjarri, e gjysma nga bora. Ai melek në dua thotë: ‘Allahu im, ashtu siç ke bashkuar borën e zjarrin, ashtu bashko zemrat e robërve Tu të mirë!’¹²³

Resulallahu s.a.v.s. gjithashtu thotë:

“Çdokush që vëllazërohet për Allahun, Allahu krijon për të një gradë në xhenet.”²⁴

Përsëri Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Ata që duhen mes vete për Allahun gjenden në maje të shtyllës nga rubinë (jakut) të kuq, në të cilën gjenden shtatëmijë çardakë, dhe nga aty shikojnë banorët e Xhenetit. Me hijeshinë e vet ndriçojnë përmbi të gjithë banorët e Xhenetit ashtu siç ndriçon dielli mbi banorët e kësaj bote. E banorët e Xhenetit thonë: ‘Ejani ti shikojmë ata që duhen për Allahun’.

Ata do të jenë të veshur me rroba nga mëndafshi i hollë e i gjelbër, e në ballë do t’ju shkruaj: ‘Ata që duhen për Allahun’.²⁵

²² Tebarani në veprat *‘Evsat’* dhe *‘Sagir’* nga Ebu Hurejres r.a.

²³ Ebu esh-Shejl ibn Hibban në veprën *‘Kitabu’l-Azame’*, nga Muaz ibn Xhebel r.a, dhe Irbadh ibn Sarije r.a.

²⁴ Ibn Ebu ed-Dun’ja në veprën *‘Kitabu’l-Ihvan’*, nga Enesit r.a..

²⁵ Tirmidhiu në veprën *‘Nevadir’*, nga Ibn Mesuda.r.a.

Hazreti Alia r.a., ka thënë:

“Përfitoni shokë! Ata janë pasuri për ju në këtë botë, dhe në botën tjetër. A nuk i keni dëgjuar fjalët e banorëve të Zjarrit?:

*“...tashmë ne nuk kemi asnjë ndërmjetësues (tek Allahu),
e as mik të ngushtë!”* 26-Esh-Shu’ara: 100, 101

Abdullah ibn Omer r.a.,ka thënë:

“Unë mund të agjëroj tërë jetën, të kaloj natën me ibadet, të dhuroj gjithë pasurinë në rrugën e Allahut, e të vdes në këtë gjendje, por - nëse në zemër nuk kam dashuri ndaj njerëzve që u janë nënshtruar Allahut Teala, e as përbuzje ndaj kryengritësve, aspak nuk do të kem dobi.”

Ibn es-Semmak, në prag të vdekjes ka thënë:

“Allahu im, Ti e di që nëse unë isha i panënshtruar – unë e doja atë që të nënshtrohej Ty. Bëj që kjo dashuri të më afroje tek Ti!”

Përkundër kësaj, nga Hasani Basriu, transmetohet:

“O biri i Ademit, mos të mashtron hadithi: ‘Njeriu është me atë që do’; të ndershmëve do t’u afroresh vetëm nëse vepron njëjtë si ata. Sepse edhe hebrenjtë dhe të krishterët sipas tyre i duan Pejgamberët e vet, por nuk ishin me ta.”

Kjo tregon që shoqërimi me të nderuarit, pa bërë veprat e mira që ata i bëjnë, nuk ka kurrfarë dobie.

Në njërin nga fjalimet e tij, Fudajl ka thënë:

“Ti dëshiron të jesh në Xhenet Firdeus, të jesh bashkë me pejgamberët, shehidët dhe të devotshmit, por – me çfarë vepre e ke merituar këtë? Cilën dëshirë të epshit e ke braktisur? Cilin zemërim e ke mposhtur? Cilën lidhje të ndërprerë familjare e ke rivendosur? Cilin gabim ia ke falur vëllait tënd? Nga cilët të afërm u largove, e cilëve të largët ju afrove për Allahun?”

Transmetohet se Allahu Teala i shpalli Musait a.s.:

- A ke bërë një vepër për Mua? Musa a.s. u përgjigj:

- O Rabbi im, kam falur namazin për rizanë Tënde, kam agjëruar, kam dhënë sadaka dhe zeqat. Allahu Teala tha:

- Të gjitha këto janë për ty. Namazi është dëshmi për ty, agjërimi yt është mbrojtje prej xhehenemi, sadakaja hije, e zeqati dritë. Prandaj, çfarë ke bërë për Mua? Musa a.s. u përgjigj:

- Allahu im, më trego veprën që bëhet për Ty. Allahu Teala tha:

“O Musa, a ke dashur dikë për Mua? A ke urrejtur dikë për Mua?”

Kështu Musait a.s. iu mësua që vepra më e mirë është dashuria për Allahun dhe urrejtja për Allahun.

Ibn Mesud r.a.,ka thënë:

“Po t’i bëj dikush ibadet Allahut për shtatëdhjetë vjet, në Qabe, në mes të ruknes dhe makami Ibrahimit, Allahu përsëri do ta ngjallë në Ditën e Gjykimit me atë të cilin ai person e do.”

Hasan Basriu Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë:

“Largimi nga gjynahqarët është afrim Allahut.”

Një njeri i tha Muhammed ibn Vasiut:
- *Vërtetë të dua për Allahun!* në çka Ibn Vasi tha:
- *Për çka më do ti mua, për atë të dua edhe unë ty.* Pastaj
ktheu fytyrën dhe tha:
-*Allahu im, tek Ti strehohem nga ajo që dikush të më
dojë, e Ti të më urresh!*

Një njeri hyri te Davud et-Tai, e ky i tha:
- *Çfarë të duhet?* Ky ia ktheu:
- *Të të vizitoj.* Davud et-Tai u përgjigj:
- *Ti bëre vepër të mirë dhe ke përfituar. Por, kush jam unë
që të më vizitosh? A jam zahid? Jo! A jam prej abidëve? Jo,
nuk jam. A jam prej të mirëve (salih)?' Jo."*
Filloi të qortojë veten, dhe tha:
- *Në rini isha gjynahqar. Kur u plaka kisha dëshirë vetë-
lavdërimin. E për Allahun një person i tillë është më i keq se
gjynahqari.*

Hazreti Omeri r.a., ka thënë:
*"Nëse dikush nga ju ndjen dashuri ndaj vëllait mysliman,
le t'i mbahet asaj. E kjo ndodh rrallë."*

Muxhahidi ka thënë:
*"Ata që duhen për Allahun, kur takohen dhe i buzëqeshin
njëri-tjetrit, gjynahet bien nga ta ashtu siç bien gjethet e
thata."²⁶*

Fudajl thoshte:
*"Është ibadet që njeriu të shikojë fytyrën e mikut të vet
me dashuri dhe mirësi."*

²⁶ Në origjinal shkruan *dimri* (shita')

KUPTIMI I VËLLAZËRISË PËR ALLAHUN DHE DALLIMI I SAJ NGA VËLLAZËRIA E KËSAJ BOTE

Dije se: dashuria dhe urrejtja për Allahun janë fshehtësi të mbuluara. Me shpjegimet tona, do të mundohemi t'i bëjmë këto të kuptueshme, duke heq perden nga to:

Nganjëherë, biseda (*sohbet*) dhe shoqërimi bëhen rastësisht. Të tilla janë shoqërimi me fqinjët, shoqërimi në rrugë, në shkollë, në treg, në dyert e shtetit, ose në udhëtime dhe të ngjashme; këto nuk janë nga vullneti dhe nga dëshira e brendshme, këto janë produkte të rastësishme. E nganjëherë, biseda (*sohbet*) bëhet me vetë-dëshirë dhe vullnet. Kjo është pjesa të cilën ne dëshirojmë ta shpjegojmë. Sepse, shpërblimi është në veprime të bëra me vullnet dhe dëshirë. Edhe bashkimi dhe inkurajimi janë vepra të bëra me vullnet dhe dëshirë.

Biseda (*sohbet*) përbëhet nga afrimi, shoqërimi dhe të qëndruarit bashkë në një vend. E këto bëhen vetëm falë dashurisë. Sepse njeriu ik nga ai që nuk e do, nuk dëshiron të vijë në kontakt me të dhe t'i afrohet.

E ai që do, ose e do personin për vet atë e jo që përmes kësaj të arrijë një dashuri tjetër, ose dashuria ndaj tij bëhet që nëpërmjet kësaj të arrijë në një dashuri tjetër. Lloji i dytë nënkupton se qëllimi mund të jetë i lidhur për këtë botë dhe të mirat e saj, ose për lumturinë e ahiretit (botës tjetër) ose edhe mbi këto një dashuri në lidhje me Allahun. Pra, ekzistojnë katër lloje:

Lloji i parë: është të duhet personi (për qenien e tij- për vet atë). Kjo lloj dashurie është e mundur; personi ka diçka që ti e konsideron të bukur, kur e sheh – gëzohesh dhe kënaqesh. Ai që njuh bukurinë, e di që ajo është e ëmbël.

Kënaqësia është e lidhur për njohje të bukurisë. Edhe bukuria është e lidhur me pajtueshmërinë mes dy natyrave: shfaqjes së gëzimit dhe marrëdhënies. Tutje, diçka që pranohet si e bukur, është e bukur nga jashtë, pamja e jashtme dhe trupi, ose për nga gjendja e brendshme, ahlaku dhe veprat e mira – bukuria e brendshme. Ashtu siç i nënshtrohen veprat e mira ahlakut, ashtu edhe dituria i nënshtrohet mendjes së përkryer. Sipas poseduesve të mendjes së përkryer dhe mendjes së drejtë, të gjitha këto janë të bukura. E çdo gjë e bukur është e dashur dhe e ëmbël. Bashkë me të gjitha këto paraqitje të shkaqeve (sebepeve) të dashurisë, ekzistojnë lidhje edhe më të thella e më të fshehta, që i lidhin zemrat për njëra-tjetrën.

Nganjëherë, edhe nëse nuk ekziston bukuria në formë dhe ahlak, mes dy personave mund të krijohet lidhje e përzemërt me një shkak (sebepe) të marrëdhënies së brendshme, e cila krijon njohjen dhe miqësinë. Sepse natyra e personit anon kah ngjashmëritë. Ngjashmëria e brendshme ka një anë të thellë dhe të fshehtë, që njeriu nuk mund ta perceptojë. Resulallahu s.a.v.s., na informon për këtë kur thotë:

“Shpirtrat janë si ushtarë të ndarë në njësi - ata që janë njohur (në botën e shpirtrave) me njëri-tjetrin edhe në dynja (këtë botë) përshtaten me njëri-tjetrin; e ata që nuk e njohin njëri-tjetrin – nuk kuptohen, nuk duhen.”²⁷ Mosmarrëveshja dhe mohimi kanë përfundim ndarjen, ndërsa mirëkuptimi ka si përfundim lidhjen. Resulallahu s.a.v.s., këtë e ka shpjeguar me fjalën *‘tearuf’* (njohje e ndërsjellë).

Në versionin tjetër të këtij hadithi, thuhet:

“Shpirtrat janë si ushtarë të ndarë në njësi. Takohen në ajër dhe duke i marrë erë njëri-tjetrit (duke nuhatur njëri-tjetrin) - kuptohen.”²⁸

²⁷ Muslimi nga Ebu Hurejre r.a., dhe Buhariu nga Aisha r.a.

²⁸ Taberani, në veprën e tij *‘Evsat’*, transmetuar nga Hz. Alia r.a.

Disa dijetarë këtë hadith e interpretojnë ashtu që thonë se Allahu Teala i krijoi shpirtrat, e më pas i shpërndau. Shpirtat u shëtitën rreth Arshit. Ata që u takuan dhe u kuptuan, edhe në dynja kur takohen – e donë njëri-tjetrin.

Përsëri Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Shpirtrat e dy besimtarëve takohen në rrugëtimin e një dite, e që kurrë njëri të mos e ketë parë tjetrin.”²⁹

Transmetohet se një grua në Mekë i bënte gratë tjera për të qeshur, e në Medine ishte një grua tjetër si ajo. Njëherë, kjo gruaja nga Meka erdhi te kjo tjetra në Medine. Vizitoi Aishen r.a. dhe e bëri të qesh. Aisha r.a. e pyeti: *“Ku je vendosur?”* Gruaja ia përmendi shoqen e vet. Aisha tha: *“Të vërtetën e ka thënë Resuli i Allahut. E kam dëgjuar duke thënë:*

“Shpirtrat takohen.”³⁰

E vërteta këtu është kjo: dëshmia e përvojës dhe perceptimi tregojnë vërtetësinë e ekzistimit të afërsisë në rast se ekziston lidhje shpirtërore, kurse ekzistimi i lidhjes në karakter dhe moral (ahlak) të jashtëm dhe të brendshëm është një realitet i njohur.

Por, nuk është në fuqinë e njeriut të kuptohen sebepe (shkaqet) e nevojshme që e bëjnë lidhjen. Ja edhe llomotitjet e astrologëve në këtë çështje; Astrologu thotë: *“Nëse (një yll) lajmërohet para gjashtëfishimit të tjetrit, ose trefishimit, kjo nënkupton harmoni dhe dashuri, prandaj edhe kërkon afërsi dhe dashuri, e nëse përputhet me tjetrin, ose lajmërohet para katërfishimit të tij, do të nënkuptojë urrejtje dhe armiqësi”,* kjo, edhe nëse përshtatet me realitetin, si edhe me

²⁹ Hadithin e shënon Ahmedi, në transmetim nga Abdullah ibn Omer r.a.

³⁰ Hadithin e shënon Hasan ibn Sufjan në veprën e tij *‘Musned’*, me zinxhir të mirë të përcjellësve.

ligjin dhe rregullin e Allahut në krijimin e qiejve dhe tokës, vështirësitë e vërteta në afërsi i paraqet edhe më të vështira. Për këtë arsye, njeriu as nuk ka nevojë të merret me fshehtësi të cilat atij nuk i janë zbuluar.

Diskutimi për fshehtësinë nga e cila njeriut nuk i është zbuluar asgjë, nuk ka as kuptim. E neve na është dhënë veçse pak dituri. Për besueshmërinë e kësaj që po flasim na mjaftojnë përvoja dhe perceptimi.

Për këtë flet edhe hadithi në vazhdim:

“Nëse besimtari hyn në tubim (mexhlis) ku ka me qindra dyfytyrësh, e vetëm një besimtar, do të vijë e të ulet afër tij. E nëse dyfytyrëshi vjen në tubim (mexhlis) ku ka qindra besimtarë, e vetëm një dyfytyrësh, do të vijë e të ulet afër tij.”³¹

Kjo dëshmon që ngjashmëria me diçka tërheq nga vet natyra, edhe nëse njeriu nuk është i vetëdijshëm për atë ngjashmëri. Malik ibn Dinar do të thoshte: *‘Nëse mes dhjetë personave dy persona kuptohen, kjo është për shkak të veçorive të tyre. Në këtë çështje njerëzit u përngjajnë zogjve. Sikur zogjtë, kur gjatë fluturimit takohen (me zogj të llojit tjetër) e nuk kuptohen, edhe njerëzit të cilët nuk kanë marrëdhënie mes vete, kur takohen – nuk kuptohen njëri me tjetrin.’*

Një ditë Maliku pa korbin me pëllumbin duke fluturuar së bashku. U habit nga kjo, dhe tha: *“Allah, Allah. Ata nuk kanë asnjë lidhje mes vete - si fluturojnë bashkë?”*

Pas pak, zogjtë zbritën, dhe u pa se të dy janë të çalë. Në këtë Maliku tha: *“Ja! Kështu e ndërtuan lidhjen këta!”*

³¹ Bejheki në veprën e tij *‘Shu’abul-iman’*, nga Ibn Mesud r.a., dhe autori i *‘Firdevs’*-it, nga Muadh ibn Xhebel r.a.

Një dijetar ka thënë: *“Secili person afrohet me personin e ngjashëm me të, ashtu siç fluturon secili zog me sojin e vet. Nëse dy persona shoqërohen një kohë mes vete pa poseduar cilësi të ngjashme, në fund sigurisht se do të ndahen.”*

Ky është një kuptim i fshehtë, të cilin disa poetë e ndjejnë, bile, dikush nga ta i tha vargjet në vazhdim:

Dikush pyeti: “Pse u ndatë ju të dy?”

E unë iu përgjigja:

“Nuk kishte ngjashmëri, e për këtë arsye u ndamë. Sepse njerëzit me ngjashmëri shoqërohen.”

Nga kjo kuptohet se njeriu dashuron personin (qenien e tij), jo që me këtë të arrijë ndonjë dobi, pozitë ose pasuri, por thjesht për shkak të ngjashmërisë dhe lidhjes së karakterit të brendshëm dhe ahlakut të fshehur. Në këtë pjesë hyn edhe dashuria për shkak të bukurisë, sepse kjo (pëlqimi i bukurisë) nuk do të thotë domosdo edhe dëshirë e epshit. Format e bukura japin kënaqësi vetvetiu, edhe po të mos ketë nevojë për epsh – nga to merret kënaqësi. Kënaqësi merret nga shikimi i pemëve, luleve, dritës dhe sythit, mollës së kuqe, ujit që rrjedh dhe gjelbërimit. Këtu nuk bëhet fjalë për epshin, e as nuk ka të bëjë me dashuri për Allahun. Kjo është një dashuri natyrore. Edhe jobesimtari e ka këtë dashuri. Por nëse kjo dashuri i mbështetet ndonjë qëllimi të keq, atëherë bëhet e papëlqyer, siç është dashuria ndaj formës së bukur për kënaqjen e epshit, e kjo kënaqje nuk është e lejuar. Nëse për dashuri nuk është i lidhur ndonjë qëllim i keq, dashuria e tillë është *mubah*, nuk kualifikohet as si e lavdëruar e as si e papëlqyer. Pra, dashuria ndahet në tri pjesë: e lavdëruar (*mahmud*), e papëlqyer (*mezmum*), ose - as e lavdëruar e as e papëlqyer (*mubah*).

Lloji i dytë: nuk është dashuria ndaj vet personit (vetë qenies), por dashuria përmes së cilës arrihet qëllimi. Padyshim që dashurohet edhe mjeti përmes së cilit arrihet

dashuria. Dashuria e vërtetë është qëllim, e jo mjet që mundëson qëllimin. Por, gjithashtu duhet edhe mjeti që dërgon në dashuri. Ari dhe argjendi janë të kësaj natyre, nuk janë qëllim vet metalet e çmuara, se ato as nuk hahen e as nuk vishen, por ato janë mjete të arritjes së qëllimit, sepse me to mund të arrihet reputacion, pasuri, ose dituri. Dikush, në anën tjetër, e do pozitën sepse përmes saj vjen deri te pasuria dhe reputacioni, e do shoqërinë e lartë (aristokracinë), që shkon bashkë me pozitën, sepse të tillët e bëjnë të ndihet mirë. Nëse dashuria (një mjet i tillë) është e limituar vetëm në të mirat e kësaj bote, atëherë një dashuri e tillë nuk është dashuri për Allahun. Gjithashtu, nëse kjo dashuri (mjet) nuk është e limituar vetëm në dobitë e kësaj bote dhe ka lidhje edhe me ahiret, por ai që do - do vetëm nga ana e kësaj bote - si dashuria e nxënësit ndaj mësuesit, as kjo nuk llogaritet si dashuri për Allahun. Për shembull, në këtë rast nxënësi e do mësuesin vetëm me qëllim që të fitojë dituri, dashuri e tij e vërtetë është dituria. E nëse nuk dëshiron dituri me qëllim që t'i afrohet Allahut Teala, por me qëllim që të arrij reputacion, pasuri dhe pëlqimin e njerëzve, atëherë dashuria i takon reputacionit dhe pëlqimit prej njerëzve; në këtë rast dituria është vetëm mjet për arritjen e tyre, e mësuesi është mjet për arritjen e diturisë. Këtu nuk ka asgjë që do të ishte dashuri për Allahun, sepse dashuritë e tilla gjenden edhe te ata që nuk besojnë në Allahun Teala.

Më pas, kjo dashuri ndahet gjithashtu në të papëlqyer, dhe në të lejuar. Pra, nëse me këtë dashuri dëshirohet të arrihet diçka e papëlqyer: mposhtja e rivalit, grabitja e pasurisë së jetimit, qeverisje e dhunshme etj., - edhe vet ajo dashuri është e papëlqyer. E nëse me atë dashuri dëshirohet të arrihet diçka që është e lejuar, ajo dashuri është e lejuar. Meqenëse mjeti i është nënshtruar qëllimit, merr përsipër përgjegjësinë e qëllimit.

Lloji i tretë: dashuria për një qëllim tjetër e jo për vet personin (qenien). Nëse ky qëllim është për ahiret e jo për këtë botë (dynjallëk), edhe kjo është gjithashtu e qartë, aspak hutuese.

Kjo është sikur kur dikush e do mësuesin ose Shejhun e vet, me ndihmën e të cilit merr dije dhe zbukuron veprimet, e me dituri dhe vepra synon shpëtimin në botën tjetër (ahiret). Kjo dashuri është dashuri për Allahun Teala. Gjithashtu, edhe mësuesi ose Shejhu e do nxënësin e tij për Allahun, sepse edhe ai me ndihmën e këtij i zgjeron dituritë, përmes tij merr pjesë në mësimdhënie, kështu që përmes tij ngritët në shkallë të lakmueshme në botën e melekutit. Isa a.s. ka thënë:

“Kush mëson, vepron përshtatshëm mësimit dhe i mëson të tjerët, atë e përmendin me nderime në botën e melekutit.”

Padyshim që të mësuarit bëhet me nxënësin. Për të arritur në këtë lartësi, nxënësi është një shkallë - mësuesi e do nxënësin nga kjo pikëpamje. Sepse për përmendjen e mësuesit me nderim në botën e melekutit shkaktar është nxënësi të cilit mësuesi ia përgatit gjoksin si arë për farën e tij. Pra, kjo është dashuri për Allahun. Bile, ai që me sinqeritet ndanë pasurinë e tij për rizanë e Allahut Teala, dhe mbledhë mysafirë, ndanë me ta ushqim të rrallë dhe të shijshëm, dhe e do kuzhinierin sepse ai pregaditë mirë, gjithashtu radhitet ndër ata që duan për Allahun Teala. Njëjtë, nëse e do personin si mjet i cili ia dërgon sadakanë e tij atyre që e meritojnë, gjithashtu është dashuri për Allahun.

Bile, do të shtojmë në këtë edhe këto fjalë: nëse dikush e do dikë që i ndihmon (i bën hyzmet) në larjen e rrobave, pastrimin e shtëpisë dhe përgatitjen e ushqimit, dhe me këtë i mundëson që t'i kushtohet mësimit ose kryerjes së veprave të mira, e qëllimi i kësaj ndihme është pikërisht mundësimi i bërjes së ibadeteve, gjithashtu bëhet fjalë për dashuri për Allahun Teala.

Për më shumë: nëse dikush e do atë që i jep nga pasuria e vet, e vesh me rrobat e veta, e ushqen me ushqimin e vet, e strehon në shtëpinë e tij, me të ndan gjithçka që ka në këtë botë, e me gjithë këtë dëshiron të arrijë dituri dhe vepra që do ta arrijnë rizanë e Allahut, edhe kjo është dashuri për Allahun. Një grup i të pasurve kujdesej për nevojat e disave nga gjenerata e parë, me qëllim që ata të bëjnë ibadet në qetësi. Kështu që, edhe ata që ndihmojnë, edhe ata që ndihmohen – hynë në mesin e atyre që duhen mes vete për Allahun.

Do të shtojmë edhe këtë: ai që martohet me besimtare të mirë me qëllim që me ndihmën e saj të mbrohet nga vesveset (psherëtimat) e shejtanit dhe të ruajë fenë, ose që me atë të ketë fëmijë të mirë i cili më vonë do të lusë Allahun Teala për të – nëse e do gruan sepse atë e ka mjet me ndihmën e së cilës vije deri te këto qëllime, ani pse janë të kësaj bote, fjala është për dashuri për Allahun. Për këtë shkak janë përmendur transmetimet për shpërblimet e mëdha dhe sevapet që fitohen me sigurimin e jetesës së familjes, qoftë edhe një kafshate të cilën burri i jep në gojë gruas së tij.

Bile edhe kështu themi: ai që është i njohur për dashurinë ndaj Allahut Teala, që e do kënaqësinë e Tij dhe takimin me Të në vendbanimin e përhershëm, e ky dashuron dikë – atëherë fjala është për dashuri për Allahun Teala. Sepse nuk mund të paramendohet që i tilli të dashurojë diçka që nuk është e përshtatshme me atë që do, e në këtë rast – kënaqësia e Allahut Teala.

Dua të shtoj edhe diçka: në zemrën e një personi mund të mbliidhen dy dashuri: njëra ndaj Allahut Teala e tjetra ndaj dynjallëkut. Pra, këto dy dashuri ai mund t'i arrijë nëpërmjet një personi, e të duhet personi për këto dy qëllime, përsëri është dashuri për Allahun. Kjo është sikur kur dikush e do mësuesin i cili ia ka mësuar fenë dhe gjërat e kësaj bote.

Pra, e do sepse në natyrë ka kërkimin për rehati në këtë botë dhe kënaqësi në ahiret, kurse mësuesin e ka mjet për arritjen e këtyre dy qëllimeve, prandaj kjo është dashuri për Allahun Teala.

Kategorikisht pohoj që në atë rast dashuria do të kualifikohej si dashuri për Allahun Teala. Për të qenë një dashuri për Allahun, nuk mund të thuhet që kusht është që asaj dashurie të mos i përzihet asgjë nga kjo botë. Sepse dua ja me të cilën janë detyruar Pejgamberët a.s. përfshinë edhe këtë botë, edhe botën tjetër. Nga aty fjalët:

“Rabbi ynë, na jep të mira në këtë botë, dhe në botën tjetër!” 2-Bekare: 201

Në duanë e tij, Isa a.s. kështu ka thënë:

“Allahu im, mos lejo që armiku im të gëzohet për shkak timin, e as që miku im të pikëllohet për shkak timin. Mos lejo që feja ime të më shkatërrohet, mos bëj që preokupimi me këtë botë të më bëhet brenga më e madhe.”

Isa a.s., nuk ka thënë: *“Bëj që kjo botë të mos më bëhet brengë, fare”* por është lutur që Allahu t’i mundësojë që preokupimi me këtë botë të mos i jetë brenga më e madhe.

Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Allahu im, kërkohet rahmetin Tënd që më sjell nder në dynja dhe ahiret.”³²

dhe ka thënë:

“Allahu im, më mbroj nga fatkeqësia e kësaj bote dhe nga fatkeqësia e ahiretit.”³³

³² Tirmidhiu nga Ibn Abbas r.a., në një hadith më të gjatë rreth duasë së Resulallahut s.a.v.s. pas namazit të natës, për të cilin tashmë kemi folur.

³³ Ahmedi nga Bishr ibn Ebi Ertat.

Shkurtimisht, siç nuk është dashuria ndaj lumturisë në ahiret në kundërshtim me dashurinë ndaj Allahut Teala, edhe kërkimi i shpëtimit, shëndetit, bollëkut dhe nderimit në këtë botë, padyshim që nuk është në kundërshtim me dashurinë për Allahun. Edhe dynjallëku edhe ahireti janë vetëm shprehje të dy gjendjeve, ku njëra është më afër se tjera. Nëse njeriu mund të kërkojë kënaqësinë dhe mirëqenien e së nesërme, përse të jetë pengesë kërkimi i lumturisë së sotme? Njeriu e do rehatinë që do ta marrë nesër sepse së shpejti 'e nesërmja' do të bëhet gjendje e tij, por 'e sotmja' tashmë është gjendja e tij. Sigurisht që e do edhe rehatinë e sotme.

Nga ana tjetër, dobitë e tanishme ndahen në ato të cilat janë të kundërta me dobitë në botën tjetër dhe të cilat i parandalojnë ato, dhe nga të cilat kanë kërkuar mbrojtje pejgamberët dhe robërit e mirë (*evlia*) dhe kundër të cilave kanë rekomanduar mbrojtje, dhe në ato që nuk janë të kundërta me dobitë në botën tjetër dhe të cilat nuk i parandalojnë ato, siç është martesja e përshtatshme, konsumimi i ushqimit të lejuar (*hallall*) dhe të tjera.

Është logjike që i mençuri nuk e miraton atë që është e kundërt me dobitë në botën tjetër, që nuk e do atë, d.m.th. i do ato gjëra me mendjen e tij, e jo me natyrën e tij, largohet nga ato – edhe nëse janë të ëmbla - duke menduar përfundimin, e jo që ia dëmton stomakun dhe që nuk ia dëshiron shpirti. Për shembull: ashtu siç nuk miraton konsumimin e ushqimit të shijshëm të sulltanit, duke e ditur se po ta konsumonte atë ushqim do t'ia këpusnin dorën, ose do t'i hiqnin kokën, e jo në kuptimin që ushqimi i shijshëm bëhet diçka të cilin ai, si të tillë, me natyrën e tij nuk e do, diçka që nuk do të ishte e shijshme sikur ta hante; kjo do të ishte absurd. Pra, mendja e tij e ndalon ta marrë atë ushqim me çka vjen deri te dëmtimi i ahiretit, prandaj duhet të largohet nga gjëra si kjo që dëmtojnë ahiretin.

Me këtë dëshirohet të thuhet si vijon: personi e do mësuesin e vet për arsye se ai e edukon dhe e mëson, edhe mësuesi e do nxënësin për arsye se nxënësi mëson prej tij dhe ia bën ndonjë hyzmet, që në një anë ka lidhje me këtë botë, dhe në një anë me ahiretin. Kjo dashuri përsëri është dashuri për Allahun. Por, edhe kjo ka një kusht: në qoftë se mësuesi braktis furnizimin e ushqimit të nxënësit dhe mësimin ose nxënësi nuk interesohet për hyzmet dhe mësim, me këtë do të zvogëlohet dashuria mes tyre. Aq sa zvogëlohet kjo, aq zvogëlohet edhe dashuria për Allahun dhe vetëm aq përfiton sevap. Rritja e dashurisë tënde ndaj dikujt për arsye që ka mbledh të gjitha mirësitë nuk ka pengesë. Nëse disa nga këto arsye zvogëlohen, edhe dashuria (jote) mund të zvogëlohet, nëse ato (arsye) rriten, do të rritet edhe dashuria (jote).

Shembull: Dashuria (jote) ndaj arit nuk është e njëjtë si dashuria (jote) ndaj argjendit, për arsye se kur vlerat e tyre të krahasohen, numri i qëllimeve që mund të arrihen me posedimin e arit është shumë më i madh se sa numri i qëllimeve që arrihen me posedimin e argjendit. Me shumimin e dobive shumohet edhe dashuria. Ngjashëm kësaj nuk është pengesë të përmbliidhen qëllimet e dashurisë edhe të dynjallëkut edhe të ahiretit, e gjithë kjo hyn nën dashuri për Allahun.

Shpjegimi i kësaj bëhet kështu: nuk është e mundur të paramendohet ekzistimi i çfarëdo dashurie si dashuri për Allahun, nëse në të nuk ka besim në Allahun Teala dhe në botën tjetër (ahiret).

Njëjtë si kjo, për ata që nuk kanë besim (iman), nuk është e mundur të paramendohet rritja e dashurisë për Allahun.

Kjo dashuri sado që është tërheqëse, është një ekzistencë shumë e vlefshme dhe e rrallë .

Ebu Muhammed Xhurejri tregon:

“Pas shekullit të parë (Hixhri) njerëzit nuk vepruan mes vete sipas fesë, dhe e dobësuan fenë. Pas shekullit të dytë, njerëzit nuk vepruan mes vete sipas nderit dhe e dobësuan edhe nderin. Pas shekullit të tretë nuk vepruan njerëzishëm, deri sa nuk u dobësua edhe ajo, e mbeti vetëm frikësimi dhe dëshira.”

Lloji i katërt: Që personi të dashurojë për Allahun Teala dhe për kënaqësinë (rizanë) e Allahut Teala, e që me atë dashuri nuk ka asnjë qëllim të arrijë diçka tjetër pos Qenies (Dhat). Kjo është grada më e lartë, më e thellë dhe më e fshehur. Edhe ky lloj i dashurisë gjithashtu është i mundur. Njëra nga gjurmët e zotërimit të kësaj dashurie është të dashuruarit e gjithçkaje që ka të bëjë me atë që dashurohet. Prandaj kush e do dikë me dashuri të fuqishme, e do edhe dikë tjetër i cili këtë të njëjtin person e do, atë që ky person e do, atë që i ndihmon, që e lavdëron dhe e do secilin që dëshiron të arrijë pëlqimin e personit të dashur. Kjo shkon deri aty sa që Bekijja ibn el-Velid thotë:

“Kur besimtari e do besimtarin tjetër, e do bile edhe qenin e tij.”

Kjo është pikërisht ashtu si është thënë. Për këtë tregon përvoja e cila flet për gjendjet e të dashuruarve, si dhe ndjenjat e poetëve. Prandaj ata i ruanin edhe rrobat e të dashurave të tyre dhe i fshihnin, bile, si kujtim në të ia donin shtëpinë, vendin ku jeton, komshinjtë dhe atë deri në atë masë sa që Mexhnun b. Amir (emri i tij është Kajs) këndon:

*Shëtis vendin ku Lejlaja gjendet
E puthi gurin dhe dheun e atij vendi
Në fakt nuk është vendi që ma djeg zemrën
Është dashuria e Lejlasë që rri aty.*

Pra, realiteti dhe përvoja tregojnë se dashuria kalon nga personi i dashur në atë që e rrethon personin e dashur, në atë që është e lidhur me të, në atë që i përngjanë atij, qoftë edhe nga larg. Por, kjo është një nga specifikat e dashurisë së tepruar, e jo e themelit të dashurisë, prandaj bartja e dashurisë nga personi i dashur në atë që e rrethon, dhe lidhja me shkaktarët e saj, vjen si pasojë e dashurisë së tepruar. Për atë person, baza e dashurisë nuk është e mjaftueshme, por dashuria zgjerohet, ashtu që kalon nga personi i dashur në atë që e rrethon dhe në atë që është e lidhur me shkaktarët e dashurisë ndaj atij personi, dhe atë përshtatshëm me fuqinë e dashurisë. Njëjtë është edhe me dashurinë ndaj Allahut Teala, ajo forcohet, e pushton zemrën dhe e zotëron plotësisht, dhe fillon të kalojë në të gjitha krijesat tjera, sepse gjithësia është vepra e fuqisë së Tij. Ai që e do dikë, i do edhe të gjitha veprat e tij.

Për këtë arsye, Muhammedi s.a.v.s., kur i sillej fryti i parë i ndonjë peme, i fërkonte me të sytë, i shprehte nderime, e thoshte:

“Është një krijesë e re e Rabbit tim.”³⁴

Dashuria ndaj Allahut Teala nganjëherë është si pasojë e shpresës së sinqertë në premtimin e Allahut për shpëtim dhe të mira në botën tjetër, e nganjëherë si pasojë e ndihmës të cilën Allahu ofron dhe të mirësive të llojllojshme të Tij. Nganjëherë është si pasojë e dashurisë vetëm ndaj Tij dhe asgjëje tjetër, dhe kjo është dashuria më e përpiktë dhe më e lartë. Këtë, Inshallah, do ta shpjegojmë në ***“Librin mbi Dashurinë”***, në pjesën e dedikuar gjërave që qojnë në shkatërrim. Dashuria ndaj Allahut Teala, kur forcohet, kalon në dashuri ndaj gjithçkaje që është e lidhur për të, bile edhe ndaj diçkaje që është vetvetiu një dhimbje e padëshiruar,

³⁴ Taberani në veprën ***‘Sagir’***, nga Ibn Abbasit r.a, Ebu Davud në veprën ***‘Merasil’***, si dhe Bejheki në ***‘Da’vat’***, transmetuar nga Ebu Hurejre r.a.

sepse dashuria e pamasë e zvogëlon ndjenjën për dhimbje. Gëzimi për atë çfarë bën personi i dashur dhe për atë që personi i dashur ka pasur për qëllim me shkaktimin e dhimbjes, e zvogëlon vet ndjenjën e dhimbjes. Shembull i kësaj është gëzimi për goditjen e personit të dashur dhe pickimeve të saj me qëllim të lajkave. Fuqia e dashurisë nxit gëzim i cili e zbut dhimbjen. Dashuria ndaj Allahut kulmon në atë mënyrë që disa thonë:

“Nuk bëjmë dallim në mes të halleve dhe mirësive, sepse gjithçka është prej Allahut, si dhe nuk i gëzohemi asgjëje që nuk e ka kënaqësinë e Tij.” E disa bile thonë:

“Nuk dua të arrij faljen e Allahut përmes mosbindjes ndaj Tij.”

Semnun-i këndon:

Përpos Teje, nuk kam kënaqësi, siç do Ti më sprovo.

Komentim më të detajuar të kësaj do të japim, inshallah në *“Librin mbi Dashurinë”*.

Qëllimi është ky: nëse dashuria ndaj Allahut forcohet, ajo do të dhurojë fryt të dashurisë ndaj çdo gjëje që ekziston përmes robërimit ndaj Allahut – me dituri dhe me vepra – dhe do të dhurojë fryt të dashurisë ndaj çdo gjëje që në vete përmban cilësi të cilat shkaktojnë kënaqësinë e Allahut, qoftë sjellje e hijshme, edukim i bukur apo veprim sipas urdhrave të Sheriatit të lartësuar. Nuk ka njeri që e do botën tjetër dhe Allahun Teala, e që kur t’i përmendet gjendja e dy personave, nga të cilët njëri është i dijshëm dhe besimtar, e tjetri i padijshëm dhe gjynahqar, të mos gjallërohet një dashuri në vete për atë që është i dijshëm dhe besimtar. Kjo dashuri forcohet ose dobësohet varësisht nga forcimi i besimit dhe dashurisë së tij ndaj Allahut Teala. Një prirje e tillë do të ndodhë, qoftë edhe nëse ata dy persona nuk gjenden afër personit për të cilin flasim, në kuptim që nga ta nuk mund të ketë as dobi e as të keqe, në këtë botë ose në botën tjetër. Kjo dashuri është në fakt dashuri ndaj Allahut

dhe për kënaqësinë e Allahut Teala, pa pritje të çfarëdo dobie. Thjesht, ai do ta dojë atë person, sepse atë e do Allahu Teala, dhe me të është i kënaqur, si edhe për shkakun që ai person e do Allahun, dhe është i preokupuar me ibadet (robëri) ndaj Tij. Por, nëse kjo dashuri dobësohet, ajo nuk do të lë gjurmë, e as që do të fitohet përmes saj sevap si shpërblim. Kur dashuria forcohet, kalon në shoqërim, ndihmë dhe mbrojtje, dhe atë me jetë, pronë dhe gjuhë, e te njerëzit një dashuri e tillë është prezent, në masë më të vogël a më të madhe, varësisht nga fuqia e dashurisë së tyre ndaj Allahut Teala, të Plotfuqishmit dhe Madhështorit.

E sikur dashuria të ishte e limituar vetëm në gjendje dhe pronë e cila arrihet përmes të dashurve, nuk do të ishte e mundur të kuptohet dashuria ndaj dijetarëve dhe besimtarëve të vdekur, ndaj as'habëve dhe tabiinëve, aq më shumë – as ndaj pejgamberëve të cilët nuk janë më në mesin e të gjallëve, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të gjithë ata. Dashuria ndaj të gjithë atyre qëndron vendosmërisht në zemrat e myslimanëve të devotshëm.

Kjo dashuri lajmërohet tek myslimanët me nevikosje kur flasin kundër tyre, dhe me kënaqësi kur lavdërohen dhe flasin në favor të tyre. E gjithë kjo është dashuri për Allahun Teala. Sepse këta janë robërit e mëdhenj të Allahut, e kush e do mbretin ose ndonjë person të mirë, ai i do edhe njerëzit e tij dhe i do ata që e donë. Por dashuria provohet me dëshirat e nefsit. Domethënë: kërkohet a i braktisë apo jo dëshirat (e veta) për dashurinë. Nganjëherë, dashuria shkon aq përpara sa që për dashuri i braktis të gjitha kërkesat dhe dëshirat.

Këtë e shpjegon poeti me rreshtat:

*Unë dua të arrij dashurinë; ai do ndarje,
Sakrifikoj dëshirën time për kërkesat e tij.*

Gjithashtu ia vlen të përmendim edhe fjalët:

*E çka janë plagët,
kur me dhimbje jeni të kënaqur?*

Varësisht shkallës së dashurisë, njeriu sakrifikon disa dëshira, por jo të gjitha kërkesat. Sikur duke i dhënë të dashurës gjysmën e pasurisë, ose një të tretën, ose edhe një të dhjetën. Sasia e pasurisë së ndarë zbulon sasinë e dashurisë, sepse shkalla e dashurisë ndaj dikujt matet me braktisjen e dëshirave tjera përballë asaj dashurie. Nëse dashuria ka mbushur plotësisht zemrën, tani në atë zemër nuk ka vend për dëshira tjera - të gjitha dëshirat sakrifikohen përballë dashurisë, mu sikur Hz. Ebu Bekër es-Siddik, Allahu qoftë i kënaqur me të. Për hir të dashurisë ndaj Allahut, ai u shkëput prej tërë pasurisë dhe nuk i la asgjë vetes. Vajzën më të dashur ia dha Resulallahut s.a.v.s, dhe e shpërndau të gjithë pronën e vet për fe. Kjo është grada më e lartë.

Abdullah b. Omer r.a., tregon:

“Njëherë, në mesin tonë ishte ulur Resulallahu s.a.v.s.. Edhe Hz. Ebu Bekr (r.a.) ishte aty, e veshur kishte një pallto të vjetër, të cilin e kishte mbërthyer me kapëse në gjoks. Në atë kohë zbriti Xhebraili a.s., i dha selam Resulallahut s.a.v.s., dhe i tha:

- O Resulallah, çfarë po shoh, Ebu Bekrin me pallto të vjetër?’ Muhammedi s.a.v.s. u përgjigj:

*- **Ka dhënë pasurinë për Islam para çlirimit të Mekës.”***

Xhebraili a.s. tha:

- Përcjelli selame nga Allahu dhe thuaj: ‘Rabbi yt po pyet:

*- **A je i kënaqur me mua në atë gjendje të varfërisë tënde, apo je i brengosur?’***

Resulallahu s.a.v.s. u kthye kah Ebu Bekri dhe i tha:

*- **O Ebu Bekër, ky është Xhebraili, të solli selam nga Allahu i Cili të pyet se a je i kënaqur me Të në atë gjendje të varfërisë tënde, apo je i brengosur?’***

Ebu Bekri r.a., filloi të qajë, dhe tha:

- Vallë, a të jem unë i brengosur në Allahun? Unë jam i kënaqur nga Allahu!³⁵

³⁵ Ibn Hibban dhe Ukajli në veprën ‘*Duafa*’.

Nga kjo përfundojmë që secili që e do dijetarin, diturinë, ose të devotshmin ose ndonjë person që i është përkushtuar mësimi ose bërjes së veprave të mira, i do për Allahun Teala, dhe ka sevape dhe shpërblime në raport me atë dashuri. Ky është shpjegimi i dashurisë për Allahun Teala dhe gradat e dashurisë. Ndonëse me këtë u kuptuan edhe cilësitë e urrejtjes për rizanë e Allahut, e këtë do të dëshiroja ta qartësoj edhe pak.

URREJTJA PËR RIZANË E ALLAHUT

Dije se: kushdo që do për rizanë e Allahut Teala, sigurisht që edhe urren për rizanë e Allahut. Ti e do një person për arsye se ai i është nënshtruar urdhrave të Allahut dhe ti mendon se është i dashur tek Allahu Teala, por nëse i njëjti bëhet kryengëritës, sigurisht që duhet ta urresh pse është bërë kryengëritës ndaj urdhrave të Allahut është bërë dhe gjynahqar. E kush do për ndonjë shkak, gjithsesi se edhe urren për të kundërten e këtij shkak. Kjo është domosdoshmëri e dyfishtë, e pandarë njëra nga tjetra. Fjala është për reciprocitet në mes të dashurisë dhe urrejtjes. Në dashuri dhe urrejtje kjo është zakon (adet) dhe mënyrë (usul). Por cilado urrejtje, bile edhe dashuri në fakt është sëmundje e fshehtë në zemër e cila lajmërohet atëherë kur dashuria ose urrejtja e pushtojnë njeriun, e që manifestohet me vepra me qëllim të arritjes së afërsisë ose largimit, kundërshtimit apo pajtimit. Manifestimit të dashurisë në miqësi i thuhet *muvalat*, kurse manifestimit të urrejtjes në armiqësi i thuhet *mu'adat*. Për këtë arsye, siç e treguam më lartë, Allahu Teala thotë:

“A je miqësuar me dikë për Mua? A je armiqësuar me dikë për Mua?”

Kjo është e qartë kur është fjala për dikë i cili nënshtrohet urdhrave të Allahut Teala dhe nuk ka ndonjë cilësi të keqe, për çka edhe e do, ose kundërshtimi i gjynahqarit dhe sjelljeve të këqija, për çka edhe e urren. Mirëpo, problematike është kur përzihen nënshtrimi dhe kundërshtimi - si të përshtaten në një vend dashuria (muhabet) dhe urrejtja. Sepse dashuria sjell miqësinë, e urrejtja armiçësinë. E ti do të pyesësh: *“Si mund të gjenden së bashku urrejtja dhe dashuria kur bëhet fjalë për kundërshti?”*, Do të them që në këtë çështje nuk ka kundërshtim mes përfitimit njerëzor dhe urdhrave të Allahut. Te njeriu gjenden dy veçori: pëlqimi dhe mospëlqimi. Njeriu me veçori të pëlqimit do, dhe me veçori të mospëlqimit - nuk do. Për shembull; personi ka grua të bukur, por të paedukuar, për shkak të bukurisë e do, e për shkak të mungesës së edukimit nuk e do. Njëjtë është edhe me fëmijën e mençur dhe të kujdesshëm, por gjynahqar; atë e do për arsye se është i mençur, e nuk e do pse është gjynahqar.

Të duhet nga njëra anë, e të urrehet nga ana tjetër - kjo bëhet mes dy gjendjeve. Le të themi, nëse do të kesh tre fëmijë, njëri i mençur dhe i ndershëm, tjetri mendjetrashë dhe i padëgjueshëm, dhe i treti i mençur por i padëgjueshëm; sipas tipareve të tyre ekzistojnë tri gjendje të ndara. Prandaj duhet të jetë mënyra e sjelljes dhe trajtimi yt ndaj atij që i nënshtrohet urdhrave të Allahut, ndaj atij që kundërshton (kryengritësit), dhe ndaj atij që përzien nënshttrimin me kundërshtimin. Secilit tipar duhet t'i japësh atë që i takon – dashurinë ose urrejtjen, largimin ose afrimin, shoqërimin ose ndërprerjen e marrëdhënies, dhe të gjitha veprat tjera të cilat dalin nga një tipar i caktuar.

Nëse pyet: *“Te secili mysliman, është nënshtrimi ai që e përcakton besimin e tij, atëherë si mund ta urrej kur ai është mysliman?”*, do të përgjigjem: duaje për atë që është mysliman, e urreje për mosbindjen e tij. Sillu ndaj tij ashtu që do ta krahasosh me mosbesimtarin ose gjynahqarin.

Dallimi që do të shohësh në mes tyre tregon dashurinë për shkak të islamit dhe respektimin e të drejtave të tij, respektivisht besimin ndaj Allahut dhe nënshtrimin Atij, ose gjynahun ndaj teje dhe mosbesimit. E kush të pajtohet me ty në ndonjë qëllim, por nuk pajtohet lidhur me një qëllim tjetër, ndaj tij të jesh në një gjendje të mesme, në mes të të qenit i hapur dhe i mbyllur, në mes të favorizimit dhe refuzimit, në mes të afërsisë dhe largimit. Mos i shfaq vlerësim të tepruar, siç shfaq ndaj atij i cili në gjithçka pajtohet me ty. As mos e përçmo për së tepërmi, sikur që përçmon atë i cili në gjithçka është në kundërshtim me ty.

Eh tash, sa i përket kësaj gjendjeje të mesme, nganjëherë më shumë je i kthyer kah përçmimi, nëse gjynahet e tij mbizotërojnë te ai, e nganjëherë prapë, më shumë kthehesh kah mirësia dhe respekti, nëse pajtohesh më shumë me atë person. Njëjtë duhet të jesh edhe ndaj atij që është edhe i nënshtruar edhe gjynahqar ndaj Allahut Teala, dhe i cili në atë mënyrë një herë meriton kënaqësinë e Tij, e herën tjetër zemërimin e Tij.

Nëse pyet: *“Me çka është e mundur të shprehet urrejtja?”*, atëherë do të them:

Është e mundur me të folur, nganjëherë me përmbajtje nga të folurit, e nganjëherë me nënvlerësim dhe fjalim të hidhur. Shfaqja e urrejtjes është e mundur edhe me vepër, dhe atë nganjëherë me mosdhënie të ndihmës, e nganjëherë duke tentuar për ta dëmtuar, respektivisht të pamundësohet në qëllimet e tij. Disa nga këto janë më të forta se të tjerat, përshtatshëm shkallës së gjynahut dhe kundërshtimit nga e cila burojnë.

Nëse shfaqet ndonjë gabim dhe rrëshqitje e gjuhës, por në atë mënyrë që për këtë gabim pendohet dhe nuk këmbëngul në të, diçka të tillë më së miri është ta mbajmë të fshehtë dhe ta mbulojmë. E nëse në këtë gabim këmbëngulë, qoftë këmbëngulja e vogël a e madhe, e në mes teje dhe atij personi ekziston dashuri e madhe, miqësi dhe vëllazëri, pason gjykimi tjetër. Inshallah do të flasim për të, vetëm të theksoj

se ekziston mospajtim në mes të dijetarëve për këtë. Nëse nuk ka vëllazëri dhe miqësi të madhe mes jush, duhet treguar një gjurmë urrejtjeje, nganjëherë duke u distancuar dhe duke u larguar nga ai person, dhe me sa më pak shfaqje të konsideratës ndaj tij, dhe nganjëherë me shfaqje të përbuzjes dhe duke iu drejtuar vrazhdë atij. Kjo e fundit është më e vështirë se sa distancimi, dhe përdoret në përputhje me peshën e kundërshtimit.

Njëjtë është edhe me vepra; ekzistojnë dy shkallë:

Njëra është ndërprerja e ndihmës dhe shoqërimit me personin i cili këmbëngul në kundërshtim, dhe kjo është shkalla më e ulët.

Shkalla tjetër është angazhimi kundër tij dhe qasja aktive në prishjen e qëllimeve të tij, siç bëhet me armiqtë. Kundërshtimi duhet parandaluar për atë për të cilin është e mundur, por për atë të i cili nuk ka ndikim, nuk duhet munduar. Për shembull, njeriu pi alkool, dhe kërkon gruan me të cilën, nëse martohet, do të jetë i lumtur, për shkak të pasurisë, bukurisë dhe reputacionit, por kjo nuk do të lë ndonjë gjurmë pozitive sa i përket konsumimit të alkoolit, e nëse ti je në gjendje ose t'i ndihmosh në përmbushjen e dëshirës për martesë me atë grua ose t'ia prishësh qëllimin, në atë rast nuk është e drejtë të mundohesh për të prishur punë. Por, braktisja e ndihmës nuk është e mirë sepse mund të shfaqet dashuri në zemrën tënde për t'i ndihmuar atij, e kështu ndoshta dëgjon fjalën tënde dhe e braktis alkoolin. Të ndihmohet me këtë qëllim është mirë. Nëse një gjë e tillë nuk shfaqet, por ti pranon t'i ndihmosh në ndonjë detyrë vetëm në emër të Islamit, as kjo nuk është e ndaluar. Bile, një veprim i tillë është i mirë nëse gabimi i tij është ndaj teje, ose në lidhje me ty. Për këtë janë shpallur fjalët e Allahut Teala:

“Njerëzit e ndershëm dhe të pasur ndër ju të mos betohen se nuk do t’u japin të afërmve, të varfërve dhe të mërguarve në rrugën e Allahut; le t’i falin ata dhe të mos ua marrin për keq! Vallë, a nuk doni ju që t’ju falë Allahu? Allahu është Falës e Mëshirëplotë.” 24-Nur: 22

Mistah ibn Usasa kishte përgojuar Aishen r.a., e Ebu Bekri u betua se kurrë më nuk do ta ndihmojë, kurse i kishte ndihmuar vazhdimisht, prandaj u shpall ajeti i përmendur i cili thekson peshën e gjynahut të Mistahut. E, a ka gjynah më të madh se sa përgojimi i Aishes r.a., bashkëshortes së Resulallahut s.a.v.s.? Hazreti Ebu Bekri ishte drejtpërdrejt i goditur me këtë gjynah të Mistahut, por megjithatë e fali dhe përsëri vazhdoi ta ndihmojë.

Vlera e lartë është të falet dhe t'i bëhet mirësi atij që të ka bërë keq.

Sa i përket personit i cili nuk të ka bërë dëm ty por dikujt tjetër dhe me këtë ka shfaqur kryengritje ndaj Allahut Teala, nuk është mirë të shfaqet mirësi ndaj tij, sepse shfaqja e mirësisë ndaj zullumqarit nënkupton padrejtësi ndaj atij që i është bërë zullum (mazlum) e më e rëndësishme është të respektohen të drejtat e *mazlum*-it. Të hiqet mërzia e mazlumisit duke kundërshtuar zullumqarin është më e dashur te Allahu Teala se sa të turpërohet dhunuesi. E nëse të është bërë ty padrejtësi për ty më së miri është të falësh dhe ta kalosh atë situatë. Rrugët e gjeneratës së parë të myslimanëve (*selef*) ndahen në lidhje me shfaqjen e urrejtjes ndaj gjynahqarëve, por të gjithë pajtohen se duhet shfaqur urrejtje ndaj përdhunuesit, ndaj bidatçijve dhe ndaj secilit që është kryengritës, e me këtë gjynah godet edhe të tjerët. Por, janë në mospajtim me ata që dëmtojnë veten dhe që gjynahet ngelin me ta. Disa do të tregonin mëshirë ndaj tyre, e disa do t'i braktisin.

Ahmed ibn Hanbel do të braktiste personat e mëdhenj edhe për një fjalë, bile është distancuar nga Jahja ibn Mein vetëm se ky ka thënë: *“Nuk kërkoj asgjë prej askujt, por nëse edhe sulltani më sjellë e pranoj.”*

U distanca prej Haris Muhasibit për shkak se ai shkroi veprën *'Kundërshtimi i Mësimeve të Mutezilive'* dhe tha:

"Padyshim që së pari paraqite dyshimet e tyre (mutezilëve), pastaj i kundërshtove. Duke paraqitur dyshimet e tyre, i bëre njerëzit të fillojnë të mendojnë për to."

Imam Shafiu është larguar prej shokut (Ebu Sevr) pasi ka komentuar hadithin e Muhammedit s.a.v.s.:

"Vërtetë, Allahu e krijoi Ademin në pamjen e Vet."³⁶

Ky veprim është sipas qëllimit, e qëllimi është sipas gjendjes. Personi, duke menduar pafuqinë e njeriut dhe nënshtrimin e tij përcaktimit (kader), i toleron armiqësinë dhe urrejtjen. Dhe kjo është një arsytim, ani pse nganjëherë përngjanë edhe në lajkatim dhe shmangie nga përgjegjësia. Në përgjithësi, njerëzit në kryengritje i tërheq kjo shmangie nga përgjegjësia, si edhe preferimi sjelljes ashtu që të mos i prishet dëshira dhe të mos ofendohet tjetri. Nëse shejtani i mallkuar ua zbukuron budallenjëve këto mendime dhe bëhet shkak që këta të sillen ndaj të tjerëve me mëshirë, vlerësimi i kësaj është kjo: Pohon se personi është i detyruar në gjynah, dhe që nuk ia vlen të ruhesh nga caktimi (*kader*). Si mundet edhe ashtu, t'i iket caktimit, kur ai është i shkruar! Këto dhe pohime të ngjashme justifikojnë qëllimin e personit që të mbyll sytë ndaj gjynaheve që bëhen ndaj Allahut Teala. Këto janë mashtrime, me të cilat shërbehet shejtani i mallkuar, prandaj njeriut duhet tërhequr vëmendja në to.

Nëse thua: *"Shkalla më e ulët në shfaqjen e urrejtjes është largimi, distancimi, ndërprerja e shoqërimit dhe e ndihmës. Atëherë a është e obligueshme që plotësisht të largohemi nga personi që bën gjynah?"*, do të të përgjigjem:

³⁶ Shënon Muslimi, në transmetim të Ebu Hurejres r.a.

Nga ana e jashtme e diturisë (zahir), kjo nuk hyn në obligime. E dimë se ata që kanë pirë alkool dhe i janë dhënë shthurjes gjatë kohës së jetës së Pejgamberit s.a.v.s., dhe as'habëve, nuk i kanë braktisur plotësisht, por u janë qasur në mënyrë selektive – disa u janë drejtuar vrazhdë, disa kanë shfaqur urrejtje ndaj tyre, disa janë distancuar nga ato vepra, por jo edhe nga vet personi, e disa në ta kanë shikuar me keqardhje, nuk i kanë braktisur e as nuk janë larguar nga ta.

Këto janë finesa fetare rreth të cilave ndahen rrugët e udhëtarëve shpirtërorë (*salikun*) drejt ahiretit, prandaj reagimi i secilit prej tyre ka qenë përshtatshëm gjendjes dhe kohës së tyre. Në këso gjëra, gjendjet nganjëherë e cilësojnë situatën si të papëlqyer (*mekruh*), e nganjëherë si të lavdërueshme (*mendub*), kështu që cilësimi mbetet në përcaktimin e dallimeve, dhe nuk përfundon me vlerësime “e ndaluar” (*haram*) ose “e detyruar” (*vaxhib*). Si përkushtim llogaritet themeli i njohjes së Allahut Teala dhe themeli i të dashuruarit, me çka nënkuptohet dashuria e cila nuk kalon nga ajo që dashurohet në diçka tjetër. Si kalimtare llogaritet dashuria e pamasë dhe preokupimi me dashuri. Këto gjendje fare nuk përkasin në domenin e vendimeve ligjore (*fetva*) dhe obligimeve të jashtme, në rast se bëhet fjalë për njerëzit e zakonshëm (*avam*).

SHPJEGIM I GRADAVE TË ATYRE QË URREHEN DHE MËNYRAT E SJELLJES NDAJ TYRE

Mund të pyesësh: “Nëse nuk është obligim për të treguar urrejtje dhe armiqësi me vepër, atëherë ajo me siguri është e lavdërueshme (*mendub*). Tutje, kryengritja dhe gjynahet ndodhen në gradë të ndryshme, e si atëherë të veprohet në mënyra të ndryshme? A veprohet ndaj tyre njëjtë apo jo?”

Dije se ata të cilët i kundërvihen urdhërave të Allahut Teala, atë e bëjnë duke iu kundërvënë në besim, ose me vepra. Ai i cili i kundërvihet zbatimit të urdhërave të Allahut në besim (akide), ose është bidatçi ose pabesimtar (kafir). Bidatçiu ose fton njerëzit në bidat ose hesht; personi që hesht, atë e bën ose për shkak të pafuqisë së tij, ose nga vullneti i tij i lirë. Kështu, ekzistojnë tri lloje të besimit të gabuar.

LLOJI I PARË:

Gjendja e mosbesimit (*kufër*). Pabesimtarin, nëse është armik në luftë, është e lejuar ta mbysësh ose ta robërosh. Përpos këtyre dy mënyrave nuk ka një mënyrë të tretë të poshtërimit të tij. E sa i përket zimmije's (jomuslimanit të lirë që është nën mbrojtjen e shtetit islam të cilit i paguan taksa), nuk është e lejuar që të shqetësohet, përpos largimit nga ai, nënçmimit, mosrespektimit, dhe duke mos i dërguar selam. Nëse zimmija i tillë do të thoshte: "*Es-selamu alejkum*", duhet vetëm përgjigjur: "*Ve alejke*". Është prioritet që të përmbahesh nga shoqërimi me të, bërja e biznesit me të si dhe nga përfaqësimi i tij. E sa i përket të qenit i hapur ndaj tij, është e papëlqyer që t'i besosh atij siç i beson shokut. Mospëlqimi në këtë rast është aq i fortë sa mund të kalojë në ndalesë (haram). Allahu Teala thotë:

"Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre." 58-Muxhadela: 22

Muhammedi a.s. ka thënë:

"Zjarri i myslimanit dhe zjarri i idhujtarit (*mushrik*) nuk e shohin njëri-tjetrin."³⁷

³⁷ Ebu Davud dhe Tirmidhiu, transmetuar nga Xheriri. E shënon edhe Nesa'i. Buhariu thotë që ky transmetim është i besueshëm (sahih).

Allahu Teala thotë:
“O besimtarë, mos i bëni miq armiqtë e Mi dhe tuaj.” 60-Mumtehine:1

LLOJI I DYTË:

Bidatçiu i cili fton në bidate të veta. Nëse këto bidate e dërgojnë në qyfer, atëherë rasti i tij është më i keq se rasti i zimmijes, pasi që një person i tillë nuk paguan taksa (*xhizja*) dhe nuk mund të arsyetohet me marrëveshjen për zimmijën. E nëse bidati nuk bëhet shkak i qyfit, atëherë rasti i tij është rast në mes tij dhe Allahut Teala, sigurisht shumë më i lehtë se rasti në mes të qafirit dhe Allahut Teala. Por, më me rëndësi është të refuzohet i tilli se sa të refuzohet qafiri, sepse e keqja e qafirit nuk kalon te tjetri. Myslimanët janë të bindur në mosbesimin e tij, nuk motivohen nga fjalët e tij, sepse ai nuk thërret në Islam dhe në të vërtetën. Kurse bidatçiu i cili fton në bidat, beson se ajo në çka ai fton është e vërtetë, çka është arsye për gabimin e tij në lidhje me të vërtetën, prandaj edhe e keqja e tij përhapet ndër myslimanë. Karshi kësaj është e lavdërueshme (*mustehab*) të tregohen armiqësia, ngurrimi, përbuzja – të flasësh kundër tij për shkak të bidateve dhe njerëzit ta urrejnë atë. Nëse bidatçiu është vetëm dhe jep salam, nuk ka asgjë të keqe të përgjigjesh me salam. Në qoftë se nuk e shikon atë dhe nuk interesohesh për atë, e ai kupton që kjo gjendje është për shkak të bidateve të tij, dhe me këtë i jepet mundësia të braktis bidatet – mos të kthehet selami është më mirë. Sepse sa është e obligueshme të kthehet selami, në disa kushte ky obligim humb natyrën obliguese, si kur ndodhet në tualet ose diku tjetër duke kryer nevojë fiziologjike. Ndërkaq, qëllimi për të penguar atë nga bidatet është më i rëndësishëm. Nëse bidatçiu i jep salam dikujt deri sa është në shoqëri, është më e rrugës që të mos i përgjigjet me salam, në mënyrë që njerëzit tjerë të neveriten me të, dhe të përbuzin bidatin në të cilin ai fton. Ky prioritet i mos-përgjigjes përfshinë edhe mos-ndihmën, sidomos nëse të tjerët e shohin këtë.

Muhammedi a.s. thotë:

“Kush kundërshton bidatçinë, Allahu do t’ia mbush zemrën me besim dhe siguri. Kush nuk i beson bidatçisë, Allahu do t’i japë siguri në ditën e frikës më të madhe. E kush është i butë me të, i shpreh respekt dhe e pret me gëzim, ka nënvlerësuar atë që Allahu i ka shpallur Muhammedit (a.s).”³⁸

LLOJI I TRETË:

Bidatçiu i cili është njeri i rëndomtë (avam). Ky është ai person i cili nuk është në gjendje të ftojë, prandaj nuk ka as frikë nga përshtatja atij, prandaj edhe rasti i tij është shumë më i lehtë. Më e rëndësishme është të mos shprehet mospajtimi me të përmes të folurit të keq dhe poshtërimit. Aq më shumë, më mirë është që me të të silltë butë, përmes këshillimit, sepse zemrat e shumicës së njerëzve kthehen shumë lehtë. Nëse këshillimi nuk është i dobishëm, atëherë distancimi nga ai është i lavdërueshëm (*mustehab*). Nëse je i sigurt se as nga kjo nuk do të ketë dobi, për shkak që zemra e tij është errësuar dhe besimi në atë bidat i është ngulitur fuqishëm në zemër, më e drejtë është distancimi nga ai, të mos i jepet vlerë dhe respekt. Sepse nëse bidati nuk qortohet fuqishëm në mesin e popullit, ai do të përhapet, e me këtë edhe dëmi i tij do të bëhet më i gjerë.

E kur bëhet fjalë për besimtarët e qëndrueshëm, të cilët kryengritjen e shprehin përmes veprës; edhe këta ndahen në tre:

1) Prej veprave të këqija të tyre dëmtohen (edhe) të tjerët, përmes dhunës (*zulm*), grabitjes, të folurit të paturpshëm, përgojimit, gënjeshtres, dëshmisë së pavërtetë, mbjelljes së ndasive në mes njerëzve, bartjes së fjalëve të huaja me qëllim të keq, dhe të ngjashme.

³⁸ Ebu Nuajm, në veprën e tij *‘Hilje’*, Herevi në veprën *‘Zemmul-kelam’*, Ibn Omer r.a.

2) Me vepra të këqija i dëmtojnë (edhe) të tjerët; edhe këtë e bëjnë me ftesë në vepra të këqija si organizimi i mbledhjeve në një vend i meshkujve dhe femrave, dhe nxitja në pirje të alkoolit.

3) Nuk ftojnë të tjerët në bërjen e veprave të veta të ndyra, si rasti i atij që pi alkool dhe bën kurvëri (*ziná*). Veprat me të cilat tjetri nuk ftohet në të keqe të njëjtë mund të jenë në formë të gjynaheve të mëdha dhe në formë të gjynaheve të vogla.

Secila nga këto forma, prapë, mund të jetë diçka për çka këmbëngulet ose diçka për të cilën nuk këmbëngulet. Të gjitha këto dallime mund të grupohen në tri lloje, me atë që secili prej tyre ka gradat e veta të ndryshme – disa janë më të mëdha se tjerat.

Lloji i parë: kjo është më e keqja, për shkak se i bën dëm njerëzve, siç është dhuna, grabitja, shturja, përgojimi, bartja e fjalëve të huaja. Prioritet është distancimi nga ta, mos-përzjerja me ta, mos-marrja pjesë në asnjë veprim të keq me ta. Sepse kryengritja që i dëmton krijesat është vepër e rëndë, si ushtrimi i dhunës fizike, mbytja, grabitja e pronës dhe sulmi në ndershmëri, dhe ndahet në disa pjesë, që edhe prej tyre, njëra është më e dhunshme se tjetra. Largimi dhe distancimi nga këta gjynahqarë është obligim i fortë. Sa më e madhe përbuzja ndaj tyre me qëllim që kjo të ndikojë në drejtim të parandalimit të veprave që ata i bëjnë, obligimi i aplikimit të përbuzjes është më i madh dhe më i fuqishëm.

Lloji i dytë: janë ata që organizojnë ndeja me pirje të alkoolit, me meshkuj dhe femra përzjer, duke nxjerrë ngjarje të turpshme dhe i lehtësojnë asaj kalimin te njerëzit. Këta të pamoralshëm nuk i dëmtojnë njerëzit kur është në pyetje jeta e tyre dhe prona, por ia shkatërrojnë fenë. Dhe nëse kjo ndodh me miratimin e tyre - përfundimi është shkatërrimi. Ky lloj, edhe pse është afër të parës, është më e padëmshme se

sa e para. Sepse gjynahet e bëra pa sulm në jetë dhe pronë, janë gjendje më e lehtë se e para, dhe mes të robit dhe Allahut Teala mund të falet, por nëse kalon te tjetri, atëherë është më e rëndë. Kjo gjithashtu kërkon nënçmim, distancim, ndërprerje të lidhjeve dhe ndërprerje të dhënies së selamit. Nëse ekziston mundësia për të braktisur, ai ose të tjerët këtë të keqe, patjetër duhet aplikuar këtë masë parandaluese.

Lloji i tretë: Kur personi e dëmton veten, por jo edhe të tjerët ashtu që pi alkool, i braktis obligimet, ose kënaqet në diçka që e ka të ndaluar (me shariat). Gjynahu i këtij lloji është më i lehtë, por njëkohësisht nëse vjen deri te kjo, është obligim që në këtë të pengohet me atë që më së miri funksionon, qoftë edhe fizikisht (me goditje) ose me shfaqjen e përbuzjes. Arsyetim për këtë gjejmë në faktin se largimi nga ajo që është e ndaluar (*nehj anil-munker*) është vaxhib.

Nëse pas bërjes së gjynahut, kuptohet që po insiston dhe mendohet se këshillimi sigurisht do t'i ndihmonte, atëherë këshillimi bëhet i obliguar. Nëse megjithatë nuk duket sikur këshillimi do të tregohet i suksesshëm, por njeriu megjithatë shpreson në të, përsëri këshillimi është në nivel të obligimit, si edhe parandalimi, sipas aftësisë së tij - me të mirë ose me ashpërsi, po të ishte kjo më e dobishme. Lidhur me çështjen e mos-kthimit të selamit dhe ndërprerjen e shoqërimit me atë person, nëse dihet që personi edhe më tutje do të këmbëngul në gjynahe dhe që këshillimi nuk do të ndihmojë, qëndrimet e dijetarëve dallojnë. Më e drejta është që kjo dallon sipas qëllimit të personit. Për gjendje të tilla thuhet: "*veprat vlerësohen sipas qëllimeve*", sepse të sillesh ndaj tyre me butësi dhe dhembshuri është një lloj modestie, derisa në ashpërsi dhe distancim ka një lloj egërsie. Në këto çështje vendos zemra. Më e vlefshme është të bëhet e kundërta nga ajo që i përshtatet dëshirave tua (nëfsit) sepse poshtërimi, përbuzja dhe ashpërsia mund të

eksponojnë mburrjen, vetëpëlqimin, madhërinë dhe bëjnë që njeriu të ekspozojë veten si të ndershëm, kurse me sjellje të butë dhe dhembshuri mund të vijë frika që po e strehon, dhe po humb ndihmën e tij. Të gjitha këto janë vesvese të shejtanit dhe janë larg nga veprat e njerëzve të ahiretit. Ai që është dhënë pas fesë gjithmonë është në luftë me veten përmes hulumtimit të hollësive të përmendura dhe përmes testimit të gjendjeve të ndryshme. Zemra gjykon - herë ia qëllon me vendim, e herë gabon; nganjëherë i përshtatet dëshirës së vet, e mendon që këtë e bën për Allahun dhe mashtrohet. Inshallah do të flasim për këto hollësi në librin për mashtrimet, në pjesën kushtuar gjërave që çojnë në vetëpëlqim '*Rub'ul-Muhlikat*'.

Një transmetim vërteton që duhet të merret qëndrim i butë ndaj gjynahqarit për gjynahun që e prek vetëm atë. Njëri që pinte verë u dënua për këtë disa herë para Resulallahut s.a.v.s., por përsëri iu kthye pijes. Dikush prej as'habëve tha:

"Allahu e mallkoftë, sa shumë pi!" Muhammedi a.s. i tha:
"Mos i ndihmo shejtanit kundër vëllait tënd."³⁹

Kjo është shenjë që mëshira ka përparësi ndaj ashpërsisë.

CILËSITË E NEVOJSHME TE PERSONI ME TË CILIN DËSHIRON TË SHOQËROHESH

Beso, nuk është mirë të shoqërohesh me secilin. Muhammedi a.s. thotë:

"Njeriu është në fenë dhe ahlakun e shokut të tij të ngushtë, prandaj keni shumë kujdes kë po e zgjidhni për shok të ngushtë."⁴⁰

³⁹ Buhariu nga Ebu Hurejre r.a.

Njeriu duhet të kërkojë disa veti nga personi me të cilin do të shoqërohet. Këto veti duhen të jenë kushtet për arritjen e dobive të dëshiruara nga shoqërimi.

Nga miqësia kërkohen dobi për fe dhe jetë. Dobitë për jetë janë përfitimi nga pasuria ose reputacioni, ose afërsi e thjeshtë në kuptimin e të qenit bashkë për argëtim, kjo nuk është qëllimi ynë.

Dobia për fe përfshinë qëllime të ndryshme, në të cilat bën pjesë edhe dobia nga dituria dhe vepra, nga reputacioni i cili personin e siguron nga ajo që shqetëson zemrën dhe nga ajo që pengon në vazhdimësinë e ibadeteve. Më pas, dobia nga pasuria me qëllim që njeriu të ruhet nga humbja e madhe e kohës në fitimin e furnizimit. Këtu bën pjesë edhe ndihma me qëllim që të evitohen problemet në situata të ndryshme. Tutje, bekimi përmes bërjes së duasë dhe pritja e shefatit në Ditën e Gjykimit.

Gjeneratat e para të myslimanëve kishin zakon të thoshin:

“Rrite numrin e shokëve, sepse secili besimtar ka (të drejtë në) një shefat, e që, inshallah e arrin shefatin e shokut tënd.”

Në garib-tefsiret (komentimet e pazakonshme dhe unike të Kur’anit) është shënuar komenti i ajetit:

“Ai u përgjigjet lutjeve të atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira dhe nga mirësia e Vet, ua shton atyre të mirat.” 42-Esh-Shura: 26.

Në komentimin e pjesës së ajetit **“ua shton atyre të mirat”** thuhet: *“Ata që besojnë do të bëjnë shefat për vëllezërit e vet, dhe së bashku do të hyjnë në Xhenet.”*

⁴⁰ Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Hakimi, nga Ebu Hurejre r.a.

Thuhet se kur Allahu e fal robin, i falë edhe vëllezërit e tij. Prandaj shumica e as'habëve inkurajonin në miqësi, afrim dhe shoqëri, dhe nuk e donin vetminë dhe izolimin.

Secila nga këto dobi kërkon kushte, dhe vetëm përmes tyre mund të arrihet te to, assesi ndryshe. Do t'i shpjegojmë këto kushte në detaje. Në përgjithësi, këto kushte janë: ai me të cilin dëshirohet të shoqërohet duhet t'i ketë pesë veti:

(1) të jetë i mençur, (2) me ahlak të mirë, (3) të mos jetë gjynahqar, (4) të mos jetë bidatçi, dhe (5) të mos jetë i pangopur pas kësaj bote.

1) Të jetë i mençur. Mendja është pasuri dhe esencë; nuk ka hair (dobi) në shoqërim me të pa-mençurin (budallanë) e të pakuptueshmin, sepse shoqërimi me atë person, sado që të zgjasë, në fund përfundon me hidhërim dhe ndarje.

Hazreti Alia r.a., ka thënë:

“Mos u shoqëro me të paditurin (xhahilin), ruaje veten nga ai. Sa shumë ka të padijshëm që i shkatërrouan shokët e mençur. Njeriu matet me shokun, çdo krijesë ka një masë ngjashmërie me krijesën tjetër. Kur takohen zemrat, dëshmojnë njëra- tjetrën.”

I padituri të bën dëm, edhe nëse dëshiron të jetë i dobishëm dhe të ndihmojë.

Prandaj poeti ka thënë:

“Nga armiku i mençur nuk frikësohem, por nga miku i padijshëm po. Mendja është një fener dhe rrugën e ka çel në mejdan, por padituria është lloj-lloj.”

Për këtë arsye është thënë:

“Largimi nga i padituri është afrim tek Allahu.”

Sufjan Sevri ka thënë::

“Shikimi i vazhdushëm i fytyrës së të paditurit është gabim.”

Me ‘njeriu i mençur’ nënkuptojmë personin i cili mund të kuptojë çdo gjë siç është, ose - kur shpjegohet diçka, e pranon atë.

2) Ahlaku (moral) i mirë është i domosdoshëm, ngase ka shumë njerëz që i kuptojnë gjërat siç duhet, por veprojnë kundër ditorisë së vet dhe i përshtaten dëshirave të veta për shkak që nuk kanë mundur të përmirësojnë cilësitë dhe ahlakun. I tilli, kur zemërohet nuk mund të frenojë zemërimin, epshi e kaplon, koprracia ose frika e mundin. Ai madje shmanget nga rruga e drejtë, prandaj nuk ka dobi në shoqërim me një person të tillë.

3) Të mos jetë gjynahqar. Kur bëhet fjalë për gjynahqarin i cili këmbëngulë në kryengritje, prapë, shoqërimi me të nuk ka kurrfarë dobie, sepse ai që i frikësohet Allahut Teala nuk këmbëngul në bërjen e gjynaheve të mëdha e kush nuk i frikësohet Allahut Teala, atij nuk i besohet, askush nuk është i sigurt nga fatkeqësia e tij dhe nuk mund të mbështetet në sinqeritetin e tij. I tilli për të realizuar qëllimet anon në çdo anë.

Ndërsa Allahu Teala thotë:

“...Mos dëgjo atë, zemrën e të cilit ia kemi lënë mospërfillëse ndaj përmendjes Sonë e që shkon pas dëshirave të veta...” 18-Kehf: 28

Kurse në ajetin tjetër:

“Prandaj, mos e lër atë që nuk beson në të (Ditën e Kiametit) dhe që jepet pas epsheve të veta, të të nxjerrë (nga rruga e drejtë), përndryshe do të humbisje.” 20-Ta Ha: 16

E në ajetin e njëzet e nëntë të sures Nexhm thuhet:

“Andaj, ti largohu prej atij që i ka kthyer shpinën Kur’anit dhe që nuk do tjetër vetëm jetën e dynjasë!”

53- Nexhm: 29

Në suren Llukman, thuhet:
“...dhe ndiq rrugën e atij që drejtohet tek Unë me devotshmëri...” 31-Llukman: 15

Me të gjitha këto ajete ndalohej shoqërimi me gjynahqarin.

4) Të mos jetë bidatçi. Sa i përket atij i cili në fe sjell bidat (risi), shoqërimi me të realisht hap mundësitë e përfshirjes në bidate. Bidatçiu meriton që nga ai të iket dhe të ndërpritet çdo marrëdhënie me të. E cilat janë pasojat e shoqërimit me të?

Hazreti Omeri r.a., siç transmeton Seid ibn el-Musejjeb, duke inkurajuar në besimin si kusht për të zgjedhur dikë si shok të afërt me të cilin shoqërohet, ka thënë:

“Zgjedh shokë të sinqertë. Jeto nën mbrojtjen e tyre, sepse të tillët janë zbulim në paqe, dhe ndihmë në telashe. Kryeje punën e shokut në mënyrën më të mirë, që në rast nevojë të ta kthejë në mënyrë edhe më të mirë. Largohu nga armiku yt, mos u lidh me secilin si shok, pos nëse është nga të besueshmit. E nuk ka besueshmëri përpos te ai që i frikësohet Allahut Teala. Prandaj mos u shoqëro me njerëzit e këqij sepse do të të fusin në të këqijat e veta. Mos ia zbulo fshehtësinë tënde, sepse e përhapë. Këshillohu dhe udhëzohu me ata që i frikësohen Allahut Teala.”

Kur bëhet fjalë për sjelljen e mirë (ahlakun), të gjitha i ka thënë Alkame el-Utaridi të birit, kur iu pat afruar vdekja. Ai pat thënë:

“Biri im, nëse do të kesh dëshirë të shoqërohesh me dikë, shoqërohu me atë i cili, nëse i ndihmon – nuk do të keqpërdorë por do të të mbrojë, me të cilin përmes shoqërimit do të zbulohesh, i cili, nëse ke nevojë - do të të vijë në ndihmë.

Shoqërohu me atë i cili, nëse ti e zgjat dorën për të mirë – edhe ai do ta zgjasë të veten, i cili, nëse te ti sheh ndonjë të mirë – do ta shtojë atë, e nëse te ti sheh diçka të keqe – do ta

largojë atë. Shoqërohu me atë i cili, nëse i kërkon diçka – do të të japë, nëse ti hesht – i pari do të të flasë, nëse je i pikëlluar – ai do të të disponojë.

Shoqërohu me atë i cili do të vërtetojë fjalët tua, i cili të jep ty përparësi, i cili do të të shpreh nderimet në kohët kritike.”

Në porosinë e tij, Alkame e ka përmbledhur gjithë kuptimin e shoqërimit, dhe ka përmendur kushtin që personi duhet t'i përmbahet të gjitha këtyre. Lidhur me fjalët e Alkames, Ibn Etemi tregon: *'Halife Me'mun-i ka pyetur:*

- Po ku ka të tillë?, e dikush i tha:

- A e di pse ai e ka porositur të birin kështu? Me'mun-i u përgjigj:

- Nuk e di. E ky i tha:

- Sepse ka dashur që i biri me askënd të mos shoqërohet.

Për arsye se për të gjetur një person me këto cilësi është shumë vështirë'.

Një njeri, orator dhe i dijshtëm, ka thënë:

“Shoqërohu vetëm me atë i cili e mbulon fshehtësinë tënde dhe e fsheh të metën tënde. Me atë i cili do të jetë pranë teje në fatkeqësi, i cili do t'i plotësojë dëshirat, do ta rritë mirësinë tënde, e do të fshehë gjynahet tua. Nëse nuk gjen shok të tillë, atëherë shoqërohu vetëm me veten tënde.”

Hazreti Alia r.a., ka thënë:

“Dije se vëlla të vërtetë e ke atë që është gjithë me ty. Për të të ndihmuar ty, vet i duron vështirësitë. Ai që kur përballesh me telashe dhe fatkeqësi, i jep të gjitha nga vetja.”

Disa dijetarë thonë:

“Shoqërohu vetëm me këta dy njerëz: me atë nga i cili mund të mësosh diçka për fenë, që do të të jetë e dobishme, ose me atë të cilin ti mund ta mësosh diçka për fenë, e që kjo të bëhet e dobishme për të. Nga një i tretë – ik!”

Disa kanë thënë:

“Janë katër lloje njerëzish: një lloj janë krejtësisht të ëmbël – nuk mund të ngopesh me ta. Lloji i dytë janë krejtësisht të hidhët, prej tyre nuk të hahet. Lloji i tretë janë të thartë, merr nga ata para se ata të marrin nga ti. Dhe lloji i katërt janë të kripur - nga ta merr vetëm kur të duhet.”

Xhafer Sadiku r.a. ka thënë:

“Mos u shoqëro me pesë njerëz: me gënjeshtarin, nëse i beson - do të të mashtrojë. Ai është si fatamorgana: çka është larg – ta paraqet si afër, dhe çka është afër – ta paraqet si larg. Tutje, mos u shoqëro me budallain (ahmak). Nga ai s’ke kurrfarë dobie – ai dëshiron të të ndihmojë, por në fakt të dëmton. Mos u shoqëro me koprracin, sepse ai nuk ta jep atë që ke nevojë. Mos u shoqëro me frikacakun - ai është i afërt me ty, por ikë sapo të lajmërohet ndonjë telashe. Mos u shoqëro me gjynahqarin (fasik), sepse ai të shet për një kafshatë, bile edhe për më pak.” Dikush pyeti:

“Çka bëhet edhe për më pak?” Xhafer Sadiku u përgjigj:

“Ai të shet duke shpresuar një kafshatë, pastaj as atë kafshatë nuk e përfiton.”

Xhunejd Bagdadi ka thënë:

“Më i mirë më vjen shoqërimi me gjynahqar por me ahlak të bukur, se sa shoqërimi me abidin (ai që bën ibadet shumë), e me ves të keq.

Ahmed b. Havari ka thënë:

“Mësuesi im, Ebu Sulejman, më ka thënë: ‘O Ahmed, shoqërohu vetëm me këta dy persona: me atë prej të cilit do të kesh dobi në këtë jetë, dhe me atë prej të cilit do të kesh dobi për ahiret.’ Të humbet kohë me këdo tjetër pos të këtillëve, është marrëzia më e madhe.”

Sehl ibn Abdullah ka thënë:

“Largohu nga shoqërimi me tre njerëz: nga gafili (i pavëmendshmi) mizor, nga dijetari hipokrit dhe dervishi i paditur.”

Të kesh kujdes, shumica e qëndrimeve të cituara nuk i përfshijnë të gjitha synimet e shoqërimit. Ato përfshijnë, siç thamë më herët, vetëm të menduarit e synimeve dhe respektimin e kushteve sipas qëllimit të shoqërimit. Sepse kushtet e domosdoshme për shoqërim i cili ka për qëllim dobitë për dynjallëk nuk janë identike me kushtet e shoqërimit të cilat kanë për qëllim ahiretin, e as me kushtet e vëllazërisë. Siç do të thoshte Bishri:

“Ka tri lloje vëllazërisë: vëllai për ahiret, vëllai për dynjallëk dhe vëllai i sohbetit (shoqërimit).”

Shumë rrallë është të gjenden këto tri cilësi të vëllazërisë te një person. Ndoshta këto cilësi gjenden të ndara te personat. Sipas kësaj, edhe kushtet e kërkuara janë të ndara. Cilësia që kërkon vëllazërimi për mirëkuptim janë ndaras, edhe cilësitë që kërkon vëllazëria për ahiret janë tjera.

Halife Me'mun-i ka thënë:

“Janë tre lloje vëllazërisë: një lloj është si ushqimi i trupit, siç nuk mundet trupi pa ushqim, edhe njeriu nuk mundet pa atë. Lloji i dytë është si ilaçi, të nevojiten kohë pas kohe. Lloji i tretë janë si sëmundja, aspak nuk të nevojiten, por robi përmes tyre sprovohet. Shokut të tillë as nuk duhet t'i afrohem, e as nuk mundet të përfitohet nga ai.”

Thuhet se njerëzit janë si drunjtë dhe bimët. Disa prej tyre kanë hije, por nuk kanë fryt. Të tillët janë të dobishëm në këtë botë, por jo edhe në ahiret, sepse dobia e dynjallëkut është si hija e cila shpejt kalon. Të tjerët, kanë fryt por nuk kanë hije. Nga të tillët ke dobi në ahiret, por jo edhe në dynjallëk. Disa kanë edhe fryt edhe hije. Njeriu i tillë është i dobishëm edhe në dynja edhe në ahiret. E disa të tjerë në

asnjërin; ata janë si gjembat - kur afroresh të shqyejnë rrobat, e për punë tjetër nuk vlejnë. Ata ngjajnë me kafshë, si minjtë dhe akrepat. Kështu, Allahu Teala thotë:

“Ata i luten asaj, dëmi i së cilës është më i afërt se dobia. Sa ndihmëtar e shok i keq!” 22-Haxh: 13

Një poet thotë:

*Njerëz vërtet të shumëllojshëm ka,
Në këtë bindesh kur t'i sprovosh,
Asnjëri nuk është i njëjtë me tjetrin-
Shiko pemën që të kuptosh.
Njëra fryt në vete ka,
Kur e shijon ëmbël, sheqer,
E tjetra, hiç asgjë nuk ka
Nga ajo fryt as shije s'merr.*

Nëse nuk gjen shok me të cilin vëllazërohesh, e nga ai të kesh dobi, vetmia është më e mirë. Ebu Dherri r.a. thotë:

‘Vetmia është më e mirë se shoku i keq, e shoku i mirë është më mirë se vetmia.’ Ky transmetim shënohet si fjalë e Muhammedit a.s..

Lidhur me besimtarin i cili nuk është gjynahqar, Allahu Teala thotë:

“E ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer kah Unë.”

31-Llukman: 15

Duke u shoqëruar me njerëzit e këqij (gjynahqarë), njeriu bëhet edhe vet i keq. E humb ndjenjën e urrejtjes ndaj të keqës. Kështu që Seid b. Musejeb ka thënë:

“Mos shikoni tiranin, i humbni mirësitë.”

Pra, nuk ka kurrfarë mirësie në shoqërim me njerëz të tillë. Shpëtimi është në ndërprerjen e lidhjeve me ta. Allahu Teala thotë:

“...kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen:

“Paqe qoftë!” 25-Furkan: 63

Këtë deshëm të përmendim në lidhje me kuptimin e fjalës “vëllazëri”, dhe kushtet që e përcjellin, si edhe dobitë. T’u kthehemi tash rregullave dhe obligimeve të tyre, si dhe mënyrave të realizimit.

5) Të jetë i pangopur pas kësaj bote. Në lidhje me personat e pangopur nga kjo botë, shoqërimi me ta është bars me pirjen e helmit të rrezikshëm për jetë, sepse natyra e njeriut është e tillë që njeriu ka dëshirë të bëjë si tjetri, të imitojë, bile – një natyrë vjedh nga tjetra, e që personi të mos e dijë. Ndeja me të pangopurin me dynjallëk e lind pangopurinë kurse ndeja me personin zahid (i cili heq dorë edhe nga bukuritë e lejuara të kësaj bote), e prenë animin kah kjo botë. Prandaj nuk është i pëlqyer shoqërimi me ata që vrapojnë pas dynjallëkut, kurse është i lavdërueshëm shoqërimi me ata që veprojnë për botën tjetër.

Hazreti Alia r.a. ka thënë:

“Gjallëroni veprimet, duke u shoqëruar me personin që turpërohet.”

Ahmed ibn Hanbel ka thënë:

“Nuk më ka gjetur sprovë më e madhe se sa shoqërimi me atë i cili nuk ka turp.”

Llokman Hakimi duke i dhënë këshillë të birit, ka thënë:

“Biri im, qëndro me të dijsmit, bashkohu me ta mirë, sepse ata i gjallërojnë zemrat me urtësi, ashtu siç ngjallet toka e vdekur nga të reshurat e bollshme.”

MBI RREGULLAT E VËLLAZËRISË DHE SHOQËRIMIT

Dije se vëllazëria bashkon dy persona, ashtu siç bashkon martesë qiftin bashkëshortor. Ashtu siç kërkon martesë që të respektohen të drejtat e caktuara, me qëllim që martesë të jetë e vlefshme, për çka kemi folur në *“Librin për rregullat e jetës martesore”* ashtu edhe vëllazëria kërkon të drejtë të caktuara. Ti ke përgjegjësi ndaj vëllait tënd, respektivisht, vëllai yt ka të drejtë të ti sa i përket pasurisë dhe personalitetit tënd; në lidhje me gjuhën dhe zemrën ka të drejtë të cilat reflektohen në fjalë të mira, këshillë, mirësjellje dhe dua (lutje), nderim dhe nderim, lehtësim, si dhe në ikje nga hipokrizia dhe mbingarkesa. Të gjitha obligimet mund të përmbledhen në tetë të drejtë:

E DREJTA E PARË RREGULLORJA PËR PASURI

Muhammedi a.s. thotë:

“Shembulli i vëllazërisë është i njëjtë me shembullin e dy duarve që e pastrojnë njëra tjetrën.”⁴¹

Janë krahasuar me dy duar, jo me dorën dhe këmbën, sepse duart ndihmohen mes vete në arritjen e qëllimit të përbashkët. Njëjtë është edhe me vëllazërinë - ajo kompletëhet nëse vëllazërit bashkohen në arritjen e ndonjë qëllimi. Në njëfarë mënyre, ata veprojnë si një person, dhe ky bashkim duhet të ekzistojë gjithmonë, në të mirë dhe në telashe, kur është në pyetje pasuria dhe situata të ndryshme të jetës.

⁴¹ Hadithin e kemi përmendur në kapitullin e mëparshëm.

Ndihma materiale mes vëllezërve ka tri shkallë.

Shkalla më e ulët është që ti ta pranosh atë si shërbëtor dhe nga teprica e pasurisë tënde, ta ndihmosh. Kur dëgjon që ka nevojë për diçka, nëse ti e ke mundësinë, domosdo ia plotëson nevojën, pa pritur që ai të kërkojë. Sepse të detyrohet vëllai të kërkojë, është një mangësi e madhe e vëllazërisë.

Shkalla e dytë, është që vëllanë ta shikosh në nivel tëndin, ta pranosh si ortak në pasurinë tënde, nëse duhet – edhe të ndash pasurinë me të. Hasani Basriu ka thënë:

“Ai që është vëlla për Allahun, e copëton mantelin në dy pjesë që ta ndajë me vëllezërit.”

Shkalla e tretë, është shkalla më e lartë. Vëllazërisë i jep përparësi në krahasim me veten, nevoja e tij të është më e rëndësishme se e jotja. Kjo është shkalla e të sinqertëve (*siddikun*), dhe është shkalla e fundit e dashurisë për Allahun. Fryt i kësaj shkalle është që edhe jetës së tij i jep përparësi në krahasim me tënden. Siç transmetohet, një grup dervishësh erdhën para një halifeje, e halifeja urdhëroi që t’u prehen kokat. Në mesin e dervishëve gjendej edhe Ebu’l- Hysejn en-Nuri. Ai doli para të tjerëve që atë ta vrasin të parin. U pyet pse veproji ashtu, e ai tha:

“Dua që vëllezërit e mi të jetojnë më gjatë.” Kjo u bë arsye që të gjithë të shpëtojnë, gjë që është e përshkruar në një tregim më të gjatë.

Nëse nuk e gjen veten në asnjërën nga këto shkallë, dije se lidhja jote vëllazërore nuk ka dhënë fryte në vet brendësinë. Marrëdhënia mes jush rrjedh vetëm sipërfaqësisht, e nuk ka sinqeritet. Kuptohet se kjo marrëdhënie nuk ka asnjë rrëndësi nga pikëpamja e fesë dhe mendjes. Mejmun ibn Mihran ka thënë:

“Kush kënaqet me atë që mos t’i jap vëllazërisë përparësi, le të vëllazërohet me të vdekurit.”

Sa i përket vëllazërisë vetëm për këtë botë, ajo nuk është shumë e vlefshme te besimtari. Transmetohet se Utbetu'l Gulam erdhi te një njeri me të cilin ishte vëllazëruar dhe i tha:
- *Më duhen katërmijë dërrhemë nga pasuria jote.* Ky i tha:
- *Merri dymijë.* Utbetu'l-Gulam refuzoi këtë, dhe i tha:
- *Ti preferove këtë botë ndaj kënaqësisë (rizasë) së Allahut Teala. Pa turp the që e pranove vëllazërimin për Allahun dhe the: 'Ky është vëllai im.'* Pastaj u largua prej tij.

Kush gjendet në këtë nivel të dynjallëkut, me të mos të bëhet asnjë punë e kësaj bote.

Edhe Ebu Hazim ka thënë:

"Nëse ke vëlla për Allahun, mos u lësho me të në punë të kësaj bote." Këtu është menduar në atë që në lidhje me vëllazërinë është në nivel të kësaj bote.

E sa i përket shkallës më të lartë, kështu Allahu Teala i përshkruan ata:

"...dhe këshillohen për punët e veta me njëri-tjetrin; ndajnë prej asaj që u kemi dhënë Ne;" 42-Esh-shura: 38

pra, janë bashkë në të gjitha situatat, nuk ndahen nga njëri-tjetri. Në mesin e tyre ka qenë edhe njëri i cili nuk ka dashur të shoqërohet me atë që ka thënë *"nallanja ime"*, sepse i tilli ka marrë diçka vetëm për vete.

Fetu'l-Musili erdhi në shtëpinë e vëllait të vet, e ky nuk ishte aty. Fetu'l-Musili urdhëroi familjarët që t'i nxjerrin valixhen me pasuri të pronarit të shtëpisë (vëllait të tij në fe). Familjarët ia dhanë, ai e hapi e mori çka iu desh. Shërbëtorja njoftoi pronarin e vet se çfarë kishte ndodhur, e pronari tha:

"Nëse e ke thënë të vërtetën, je e lirë", i lumtur me atë që kishte ndodhur.

Një njeri erdhi te Ebu Hurejre r.a. dhe i tha:
- *Dua të vëllazërohem me ty. Ebu Hurejre r.a., e pyeti:*
- *A e di ti cilat janë të drejtat e vëllezërve?*
- *Më mëso, i tha ky. Ebu Hurejre r.a., i tha:*
- *Të mos i japësh vetes përparësi në krahasim me mua në dinarë dhe dërhëmë.*
- *Unë nuk jam ende në atë gradë, e pranoi vizitori.*
- *Atëherë largohu, i tha Ebu Hurejre r.a..*

Ali ibn Husein r.a. i tha njërit:
- *A ka ndodhur që dikush nga ju të fus dorën në xhepin e vëllait dhe të marrë atë që i nevojitet, pa pyetur? Personi tha:*
- *Jo. Huseini r.a. tha:*
- *Atëherë nuk jeni vëllezër.*

Disa njerëz hynë te Hasan Basriu dhe i thanë:
- *O Hasan, a ke falur namazin? Ai u përgjigj:*
- *Po, e kam falur. I thanë:*
- *Tregtarët ende nuk e kanë falur. Hasani tha:*
- *E kush mund të marrë nga tregtarët atë që i takon? Dhe vazhdoi:*
- *Ata nuk ndimojnë shokët as me një dërhëm.*

Ibrahim Ed'hemi, Allahu e mëshiroftë, ishte përgatitur të niset për Jerusalem (*Bejtul-makdis*). I erdhi një njeri dhe i tha:
- *Dua të të bashkohem në rrugë. Ibrahim i tha:*
- *Po, me një kusht – që në pasurinë tënde edhe unë të kem të drejta si ti.*
- *Jo, këtë nuk mundem të pranoj, u përgjigj personi.*
- *Më pëlqen sinqeriteti yt, i tha Ibrahim ibn Ed'hem.*

Kur Ibrahim Ed'hemi ishte në rrugëtim nuk do ta kundërshtonte asnjëherë mikun, por edhe nuk do të shoqërohej me dikë me të cilin nuk pajtohej. Kështu, një herë mori rrugë me një tregtar rripash, e një njeri i dhuroi një enë

tirit⁴² kurse Ibrahim Ed'hemi hapi dengun e shokut të tij, mori disa rripa nga aty, i vendosi në enë dhe ia ktheu atij që i kishte bërë dhuratë. Kur iu kthye shoku, e pyeti:

“Ky tiriti që e hëngre, sa kushtoi? Unë për të nuk jap më shumë se dy rripa.” Ibrahim u përgjigj:

“Bëhu i mëshirshëm, edhe Allahu do të bëhet i mëshirshëm ndaj teje!”

Një herë, pa kërkuar leje, i dha gomarin që i takonte shokut të tij, një njeriu që e pa duke ecur. E shoku për këtë nuk tha asgjë.

Ibn Omeri r.a. ka thënë:

“Njërit prej as’habëve të Muhammedit a.s. i është dhënë një dele si dhuratë. Ai tha: ‘Filan vëllait tim kjo i nevojitet më shumë’. Ky ia dërgoi delen shokut, ai ia dha tjetrit, e kështu me radhë, deri sa nuk u kthye përsëri te i pari, e kishte kaluar nëpër shtatë njerëz.”

Transmetohet se Mesruku kishte rënë në borxhe të mëdha, e shoku i tij Hajseme kishte gjithashtu borxhe. Mesruku, përkundër borxhit të vet, shkoi te huadhënësi i shokut dhe ia ktheu borxhin e tij, e shoku as që e diti. Edhe Hajseme shkoi dhe e ktheu borxhin e Mesrukut, e që Mesruku nuk kishte dijeni.

Kur Resulallahu s.a.v.s. e vëllazëroi Abdurrahman ibn Avf’in me Sa’d ibn Rebi’un, Sa’di ia dhuroi tërë pasurinë Abdurrahmanit. Abdurrahmani tha: *“Allahu të dhuroftë bereqet”* dhe e ndau pasurinë në dy pjesë, një pjesë për vete, një për Sa’din.⁴³ Vepra e Sa’adit quhet *Isar* (të preferohet që pasurinë t’a ketë tjetri, përkundër nevojës që ka vet personi) dhe të dytës i thuhet *musavat* (barazi). Isari është më i vlefshëm se musavati.

⁴² Përshesh copash buke me lëng mishi.

⁴³ Shënon Buhariu, në transmetim të Enesit.

Ebu Sulejman ed-Darani ka thënë:

“Po të ishte e tërë kjo botë e imja, dhe me të ta ushqeja njërin nga vëllezërit e mi, do të më dukej pak.”

Gjithashtu ka thënë:

“Sa herë që dikujt prej vëllezërve të mi i jap një kafshatë, unë e ndjej shijen e saj në fyt.”

Dhënia vëllait është më e vlefshme se sa dhënia sadaka të varfërve, prandaj edhe hazreti Alia r.a. ka thënë:

“Dhjetë derhemë që për Allahun Teala ia jap vëllait tim, më janë më të dashura se njëqind derhemë që i jap të varfrit.”

Hazreti Alia r.a., gjithashtu ka thënë:

“Të siguroj një sasi ushqim dhe për Allahun t’i ftoj vëllezërit e mi ta hanë, më është më e dashur se sa të çliroj një skllav.”

Resulallahu s.a.v.s. ka qenë shembull për të gjithë në dhënien përparësi tjetrit në krahasim me veten.

Kështu Resulallahu a.s. një herë, derisa ishte me një as’hab, nga pema e misvakut bëri dy misvakë. Njëri ishte i shtrembër, e tjetri i drejtë. Resulallahu s.a.v.s. ia dha shokut të tij misvakun e drejtë, e shoku i tha:

“O Resulallah, pasha Allahun, ty të përshtatet misvaku i drejtë.” Muhammedi a.s. iu përgjigj:

“Kushdo që shoqërohet me tjetrin, qoftë edhe një orë, do të pyetet për atë shoqërim – a i ka respektuar të drejtat të cilat Allahu ia ka dhënë (shokut), apo i ka shkelur ato.”⁴⁴

Me këtë shembull, Resulallahu s.a.v.s. ka treguar se dhënia përparësi shokut do të shpërblehet.

⁴⁴ Nuk është gjetur burimi i hadithit.

Resulallahu s.a.v.s., një herë shkoi me Hudhejfen te bunari që të lahet. Hudhejfe vendosi një copë rrobë që të mbulojë të Dërguarin e Allahut, deri sa të përfundojë pastrimin. Atëherë Hudhejfe u ul që të pastrohet, e Resulallahu s.a.v.s. mori rrobën që të mbulojë Hudhejfen, të mos e shohin njerëzit. Hudhejfe refuzoi, duke thënë:

“Ti që më je më i dashur se babai dhe nëna, o Resulallah, mos!” Muhammedi a.s. nuk e dëgjoi, por e mbulojë deri sa Hudhejfe përfundoi pastrimin. Atëherë, Resulallahu s.a.v.s. tha: **“Kur dy vetë shoqërohen, më i dashur për Allahun Teala është ai që është më i mirë ndaj tjetrit.”**⁴⁵

Transmetohet që Malik ibn Dinar dhe Muhammed ibn Vasi erdhën në shtëpi te Hasani Basriu. Hasani nuk ishte prezent, e Muhammedi nxori shportën me ushqim prej dollapit të Hasanit dhe filloi të hajë. Maliku i tha:

“Përmëbahu deri sa të vijë pronari i shtëpisë”, por, Muhammedi as që reagoi në fjalët e tij, dhe vazhdoi të hajë. Maliku ishte më bujar se ai dhe me sjellje më të mirë. Erdhi Hasani, dhe tha:

“O Maliku i mirë. Ja, kështu kemi qenë ne, nuk kemi pasur drojë nga njëri-tjetri. E tash ka ardhur gjenerata e re, e jotja dhe e shokëve tu.”

Me këtë ka dashur të thotë që sjellja e lirë në shtëpinë e vëllait është shenjë e shoqërimit të singertë. E si të mos jetë ashtu, kur Allahu Teala thotë:

“...çelësat e të cilëve u janë lënë juve, ose te miqtë. Nuk është gjynah për ju që të hani bashkërisht apo veçmas .”

24-Nur: 61

Ky ajet është shpallur kur një njeri i kishte lënë vëllait të vet çelësat e shtëpisë së tij, por këtij i kishte ardhur vështirë të marrë ushqim, nga devoshmëria. Kështu u lejua që të sillen lirshëm dhe ushqehen vëllezërit dhe shokët e singertë.

⁴⁵ Zinxhirin e transmetuesve të këtij hadithi e kemi përmendur në kapitullin e mëparshëm.

E DREJTA E DYTË
VËLLAIT DUHET NDIHMUAR PARA SE AI TË KËRKOJË
NDIHMË

Edhe kjo ka shkallët e veta. Kështu është edhe kur kemi të bëjmë me ndihmesë materiale. Shkalla më e ulët është plotësimi i nevojës pasi që vëllai të lus për diçka, por me buzëqeshje, me fjalë të ëmbla dhe me kënaqësi. Disa thonë: *“Nëse kërkon nga vëllai ndonjë shërbim, e ai nuk ta përmbushë, tërhiqi vërejtjen edhe një herë, ndoshta ka harruar. Por, nëse edhe atëherë nuk e përmbushë, bëj katër tekbirë dhe këndo ajetin:*

“Të vdekurit Allahu i ringjall.” 6-Ennam: 36

Ibn Shubrume i bëri një shërbim të madh një vëllait të tij. Pas kësaj, ky i solli një dhuratë. Ibn Shubrume e pyeti:

- *Çfarë është kjo?*

- *Po shpreh falënderim, iu përgjigj ky. Atëherë, Ibn Shubrume tha:*

- *Merre atë, Allahu të mëshiroftë. Nëse lut vëllanë të të bëjë një shërbim, e ai nuk përpiqet, merr abdes, bëj katër tekbirë dhe llogarite si të vdekur.”*

Xha'fer ibn Muhammed ka thënë:

“Ngutem që të plotësojë dëshirat e armiqve të mi, nga frika që të mos i refuzojë e të mos kenë më nevojë për mua.” Nëse kështu është për armiqtë, e çfarë të thuhet vallë për miqtë?!

Nga gjenerata e parë e myslimanëve, ishin disa shokë të cilët u kujdesen për familjen dhe fëmijët e shokut të tyre edhe për katërdhjetë vite pasi ai kishte vdekur. U ndihmonin çdo ditë dhe u vinin në vizitë. U jepnin nga pasuria e vet, kështu që ata kishin humbur babanë - por jo edhe gjithçka që nënkupton të kesh baba. Aq më shumë, merrnin edhe atë që nuk e kishin kur babai ishte gjallë.

Në atë gjeneratë ishte edhe njëri i cili do të shkonte te dyert e vëllait të vet dhe do të pyeste: *“A keni vaj? A keni kripë? A ju duhet gjë?”* Këtë do ta thoshte në atë mënyrë që vëllai i vet të mos ia njihte zërin. Kështu shprehej atëbotë kujdesi dhe vëllazëria.

Përderisa njeriu nuk kujdeset për vëllanë e vet ashtu siç kujdeset për vete, nuk ka të mirë në atë lidhje. Mejmun ibn Mihran thotë:

“Nëse nga një miqësi nuk ke dobi, as armiqësia e atij personi nuk do të dëmtojë.”

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Vërtetë, Allahu Teala i ka enët e veta në Tokë. Ato enë janë zemrat e njerëzve, e enët më të dashura për Allahun Teala janë ato më të pastrat (nga gjynahet), më të qëndrueshmet (në besim), dhe më të butat (ndaj vëllezërve).”⁴⁶

Shkurtimisht, nevoja e vëllait tënd duhet të jetë nevojë e jotja, ose edhe më e rëndësishme. Duhet pasur kujdes edhe për kohën që e ke në dispozicion për plotësimin e nevojës. Nuk guxon të jesh i pakujdesshëm ndaj gjendjes së vëllait tënd, ashtu siç nuk je i pakujdesshëm ndaj gjendjes tënde. Kurseje nga lutjet, mos lejo të të lus. Në fakt, sillu sikur as nuk e di se i ke ndihmuar dhe sikur nuk sheh kurrfarë merite tënden në atë që i ke ndihmuar.

Bile nuk duhet të jesh i kënaqur vetëm me furnizimin e nevojshëm por edhe më shumë, duke i dhënë përparësi atij mbi të afërmit. Edhe Hasani Basriu ka thënë:

“Më të dashur janë miqtë dhe vëllezërit se sa të afërmit tanë, sepse të afërmit na përkujtojnë në këtë botë, por miqtë dhe vëllezërit na përkujtojnë edhe në mahsher (Ditën e Kijametit).”

⁴⁶ Shënon Taberani nga Ebu Utbe Havlani.

Hasan Basriu gjithashtu do të thoshte:

“Kush e përcjell vëllain për Allahun, Allahu Teala do t’ia dërgojë një melek nën Arshin e Tij që ta përcjell në Xhenet.”

Në një transmetim thuhet:

“Nuk do të ndodhë që dikush të vizitojë vëllanë për Allahun, me dëshirë që ta shohë, e të mos i thotë nga mbrapa meleku: ‘Ke bërë vepër të mirë, dhe ke merituar Xhenetin!’”⁴⁷

A t ā ka thënë:

“Kujdesuni për vëllezërit në tri gjëra: nëse janë të sëmure – i vizitoni, nëse janë shumë të zënë – i ndihmoni, nëse harrojnë – i rikujtoni.”

Transmetohet se Abdullah Ibn Omeri r.a., sillej majtas-djathtas para Resulallahut s.a.v.s.. Pejgamberi e pyeti për këtë, e Ibn Omeri u përgjigj:

- *Më pëlqeu një njeri, e nuk po e shoh.*

Resulallahu s.a.v.s. tha:

- **Kur të pëlqen dikush, pyete se si quhet, si i quhet babai, ku jeton, që nëse sëmuret – ta vizitosh, nëse është shumë i zënë – ta ndihmosh.**⁴⁸

Sha’bi ka thënë: *“Kur njeriu shoqërohet me dikë e thotë: ‘e njoh, por nuk ia di emrin’, - ky është shoqërim i budallenjve.”*

Dikush e pyeti Ibn Abbasin r.a.:

- *Cili njeri të është më i dashuri?, e ai u përgjigj:*

- *Ai që shoqërohet me mua.*

⁴⁷ Është përmendur në kapitullin e mëparshëm.

⁴⁸ Hadithin e shënon Hara’iti në veprën **‘Mekarimul-Ahlak’**, Bejheki në veprën **‘Shu’abul-iman’**, Tirmidhiu nga Jezid ibn Nu’am.

Ibn Abbasi r.a., gjithashtu ka thënë:

“Nëse dikush vjen te unë tri ditë radhas, e nuk ka ndonjë kërkesë materiale nga unë, e kuptoj që vjen vetëm për rizanë e Allahut.”

Se’id ibn el-As ka thënë:

“Ai që vjen tri ditë në mexhlin tim, kur të më afrohet e nderoj, kur flet e dëgjoj, e kur do të ulet – i bëj vend.”

Ndërsa Allahu Teala thotë:

“...e të mëshirshëm mes vete...” 48-Feth: 29

e me këtë thekson mëshirën dhe nderin. Kompletim i mëshirës dhe nderit është edhe kur personi nuk ha vetëm ushqimin që i pëlqen, nuk kënaqet kur nuk e ka vëllanë prezent por pikëllohet kur vëllai nuk është aty, si dhe ndjehet disi i vetmuar pa prezencën e vëllait.

E DREJTA E TRETË NGANJËHERË DUHET HESHTUR, E NGANJËHERË DUHET FOLUR

Sa i përket heshtjes, duhet heshtur për të metat e vëllait, edhe kur vëllai jonë mungon, edhe kur është prezent. Aq më shumë, duhet bërë si i shurdhër e të mos i përgjigjet atij që flet për të metat e tij. Nuk duhet spiunuar, e të pyetet për të metat e tij. Kur ta shohim në rrugë ose në ndonjë nevojë, nuk duhet pyetur se çka do, çka ka për qëllim, çka e ka motivuar, çka dëshiron. Nganjëherë pyetje të tilla mund t’i vijnë të vështira, ose me to do ta detyrojmë të gënjejë. Askujt mos t’i flitet për sekretet të cilat ai t’i ka besuar, as shokëve të tij më të afërt. Sekretet e tij mos t’i zbulojë as atëherë kur ata nuk janë shokë më. Diçka e tillë është akt i pamoralshëm.

Duhet përmbajtur edhe nga përgojimi i shokëve të tij, familjes dhe fëmijëve, e gjithashtu nuk duhet folur as për atë se si të tjerët e përgojnë, sepse ai që të shanë, është vet ai që ta sjellë atë fjalë.

Enesi r.a., ka thënë:

“Resulallahu s.a.v.s. askujt nuk do t’i thoshte atë që atij personi nuk i pëlqen.” Sepse vuajta është së pari prej atij që e përcjell lajmin, pastaj prej atij që e thotë atë. Por nuk duhet fshehur fjalët e lavdërimit të cilat i kemi dëgjuar për vëllanë tonë, sepse gëzimi i parë vjen prej atij prej të cilit e dëgjon, pastaj prej atij që e ka thënë lavdërimin. Fshehja e mirësive të tilla është nga xhelozia.

Shkurtimisht, duhet heshtur për secilën fjalë që nuk është e dashur për vëllanë tonë, të mos e përcjellim as shkurtimisht as fjalë-për-fjalë, përpos nëse e kemi obligim për ta përcjellë, për shembull, nëse është ndonjë urdhër për të urdhëruar të mirën dhe për largim nga e keqja (*el-emr bil-ma’ruf ven-nehj anil-munker*). Atëherë heshtja nuk mund të jetë kurrfarë lehtësimi. Në raste të tilla nuk mund të ketë kujdes që të mos mërzisim vëllanë, sepse, në fakt, në atë rast kjo është mirë-bërje dhe ndihmë ndaj tij, qoftë edhe nëse nga jashtë do të dukej si e keqe.

Përmendja e të këqijave dhe të metave të tij si dhe të këqijat e familjes së tij, është thashetheme (*gibet*), e gibeti është i ndaluar (*haram*) për myslimanin. Dy gjëra e largojnë njeriun nga thashethemet (*gibet*):

E para, kontrolloje veten. Nëse gjen edhe një veti të papëlqyeshme, lësho pak pe ndaj vëllait. Mendo se vëllai është i pafuqishëm të përmirësojë atë veti të keqe që e ke parë te ai, njëjtë siç je ti i pafuqishëm të përmirësosh veten tënde. Mos ia vështirëso për një të papëlqyer. Fundja, kush është pa të meta? Mos prit që vëllai yt të jetë pa të meta ndaj teje, kur ti ke të meta ndaj urdhrave të Allahut, sepse ai nuk është i obliguar ndaj teje më shumë se që je ti i obliguar ndaj urdhrave të Allahut.

E dyta, ti e di mirë që sikur t'i kushtoje vëmendje të gjitha gabimeve, së shpejti do të largohesh nga të gjitha krijesat. Nuk do të kishe askënd me kë të shoqërohesh. Secili njeri ka anët e veta të mira, por edhe të këqija. Nëse anët e mira mbizotërojnë mbi të këqijat, kjo mjafton, aty duhet ndalur. Besimtari fisnik gjithmonë mendon anët e mira të vëllait, e në këtë mënyrë i shtohet dashuria dhe respekti ndaj tij. Kurse hipokritët dhe të pamoralshmit vazhdimisht kërkojnë gabimet e njerëzve.

Ibn Mubarek ka thënë:

“Besimtari gjithmonë pranon arsyetimet, kurse hipokriti gjithmonë kërkon gabimet.”

Fudajli ka thënë:

“Falja e gabimeve të vëllezërve është fisnikëri, sepse Muhammedi a.s. ka thënë:

“Strehohuni te Allahu Teala nga fqinji i keq, i cili nëse sheh ndonjë të mirë – e fsheh, e nëse sheh diçka të keqe – u tregon të gjithëve.”⁴⁹

Nuk ka asnjë person për të cilin nuk është e mundur që gjendja t'i ndërrohet për të mirë. Natyrisht, është e mundur që vetitë t'i ndërrohen edhe për të keq. Transmetohet se një njeri po e lavdëronte tjetrin para Resulallahut s.a.v.s., kurse të nesërmen e qortoi të njëjtin, prandaj Muhammedi a.s. e pyeti:

- Dje e lavdëroje, e sot po e qorton? Ky u përgjigj:

- Vallahi, të vërtetën e kam folur dje për të, e as sot asgjë lidhur me të nuk kam gënjyer. Dje ka bërë që të jem i kënaqur me të, prandaj kam thënë për të gjithë të mirat që i kam ditur. Sot më ka hidhëruar, prandaj thash për të gjithë të këqijat që ia di. Resulallahu s.a.v.s., në këtë tha:

“Në disa deklarata ka magji (sihër).”⁵⁰

⁴⁹ Shënon Buhariu në veprën *Tarih*, transmetuar nga Ebu Hurejre r.a., dhe Nesa'i nga Ebu Hurejre r.a.dhe Ebu Se'id r.a.

Resulallahut s.a.v.s. nuk i ka pëlqyer si ka vepruar ky person, prandaj diçka të tillë e ka krahasuar me sihër. Prandaj, është transmetuar gjithashtu:

“Të folurit e paturpshëm dhe zbulimi i gjërave janë dy degë të dyfityrësisë.”⁵¹ Kurse në një hadith tjetër: **“Vërtet, Allahu urren zbulimin e plotë të gjërave.”**⁵²

Edhe Shafiu ka thënë:

“Nuk mund të paramendohet për asnjë person që u nënshtrohet urdhrave të Allahut Teala e fare të mos kundërshtojë, e as që kundërshtuesi fare të mos nënshtrohet. E te kush ka më shumë mirësi se sa të këqija, dhe nënshtrimi është më i madh se kryengritja, ai është njeri i mirë dhe i drejtë.”

Nëse të tillët pranohen si të drejtë, atëherë nënkuptohet që edhe ti ta pranosh si të drejtë personin me gabime, por te i cili ka më shumë të mira se të këqija.

Siç është bërë obligim që të mos flitet keq për shokun, gjithashtu është obligim që me zemër të mos mendohet keq për të, sepse edhe kjo është e ndaluar. Kuptimi i kësaj ndalese është që të mos interpretosh veprimet të tij në të keqe kur ka mundësi të interpretohen për të mirë.

Por, nuk është e mundur të bëhesh sikur nuk di, për njohuritë e qarta të cilat i di. Edhe mangësitë duhet harruar aq sa është e mundur, dhe të falet gabimi. Një pjesë e hamendjes si kjo mbështetet në kuptimin përmes zgjuarsisë, dhe kësaj i thuhet *‘teferrus’* (kuptim i diçkaje me anë të zgjuarsisë, mirëkuptimit). Nuk është në fuqinë e njeriut të shpëtojë nga kjo. Edhe burimi i një pjese të besimit të gabuar

⁵⁰ Taberani në *‘Evsat’* dhe Hakimi në *‘Mustedrek’*, nga Ebu Bekri r.a., si dhe Hakimi nga Ibn Abbasi r.a..

⁵¹ Tirmidhiu, si dhe Hakimi me kushte të Buhariut dhe Muslimit, nga Ebu Umame.

⁵² Ibn Sunni në *‘Rijadatu’l-Muallimin’* nga Ebu Umame’s dhe Teberani në *‘Kebir’*

është i lidhur për këtë. Personi bën një vepër që mund të interpretohet si pozitive ose negative. Por, interpretimi yt i gabuar e tërheq atë në kuptim të keq. Ndërkaq, nuk ka ndonjë dëshmi të qartë për të përcaktuar të keqen. Një vepër e tillë – të interpretohet e keqja me një kuptim të tillë - është një krim, dhe gjithashtu për besimtarin është haram. Sepse Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Vërtet Allahu i ka ndaluar myslimanit gjakun, pronën dhe nderin e myslimanit tjetër, si dhe mendimin e keq për të.”⁵³

Dhe gjithashtu thotë:

“Largohuni nga dyshimet; fjalët e dyshimta janë të rrejshme.”⁵⁴

Dyshimi i keq tërheq me vete spiunimin dhe kërkimin e fshehtë, kurse Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Mos u ndani, mos u urreni, mos keni zili njëri-tjetrin, mos i ndërprisni marrëdhëniet mes vete, o robër të Allahut – bëhuni vëllezër.”

Fshehja e të metave, mosinteresimi për gjynahet e të tjerëve, janë veti të njerëzve të dedikuar fesë. Ngritja në gradat e larta arrihet me fshehjen e gjynaheve të të tjerëve dhe me theksimin e të mirës, mjafton të përmendet që me këtë përshkruhet Allahu Teala në dua:

“O Ti, i Cili thekson të mirat dhe fsheh gjynahet...” Allahu Teala është i kënaqur kur robi stoliset me vetitë e Tij, sepse Ai gjithsesi i fsheh turpet. Ai gjithsesi falë gjynahet, dhe Ai neglizhon të metat e robërve. E si atëherë ti nuk do të anashkalosh gabimet e dikujt që është si ti, që nuk është në asnjë pikëpamje rob i yti e as krijesë e jotja?!

⁵³ Hakimi në veprën **‘Tarih’**, nga Ibn Abbas r.a., si dhe Ibn Maxhe nga Ibn Omeri r.a., dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a..

⁵⁴ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

Isa a.s. u tha nxënësve të tij (*havvarijjun*):
- *Çfarë do të vepronit po të shihnit vëllanë tuaj në gjumë, dhe era ia ka hequr mbulesën duke zbuluar pjesët e tij të turpshme?* Thanë:

- *Do ta mbulonim.* Hazreti Isa a.s. tha:

- *Jo, ndoshta edhe më shumë do ta zbuloni.* Havvarijjunët thanë:

- *Subhanallah, si bëhet kështu?* Isa a.s. u përgjigj:

- *Dikush nga ju, kur dëgjon diçka për vëllanë e tij, shton edhe diçka, kjo është sikur vëllait që është në gjumë t'i zbulohen nga era pjesët e tij të turpshme, e ju edhe më shumë ta zbuloni.*

Dije se, ai që për vete do diçka derisa nuk e do edhe për tjetrin, nuk mund të bëhet poseduesi i besimit të përkryer (imani kamil). Shkalla më e ulët e vëllazërisë është kur personi sillet ndaj tjetrit ashtu siç do të donte që vëllai të sillet ndaj tij, e nuk ka dyshim që pritet që të fshehë turpet, të heshtë për të metat. E nëse megjithatë lajmërohet e kundërta, nga vëllai vetëm do të rritet pakënaqësia dhe zemërimi. Sa e shëmtuar është kur personi sillet ndaj vëllait me të kundërtën nga ajo që e pret. Ja si kërcënohen të tillët në Kur'an:

“Të mjerët ata që mangu masin e peshojnë.

Ata që kur matin prej njerëzve, për vete e plotësojnë.

E kur u matin të tjerëve ose u peshojnë, u lënë mangu.”

83-Mutaffifun: 1-3

Secili që kërkon më shumë se që ka dhënë dhe bërë përfshihet në porosinë e këtij ajeti. Mosfshehja e gabimeve të vëllait edhe mundimi që ato të zbulohen edhe më shumë janë sëmundje që ruhen në brendi, sëmundje e urrejtjes dhe zilisë. Urrejtja dhe zilia mbushin brendinë e personit të tillë me papastërti, por edhe i ruajnë ato në brendi, dhe nuk i nxjerrin jashtë deri sa të jepet rasti për këtë. E kur të lajmërohet një rast i tillë, forcohet lidhja me të papastërit, turpi zhduket, dhe në brendi fillon të shfaqet pislleku i fshehur. Më mirë është largimi nga personi i mbushur me urrejtje dhe zili.

Një dijetar ka thënë:

“Qortimi publik është më i mirë se urrejtja e fshehur. Butësia ndaj urrejtjes vetëm sa e rrit intensitetin e saj. Ai që në zemër ka urrejtje të madhe për myslimanin, kjo është shenjë që fenë e ka të dobët. Të tillin duhet konsideruar fatal për të tjerët, me këtë zemër të përlyer nuk arrihet kënaqësia e Allahut.”

Abdurrahman b. Nufejr transmeton nga i ati të ketë thënë:

- Deri sa isha në Jemen kisha një fqinj hebre. Më fliste për Tevratin. Kur u kthye hebreu nga udhëtimi, i thashë:

- Allahu na ka dërguar një peygamber që na fton në Islam. Pranuam Islamin, dhe na është zbritur Libri, që konfirmon vërtetësinë e Tevratit. Hebreu mu përgjigj:

- Ke folur të vërtetën, por nuk do të jeni në gjendje të zbatoni urdhrat ashtu siç duhet. Sepse kemi gjetur cilësitë e tij, dhe cilësitë e ummetit të tij në Tevrat kështu: ‘Nuk është e lejuar (nuk është hallall) për myslimanin të kalojë pragun e shtëpisë së vet e që në zemër të ndjejë urrejtje dhe xhelozë ndaj vëllait të vet mysliman.’

Nga kjo mund të përfundohet se është obligim të përmbahesh nga përhapja e fshehtësive të vëllait tënd të cilat t’i ka treguar në besim. Në raste të tilla, duhet mohuar atë të fshehtë të shëmtuar, edhe nëse duhet gënjer për këtë, edhe pse është vaxhib të flitet e drejta, ekzistojnë disa përjashtime. Siç i është lejuar (xhaiz) njeriut të mbulojë të metat dhe fshehtësitë e veta, edhe nëse i duhet të gënjejë, ashtu i duhet vepruar edhe për vëllanë e tij. Ai vëllanë e vet e sheh si veten, janë si një person i vetëm, e nuk mund të dallohen mes vete me asgjë përpos me trup. Kjo është esenca (*hakikat*) e vëllazërisë.

Bile, të bëhet në prezencën e vëllait vepra e cila zakonisht do të bëhej fshehtas, nuk është dyfytyrësi. Sepse ai shihet si i njëjti person me veten. Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Kush fsheh turpet e vëllait të vet, Allahu do t’ia fsheh turpet atij, në këtë botë dhe në ahiret.”⁵⁵ dhe në versionin tjetër:

“...është sikur të ketë ngjallur një të vdekur.”⁵⁶

Me një hadith tjetër, Muhammedi a.s. thotë:

“Kur dikush flet diçka duke shikuar përreth, ajo fjalë është (për ata që gjinden aty) amanet.”⁵⁷

Gjithashtu thotë:

“Mexhliet (tubimet) janë vendet e amanetit (aty çka flitet - nuk del jashtë), përpos në tri raste: bisedimet për derdhjen e gjakut të ndaluar, bisedimet për marrëdhënien e ndaluar seksuale, dhe bisedimet për uzurpimin e pronës së tjetrit.”⁵⁸

Me një hadith tjetër Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Shoqërimi i dy njerëzve bazohet në besim; asnjërit nuk i lejohet të përhapë për shokun atë që vet nuk e do.”⁵⁹

Njërin nga evliatë e kanë pyetur:

- *A mund ta ruash sekretin? Ai u përgjigj:*

- *Po, unë jam varr i sekretit.*

Ndërsa është thënë: *“Gjokset e burrave janë varret e sekreteve.”*

⁵⁵ Ibn Maxhe nga Ibn Abbas r.a, si dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a. Ekziston edhe versioni i shënuar nga Buhariu dhe Muslimi përcjellë nga Ibn Omeri r.a.

⁵⁶ Ebu Davud, Nesa’i dhe Hakimi nga Ukba ibn Amir r.a.

⁵⁷ Ebu Davud dhe Tirmidhiu nga Xhabiri r.a.

⁵⁸ Ebu Davud nga Xhabiri r.a., përmes djalit të vëllait të tij, të cilit nuk ia përmend emrin.

⁵⁹ Ebu Bekër ibn Lal në veprën *‘Mekarimul-Ahlak’*, nga Enesi r.a. Ibnul-Mubarek në veprën *‘Zuhd’* nga Ebu Bekr ibn Hazma, dhe Hakimi nga Ibn Abbasi r.a.

Gjithashtu është thënë:

“Zemra e budallait është në gjuhën e tij, kurse gjuha e të kuptueshmit në zemrën e tij,” pra, budallai nuk është në mundësi të fshehtë atë që e ka në zemër, e zbulon atë, e që as nuk është i vetëdijshëm për këtë. Për këtë arsye është obligim të ndërpritet shoqërimi me budallain. Aq më shumë, duhet ndërprerë edhe takimet me ta.

Kanë pyetur njërin:

- *Si e ruan sekretin? Ky iu përgjigj:*

- *E mohoj atë që jep sekretin dhe i bëj be atij që kërkon sekretin.*

E dikush tjetër ka thënë:

“E fshehi atë sekret dhe e fshehi se çfarë sekreti jam duke fshehur.”

Për këtë, ka thurur vargje edhe Ibn el-Mu'tez:

*Te unë u varros fshehtësia,
Desha ta ruaj atë dhuratë si ar,
E vendosa menjëherë në gjoks,
E ky, iu bë varr.*

Dikush tjetër, si shtesë kësaj, këndoi:

*Fshehtësia në gjoksin tim
Nuk është si banori në varr,
Që pret të ngjallet
E përsëri në shesh të dalë.
Unë e harroj fshehtësinë
Sikur asnjëherë mos ta kem parë,
Sikur mos ta kisha dëgjuar*

Dikush ia tha sekretin vëllait të vet, e më pas i tha:

- *Këtë mos i trego askujt, fshihe. Ky iu përgjigj:*

- *Tashmë e harrova.*

Ebu Seid es-Sevri do të thoshte:

“Kur dëshiron të vëllazërohesh me dikë, zemëroje, dhe qortoje mirë. Nëse më pas, dikush e pyet atë për fshehtësitë tua e ai për ty flet vetëm mirë dhe i fsheh sekretet tua, atëherë vazhdo shoqërimin me të.”

Dikush i tha Ebu Jezid el-Bestamiut:

- *Me cilët prej njerëzve shoqërohesh?* Bestamiu u përgjigj:

- *Me atë i cili për ty kupton diçka që vetëm Allahu di, dhe më pas e fsheh atë ashtu siç e fsheh edhe Allahu Teala.*

Dhunnun-i Misri kishte thënë:

“Nuk ka hair të shoqërohesh me atë i cili nuk dëshiron që te ti të sheh pendimin. Kush zbulon sekrete kur është i xhindosur, ai është i poshtër, sepse fshehja e sekretit deri sa njeriu është në rehati dhe qetësi është domosdoshmëri e natyrës. Burrëri është të fshihet sekreti në çastet e zemërimit.”

Një dijetar ka thënë:

“Mos u shoqëro me dikë i cili ndryshon në katër raste: kur është i xhindosur, kur është i lumtur, kur është i pangopur dhe kur i është entuziazmuar epshi. Besnikëria në vëllazëri është që të mos ndërrohet në tërë këto gjendje.”

Për këtë arsye është thënë: *“Edhe po të përfundojë shoqërimi me besnikun, ai të mirat tua i tregon dhe të këqijat i fsheh. E kur përfundon shoqërimi me njeriun e keq – ai të mirat i fsheh dhe të këqijat i tregon.”*

Abbasi r.a., i tha birit të tij, Abdullahut r.a.:

“Po shoh se ky njeri...”, e kishte fjalën për Omerin r.a., “po të jep përparësi ndaj më të vjetërve, prandaj merr nga unë pesë gjëra: assesi mos i zbulo atij fshehtësi të të tjerëve, assesi askënd para tij mos e përgojo, assesi mos i fol asnjë gënjeshtër, assesi për asgjë mos i refuzo dëgjueshmërinë, dhe le të mos ndjejë asnjëherë tradhti prej teje.”

E për këtë, esh-Shabi ka thënë:

“Kushdo që pranon cilëndo nga këto pesë fjalë, vetëm të mira ka.”

Secili duhet të përmbahet nga çfarëdo dyshimi dhe kundërshtimi përderisa vëllai yt flet. Ibn Abbasi r.a., thotë:

“Mos kundërshto më të poshtrinë se do të të shqetësojë, e as me të butin, se do të të urrejë.”

Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Kush heq dorë nga kundërshtimi kur nuk ka të drejtë, do t’i ndërtohet shtëpi në periferi të Xhenetit. E kush heq dorë nga argumentimi kur ka të drejtë, do t’i ndërtohet shtëpi në mes të Xhenetit.”⁶⁰

Ani pse është vaxhib të braktiset kundërshtimi i padrejtë, në këtë rast Allahu Teala e ka bërë sevapin e nafiles më të lartë nga sevapi i vaxhibit. Sepse braktisja e kundërshtimit të padrejtë, është më e lehtë se sa braktisja e kundërshtimit të drejtë. Më e vështirë është heshtja kur kemi të drejtë se sa heshtja për të padrejtën. Shpërblimi është në proporcion me vështirësinë dhe mundimin. Shkaktarët më të rëndë të nxitjes së zjarrit mes vëllezërve janë argumentimi dhe rivaliteti. Këta dy shkaktarë do të jenë ndarës dhe ndërprerës të marrëdhënies, sepse ndarja fillon së pari në mendim, më pas në fjalë e në fund edhe fizikisht.

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Mos u ndani, mos u urreni, mos keni zili njëri-tjetrit, mos i ndërprisni marrëdhëniet mes vete, o robër të Allahut – bëhuni vëllezër. Myslimani është vëlla për myslimanin, nuk ushtron dhunë mbi të, nuk e privon nga ndihma, nuk ndahet nga ai. Njeriu ka mjaft fatkeqësi edhe pa përbuzur vëllanë mysliman.”⁶¹

⁶⁰ Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe nga Enes bin Malik.

⁶¹ Muslimi nga Ebu Hurejre r.a. Fillimin e hadithin e shënojnë edhe Buhariu dhe Muslimi nga Enes r.a.

Debatimi dhe përplasja janë ofendimet më të rënda. Sepse kundërshtimi i fjalës së tjetrit me padituri ose pakujdesi dhe moskuptimi i gjërave ashtu siç janë, është akuzim.

Në hadithin të cilin e përcjellë Ebu Umame el-Bahili, thuhet:

“Na erdhi Muhammedi a.s. e ne po debatonim. Muhammedi a.s. na tha:

“Lëreni debatin anash, se pak ka të mirë në të. Lëreni debatin sepse dobia e saj është e vogël, kurse e ndez urrejtjen mes vëllezërve.”⁶²

Dikush nga gjenerata e parë e myslimanëve ka thënë: *“Kush ofendon vëllezërit dhe debaton me ta, i humbet mirëbërja dhe nderi.”*

Abdullah ibn el-Hasan ka thënë:

“Ruaju nga debatimi me njerëzit. Sepse përballësh me inatin nga të mirët dhe me sulmin e papritur nga i keqi.”

Përsëri, dikush nga gjenerata e parë e myslimanëve ka thënë: *“Njerëz të pafuqishëm janë ata që nuk vëllazërohen, edhe më të pafuqishëm janë ata që e humbin vëllazërinë.”*

Padyshim debatimi pa nevojë pakëson miqtë dhe e shumon armiqtë.

Hasani Basriu ka thënë:

“Mos blej armiqtësinë e një personi për miqtësinë e njëmijë personave.”

Shkurtimisht, i vetmi shkak i debatimit është paraqitja e tjetrit si të paditur, ofendimi i tij dhe paraqitja e vetes si më të mençur, më të vlefshëm dhe më të ndershëm. Kjo është mendjemadhësi, shqetësim dhe ofendim i njerëzve. Të quhen të tjerët budallenj dhe të paditur nuk është asgjë tjetër pos armiqtësi, prandaj si mund të jenë këto pjesë të shoqërimit?!

⁶² Taberani në veprën **‘Kebir’** nga Ebu Umame, Ebu Derda dhe Enesi r.a. Shënon edhe Ebu Mensur Dejlemi në veprën **‘Musnedul-Firdevs’**, nga Ebu Umame.

Ibn Abbasi r.a., transmeton nga Resulallahu s.a.v.s.:

“Mos u grind me vëllanë tënd, mos u tall me të dhe mos i premto diçka e më pas ta dëshpërosh.”⁶³

Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Nuk ju mjafton pasuria që t’i bëni njerëzit të lumtur. Por mund t’i bëni të lumtur me buzëqeshje dhe ahlak të bukur.”⁶⁴

Debatimi është e kundërta e sjelljes së mirë. Gjeneratat e para të myslimanëve në këtë çështje ishin aq të kujdesshëm sa që nga frika se do të debatohet, nuk kanë bërë pyetje. Bile, nëse i thuhet shokut ‘Çohu’, e ai të pyet: ‘Ku të shkoj?’ mos u shoqëro me të. Ai duhet të ngrihet, e as të mos pyes gjë.

Ebu Sulejman ed-Darani ka thënë:

“E kam pasur një shok në Irak. Rregullisht e vizitoja. I pata thënë një herë:

‘Më nevojiten para’, e më dha arkën e vet, dhe nga ajo mora sa më duhej. I erdha herën tjetër, dhe i thashë:

‘Më nevojiten para.’ Ai më pyeti:

‘Sa të duhen?’ - me këtë pyetje u zvogëlua në zemrën time dashuria dhe shija e vëllazërisë.”

Dikush tjetër ka thënë:

“Nëse nga vëllai kërkon diçka e ai të pyet: ‘Pse të duhet?’, ta dish se ai ka braktisur detyrimet e vëllazërisë.”

Dije se vazhdimi i vëllazërisë së sinqertë përshtatet në të folur, në vepra dhe në mëshirë. Ebu Osman Hijeri kishte thënë:

“Më mirë është përshtatja e miqve me njëri-tjetrin se sa dhembshuria ndaj njëri-tjetrit.”

E bash kështu siç ka thënë ai është.

⁶³ Hadithin e shënon Tirmidhiu, përcjellë nga Lejs ibn Ebu Sulejm.

⁶⁴ Ebu Ja’la el-Musili dhe Taberani në veprën **‘Mekarimul-Ahlak’**, Ibn Adijj në **‘Kamil’**, si dhe Hakimi, dhe Bejheki në veprën **‘Shuabul-Iman’**, përcjellë nga Ebu Hurejre r.a.

E DREJTA E KATËRT KUR DUHET FOLUR

Rregulli i katërt ka të bëj me të folurit, sepse vëllazërimi, ashtu siç kërkon nganjëherë heshtjen për të papëlqyeshmen, kërkon edhe të folurit për diçka të mirë. Të fliten fjalë të mira që shtojnë dashurinë është veçori e vëllazërisë, sepse shoqërimi me ata që mjaftohen me heshtje, është si shoqërimi me të vdekurin. Qëllimi nga vëllazërimi është përfitimi nga ai vëllazërim, e jo vetëm shpëtimi nga shqetësimet, kurse heshtja nënkupton përmbajtje nga shqetësimi. Atëherë, vëllai duhet me gjuhë t'ia shprehë dashurinë vëllait, ta hulumtojë atë që e kënaq vëllanë. Për shembull, ta pyes a ka ndonjë shqetësim, e nëse ka - të shfaq brengë, e në gjendjet e gëzueshme të vëllait të shfaq gëzimin. Vëllazërim do të thotë shoqërim në të mirë dhe në të keqe.

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Kur dikush nga ju e do vëllanë e vet, le t’ia thotë këtë.”⁶⁵

Është urdhëruar që kjo të thuhet meqenëse kjo domosdo me vete tërheq rritjen e dashurisë. Kështu nuk ka aspak dyshim që edhe vëllai yt, kur e kupton që ti e do, të të dojë ty, e më pas nuk ka aspak dyshim që, kur ti të kuptosh që ai ty të do, ti ta duash edhe më shumë. Në këtë mënyrë, dashuria mes dy njerëzve rritet dhe forcohet. Dashuria në mes të besimtarëve kërkohet në Sheriat, e është e lavdëruar edhe në fe. Për këtë arsye, duke lajmëruar rrugën e dashurisë, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Bëni dhurata njëri-tjetrit, do të duheni mes vete.”⁶⁶

⁶⁵ Ebu Davud dhe Tirmidhiu, gjithashtu Hakimi, i cili e transmeton nga Mikdad ibn Madi Kerbi.

⁶⁶ Bejheki nga Ebu Hurejre r.a.

Në dhënie të dhuratave mund të llogaritet edhe ta thërrasësh me nofka të bukura, edhe kur është prezent, edhe kur nuk është. Hazreti Omeri r.a. ka thënë:

“Tri gjëra tregojnë dashurinë tënde ndaj vëllait tënd: kur ta shohësh – i pari t’i japësh selam, t’i bësh vend aty ku ulet dhe ta thërrasësh me nofka që ai i do.”

Në këtë llogaritje edhe lavdërimi për të gjitha vetitë e mira që i ka, dhe atë para të tjerëve, sepse diçka e tillë është një prej shkaktarëve më të fuqishëm për të tërhequr dashurinë. Gjithashtu, është e hijshme t’i lavdërosh edhe fëmijët e tij, punën dhe veprat e tij, bile edhe maturinë e tij, edukimin, pamjen, dorëshkrimin, veprat e shkruara, dhe në përgjithësi gjithçka që e gëzon, por pa gënjyer dhe pa teprim. Por, duhet lavdëruar atë që është për t’u lavdëruar. Nga kjo rrjedh edhe t’i përcjellësh lavdërimet e të tjerëve, me shprehje të qartë të gëzimit, sepse fshehja e lavdërimeve ngjall zilinë.

Duhet lavdëruar veprat që i ka bërë për ty, bile edhe vetëm qëllimin, në rast se nuk arrin që të kryej atë vepër. Hazreti Alia r.a., ka thënë:

“Kush nuk e lavdëron qëllimin e mirë të vëllait të vet, ai nuk ia ka lavdëruar as veprën e mirë që vëllai e ka bërë.”

E ajo që më së shumti kontribuon në forcimin e dashurisë është që ta mbrosh para të tjerëve kur ai nuk është prezent, si edhe ta mbrosh nga fjalët e këqija që fliten për të. Kjo është e drejtë e vëllazërisë. Njëra nga obligimet në vëllazëri është përpjekja për të mbrojtur dhe ndihma vëllait që të shpëtojë nga një gjendje e vështirë dhe t’i detyrojë kundërshtarët të heshtin. Të jesh i butë ndaj tij dhe butësisht ta thërrasësh. Përmbajtja nga shprehja e të gjitha këtyre, nënkupton izolim të zemrës dhe heqje e të drejtave të vëllazërisë. Resulallahu s.a.v.s. ka krahasuar dy vëllezër me dy duar, të cilat e pastrojnë njëra-tjetrën, ku dy vëllezër ndihmojnë dhe mbrojnë njëri-tjetrin.

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Myslimani është vëlla për myslimanin, nuk i bën padrejtësi, nuk e braktisë dhe nuk e mallkon.”⁶⁷

Të heshtet padrejtësia dhe fjalët që e ndotin nderin e vëllait është njëjtë sikur të heshtet kur vëllait i kërcënohet rreziku për t’ia copëtuar mishin. I mjerë është ai vëlla që të sheh se si bishat të sulen që të të copëtojnë, e ai hesht. Nuk ka dhembshuri që të këshillojë e të të alarmojë, e as që ndjenë që duhet të të mbrojë nga ta. Kurse fjalët që ndotin nderin janë më të këqija për shpirtin se sa shqyerja nga bishat. Prandaj Allahu Teala edhe e ka krahasuar përgojimin me ngrënien e mishit të të vdekurit:

“Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?!” 49-Huxhurat: 12

Aftësia e kuptimit të gjërave në ëndërr, e cila në fakt është reflektim i Lehvi-mahfudh-it në ruh (shpirt) përmes shembujve, shfaq përgojimet përmes ngrënies së mishit të të vdekurit, kështu që kush ëndërron ngrënien e mishit të të vdekurit, kjo do të thotë që në zhgjëndërr ai përgojon njerëzit. Por, kjo ngjashmëri nuk është në formë të jashtme, është në kuptimin e vlerës shpirtërore.

Po kuptohet që mbrojtja e vëllait nga çdo lloj sulmi dhe akuze që ia bëjnë armiqtë e tij dhe sjellja e butë ndaj tij, në lidhje vëllazërie janë obligime (vaxhib). Për këtë arsye Muxhahidi ka thënë:

“Si dëshiron ti që vëllai të të përmend kur nuk je prezent, ashtu edhe ti përmende kur ai nuk është prezent.”

Tani, ke dy njësi matëse. Njëra është, të flasësh për vëllanë atë që do të doje që ai të flasë për ty. Prandaj do të duhej që secili të sillet ndaj tjetrit ashtu siç do të donte që të sillen ndaj atij.

⁶⁷ Hadithin e kemi cekur më herët.

Njësia tjetër matëse është të kesh kujdes sikur ai të jetë prezent, të fshihet pas murit, dëgjon fjalët tua, e mendon që ti nuk je i vetëdijshëm që ai është aty. Atëherë, si dëshiron të flasësh dhe cilat fjalë dëshiron t'i dëgjojë ai? Ja kështu duhet të flitet edhe kur ai nuk është prezent.

Dikush ka thënë:

“Sa herë e kujtoj vëllanë, e ai nuk është prezent, e imagjinoj të jetë aty, ulur, e të them atë që ai do të donte unë ta them po të ishte prezent.”

Dikush tjetër ka thënë:

“Sa herë përmendet vëllai im, paramendoj se jam në lëkurën e tij, dhe për të them atë që do të doja të thuhet për mua.” Ky është jetësim i vërtetë i Islamit: kur vëllait i dëshiron atë që i dëshiron vetes.

Ebu Derda r.a. po shikonte dy buaj, që po lëvronin, e njëri u ndal që të kruhet. Menjëherë u ndal edhe tjetri. Ebu Derda r.a., filloi të qajë, dhe tha:

“Kështu është edhe me dy vëllezër, së bashku punojnë për Allahun Teala, e kur të ndalet njëri, edhe tjetri përshtatet.”

Vetëm me përshtatje ndaj njëri-tjetrit kompletohet singëriteti. Kush nuk është i singertë në vëllazërim, është dyfytyrësh. Singëriteti nënkupton mosndryshim në sjellje në mungesë, në prezencë, me gjuhë dhe me zemër, fshehtas a publikisht - kur je me dikë ose kur je vetëm. Kundërshtimi dhe ndryshimi i gjendjes së njëres nga këto është prishje e miqësisë, në fe është dredhi e në rrugë të besimit (iman) është dembelosje. Kush nuk mund të pranojë këtë, më mirë e ka të ndërpresë lidhjet dhe të izolohet se sa të vëllazërohet dhe shoqërohet, sepse të drejtat e shoqërimit janë të vështira, mund t'i bartë vetëm ai që është i dëshmuar në to. Nuk ka dyshim që shpërblimi për shoqërim është i madh, por këtë e përfitojnë vetëm të suksesshmit.

Për këtë arsye Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“O Ebu Hirre, zbukuro sjelljen tënde ndaj fqinjit, do jesh mysliman. Zbukuro sjelljen tënde ndaj shokut, do jesh besimtar (mu’min).”⁶⁸

Ki vëmendjen, shpërblimi për miqësi është imani, kurse shpërblimi për marrëdhënie të mira fqinjësore – islami. Dallimi mes imanit dhe islamit është i njëjtë me dallimin në mes të kujdesit për respektimin e obligimeve ndaj fqinjit dhe kujdesit për respektimin e obligimeve të miqësisë. Miqësia kërkon shumë obligime, të drejta të cilat vazhdimisht ndjekin njëra-tjetrën, përderisa fqinjësia kërkon vetëm obligimin e afërsisë në kohë të ndryshme, jo vazhdimisht.

Nevoja e vëllait tënd për dituri nuk është më e vogël se nevoja e tij për pasuri, prandaj nëse gjendesh në gradë të kënaqshme të diturisë, duhet ta ndash atë, t’ia afrosh secilit që do ta përdorë në besim dhe në jetën e kësaj bote. Nëse vëllanë e mëson dhe udhëzon, e ai nuk sillet sipas asaj që i është mësuar, duhet ta këshillosh duke e përkujtuar në të gjitha humbjet e mundshme të një sjelljeje të tillë si dhe në dobitë e braktisjes së rrugës së gabuar. Vëllanë tënd, në këso rastesh, duhet ta frikësosh me atë që ai nuk e do në këtë botë dhe në ahiret, me qëllim që ta pengosh nga rruga e gabuar, ta paralajmërosh për të metat e tij, dhe që ajo që është e shëmtuar të urrehet në sytë e tij, dhe ajo që është e bukur t’i bëhet e bukur. Por, është obligim që gjithë kjo të bëhet fshehtas, për këtë askush nuk duhet ta dëgjojë. Tërheqja e vërejtjes për këtë në publik do të thotë ekspozim dhe turpërim për vëllanë tënd, kurse paralajmërimi në fshehtësi do të thotë të shprehësh keqardhje dhe është këshillë, sepse Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Besimtari është pasqyrë e besimtarit.”⁶⁹

⁶⁸ Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe, nga Ebu Hurejre r.a. Shënon edhe Kuda’i në veprën *‘Musnedush-shihab’*.

⁶⁹ Ebu Davud nga Ebu Hurejre r.a.

Pra, në të sheh çfarë nuk sheh në vete, dhe kështu i kupton mangësitë e veta. Nëse izolohet, atëherë nuk e ka këtë përfitim. Kështu njeriu përdorë edhe pasqyrën, duke parë të metat që gjenden në pamjen e jashtme.

Imam Shafiu r.a. ka thënë:

“Kush e këshillon vëllanë në fshehtësi, e ka këshilluar vërtet dhe e ka ngritur, por kush e këshillon publikisht, me këtë e turpëron dhe qorton.”

Dikush e pyeti Misarin:

- *A e do atë i cili t’i tregon të metat?* Misari u përgjigj:

- *Nëse më këshillon në katër sy, atëherë e dua. Por nëse më qorton para të tjerëve, atëherë nuk e dua.*

E ka folur të vërtetën. Këshillimi para të tjerëve është i barabartë me turpërim. Edhe Allahu Teala do ta qortojë besimtarin në Ditën e Gjykimit nën hijen e rahmetit të Tij, kështu që gjynahet do t’i tregohen në fshehtësi. Nganjëherë, libri me veprat e tij do t’i jepet melaikëve i mbyllur, e ata do të sillen rreth tij dhe do të lëvizin drejt Xhenetit. Kur t’i afrohen dyerve të Xhenetit, do t’ia japin librin, të mbyllur, që ta lexojë.

Por, fatkeqët do të thirren publikisht, gjymtyrët e tyre do t’i turpërojnë, do ta nxjerrin çdo gjë në shesh para çdokujt dhe do të turpërohen. Strehohemi te Allahu Teala nga Dita e turpërimit të madh!

Dallimi mes këshillimit të fshehtë me këshillimin publik dhe qortimin, është njëjtë si dallimi në mes të fytyrëqeshurit dhe dyfytyrëshit. Prandaj, nëse përmbahesh për shkak të sigurisë së besimit tënd, dhe për shkak që në përmbajtje sheh siguri për vëllanë tënd, atëherë je fytyrëqeshur. Por, nëse përmbahesh për shkak të dobisë personale dhe si pasojë e dëshirave tua, dhe për shkak të nderit personal, atëherë je dyfytyrësh.

Dhunnuni Misri ka thënë:

“Le të jetë lidhja me Allahun Teala vetëm përmes përshtatjes ndaj urdhrave të Tij, shoqërimi me njerëz vetëm përmes këshillimit, takimi me nefsin tënd vetëm përmes kundërshtimit, e takimi me shejtanin vetëm përmes armiqësisë.”

Nëse është këshillim përmendja e të metave, e në këtë ka thyerje të zemrës, si mund të jetë kjo një nga rregullat e vëllazërimit?” Dije se: Thyerja e zemrës ndodh me përmendjen e të metave të vëllait tënd për të cilat ai di, derisa përmendja e të metave për të cilat ai nuk di është dhembshuri. Dhembshuria i tërheq zemrat e njerëzve të kuptueshëm kah ti. E sa u përket budallenjve, mos u kthe kah ata. Kush të paralajmëron për vepër të papëlqyer, dëgjoje. Ose, kush të tërheq vërejtjen për ndonjë ves të papëlqyer me të cilën je veshur, dëgjoje, që të pastrohesh nga ai ves. Ai që të tërheq vërejtjen është i ngjashëm me atë që do të alarmonte për akrepin ose gjarprin e fshehur nën shtratin tënd, e paramendoje atë rrezik. Nëse ky paralajmërim nuk të pëlqen, je plotësisht një budalla! Veset e këqija janë si akrepi dhe gjarpri, ndoshta edhe më keq. Akrepi dhe gjarpri e përfundojnë këtë jetë të përkohshme, ndërsa veset e këqija e shkatërrojnë jetën e përjetshme në ahiret. Veset e këqija kafshojnë zemrat, e dhimbja në atë rast është më e madhe se sa dhimbja e kafshimit në trup nga akrepi dhe gjarpri. Ato do të krijohen në Kijamet prej zjarrit dhe do të të helmojnë. Për këtë arsye Hazreti Omeri r.a. ka kërkuar vazhdimisht nga shokët e tij që t’i tregojnë mungesat, duke thënë: *“Allahu ka mëshiruar atë i cili i tregon vëllait kur ky bën gabim.”*

Prandaj Omeri r.a., i tha Selmanit r.a., i cili e vizitoi:

- *Çka ka te unë që ty nuk të pëlqen?* Selmani i kërkoi hallallin, dhe i tha:

- *Kam dëgjuar që ke dy mantele: një e vesh natën, e tjetrin ditën. Dhe kam dëgjuar që përdor dy enë gjellë në sofër.* Omeri iu përgjigj:

- *Tani përmbahem nga këto dyja. A ka diçka tjetër?*

- *Jo,* i tha Selmani r.a.

Hudhej fetu'l-Mer'ashi i shkroi letër Jusuf ibn el-Esbatit:

-*Kam dëgjuar që ke shitur fenë tënde për dy pjesë. Shitësin e qumështit e ke pyetur:*

- *Sa kushton? shitësi të ka thënë:*

- *Një të gjashtën e dërhemit, e ti:*

- *Jo, një të tetën, dhe shitësi, pasi që të njohu, të tha:*

- *Le të jetë si thua ti. Dhe ti pranove. Ngrite nga koka perden e pakujdesjes dhe merr mësim nga të vdekurit. Dije: kush lexon Kur'an, e nuk është i kënaqur dhe i jep përparësi dynjallëkut, nuk mundet të jetë i sigurt që nuk i ka ekspozuar tallje ajeteve. Allahu Teala i përshkruan gënjeshtarët me urrejtjen që kanë ndaj atyre që këshillojnë:*

“...por ju nuk i donit ata që këshillojnë.” 7-Araf: 79

Kjo ishte e meta ndaj të cilës Ibn Esbat ka qenë i pakujdesshëm. E kur bëhet fjalë për të metat të cilat vëllai i ka bërë me gabim dhe mundohet t'i fshehë, nuk është e përshtatshme të shpjegohen.

Nëse ai i bën këto haptas, duhet të jesh i butë ndaj tij në këshillim. Nganjëherë me shaka, nganjëherë me aludim, e nganjëherë duke i folur se për çka bëhet fjalë, në atë mënyrë që kjo ta qojë në largim nga ajo e metë. E nëse e sheh që këshillimi nuk po i bën dobi, dhe që ai me natyrën e tij është thjesht i detyruar t'u dorëzohet atyre të metave, atëherë e ke prioritet të heshtësh. Krejt kjo është për të mirën e fesë dhe dynjallëkut të vëllait tënd.

Lidhur me atë që ka të bëjë me zvogëlimin e të drejtave tua te ai, duhet të fokusohesh në durim, mëshirë, falje, dhe të bëhesh sikur këtë nuk po e vëren. Paraqitja e fakteve që je privuar nga diçka nuk është pjesë e këshillimit. Por, nëse sjelljet e tij çojnë drejt ndërprerjes së marrëdhënies, më mirë është të heshtet për ato sjellje, se sa të ndërpriten marrëdhëniet. Kurse aludimi në problem, prapëseprapë, është më i mirë se sa të folurit konkretisht për problemin. Të shkruhet është më mirë se sa të thuhet. Të durohet është më mirë se sa të hiqet dorë. Kur është në pyetje vëllai, qëllimi yt duhet të jetë që të përmirësosh veten ashtu që do të kujdesesh për të, do të kryesh obligimet ndaj tij dhe do të durosh të metat e tij, e jo që nga ai të presësh ndihmë dhe përkrahje. Ebu Bekër Kettani tregon:

“Një njeri shoqërohej me mua, e unë në zemër kisha një peshë të rëndë nga ky shoqërim. Një ditë i dhurova diçka, me qëllim që ajo ndjenjë të largohej nga zemra ime. Por, nuk u largua. Një ditë tjetër e mora për dore, e dërgova në shtëpi, dhe i thashë:

- Vendos këmbët e tua në fytyrën time! Ai refuzoi, por i thashë që duhet gjithsesi ta bëjë. Kur e bëri, m’u largua nga zemra ajo peshë ndaj tij.”

Ebu Ali Ribati ka thënë:

- Shoqërohesh me Abdullah Raziun. Një herë, u nisëm për në shkretëtirë. Më pyeti:

- Kush do të udhëheqë, ti a unë?’ I thashë:

- Udhëheq ti. Më tha:

- Atëherë, duhet të dorëzohesh.

- Natyrisht, iu përgjigja. Mori një shportë, vendosi në të furnizimin për rrugë, dhe e bartte në shpinë. Kur i thashë të ma japë mua, më tha:

- A nuk më the që unë jam udhëheqësi? Do të thotë duhet të dorëzohesh. Një natë na zuri shiu. Qëndroi sipër meje tërë natën si një ombrellë, e më mbronte nga shiu. Sa e sa herë thashë me vete: ‘Më mirë të kisha vdekur, se që i thashë ‘ti je udhëheqësi.’”

E DREJTA E PESTË FALJA E GABIMEVE DHE E LËSHIMEVE

Lëshimet e vëllait kanë të bëjnë me fenë e tij, me shfaqje të gjynahut, ose me rrënimin e të drejtës tënde që ke te ai, në lidhje me vëllazërimin. Në gjynahet në të cilat ai këmbëngulë, duhesh reaguuar me të butë përmes këshillimit, në mënyrë që t'i kthehet të mirës dhe përmirësimit të vetes. Nëse nuk arrin ta bësh këtë, e ai edhe më tutje insiston në gjynahe, vazhdimi ose ndërprerja e vëllazërimit në veprimet e as'habëve dhe tabi'inëve në këso raste janë të ndryshme. Disa do të këmbëngulnin në bërjen e gjërave të cilat vëllai i do, e të tjerët do të ndërprisnin marrëdhënien me të.

Ebu Dherri r.a., për shembull, do të ndërpriste marrëdhënien. Ai do të thoshte:

“Siç e ke dashtë vëllanë kur iu ka përmirësuar gjendja, edhe kësaj radhe duhet ta urresh. Kjo është domosdoshmëri e dashurisë për Allahun dhe urrejtjes për Allahun.”

Nga ana tjetër, Ebu Derda r.a. dhe shumica e as'habëve marrin qëndrim tjetër. Ebu Derda r.a., ka thënë:

“Kur vëllai yt ndryshon, fillon të sillet ndryshe nga ajo se si do të duhej, mos e braktis, sepse ai është njeri - nganjëherë lakohet e nganjëherë drejtohet.”

Ibrahim Neha'i ka thënë:

“Mos i këput marrëdhëniet me vëllanë tënd për shkak të gjynahut që bën. Nëse sot ka bërë një gjynah, nesër do ta braktis.”

Ibrahimi gjithashtu ka thënë:

“Mos tregoni gabimin e dijetarit. Sepse dijetari e tejkalon atë gabim.”

E në hadith thuhet:

“Ruajuni nga gabimi i dijetarit, por mos i shkëputni marrëdhëniet me të; pritni përmirësimin e tij.”⁷⁰

Në një transmetim, hazreti Omeri r.a. interesohej për një vëlla me të cilin ishte vëllazëruar, e i cili kishte udhëtuar për në Sham. Kur një person u kthye nga Shami, Omeri e pyeti:

- *Si është vëllai im? Personi u përgjigj:*

- *Ai është vëlla i shejtanit! Ai bën gjynahe të mëdha, ka filluar edhe të pijë alkool.* Në këtë, Omeri tha:

- *Hesht! Kur të nisesh për në Sham, më trego. Do të doja t’ia dërgosh një letër nga unë.* Në letër i shkroi:

“Bismil’lahi’r-Rahmani’r-Rahim!

Hâ, Mîm. Shpallja e këtij Libri është prej Allahut, të Plotfuqishmit dhe të Gjithëdijshmit, Falësit të gjynaheve dhe Pranuesit të pendimit, i Cili dënon ashpër...” 40-Mu’min: 1-3

Tutje në letër e qortoi dhe këshilloi. Kur vëllai i tij lexoi çfarë i kishte shkruar Omeri r.a., filloi të qajë. Më pas tha:

- *Të vërtetën ka thënë Allahu Teala. Vërtetë, Omeri më dha këshillë të mirë.* U pendua për atë që kishte bërë, dhe i braktisi gabimet.

Transmetohet se dy vëllezër ishin vënë në sprovë. Njëri nga ta ishte vënë në sprovë me lakmi të keqe. I tregoi këtë vëllait të vet, dhe i tha:

- *Jam gjynahqar, prandaj nëse dëshiron të ndërpresësh vëllazërinë mes nesh - ndërpreje.* Në këtë, vëllai i tha:

- *Nuk do ta ndërprej vëllazërinë tonë për shkak të gjynahut tënd, kurrë.* Pasi tha kështu, iu betua Allahut se nuk do të hajë e as do të pijë derisa Allahu Teala të largojë lakminë e keqe nga vëllai i vet. Ashtu i kaloi

⁷⁰ Shënon Bergavi, në veprën **‘Mu’xhem’**, dhe Ibn Adijj në veprën **‘Kamil’**, nga Amr ibn Avfa Muzenij.

katërdhjetë ditë, dhe çdo ditë e pyeste vëllanë se si e ka gjendjen. Ky, çdo ditë do t'i përgjigjej:

-Zemra edhe më tutje këmbëngul në lakmi të keqe. Vëllai i cili nuk hante asgjë, dobësohej dhe ishte më i uritur nga dita në ditë, derisa, në ditën e katërdhjetë nuk u zhduk ajo gjendje nga vëllai i vet. Pas kësaj, filloi të hajë, pasi që gati ishte shkatërruar plotësisht.

Ngjashëm transmetohet edhe për dy vëllezër nga gjenerata e parë e myslimanëve. Njëri devijoi nga rruga e drejtë. Njerëzit e pyesnin vëllanë tjetër:

- Përse nuk i ndërpret marrëdhëniet me të, përse nuk e braktis? Ai u përgjigjej:

- Ajo që është më e rëndësishmja tani që ky ka rënë në gjynah, është që ta marrë për dore, butësisht ta qortoj, dhe ta ftoj që të kthehet në rrugë të drejtë.

Në njërin nga tregimet hebraike (*israillijjat*), transmetohet se dy vëllezër besimtarë po qëndronin në mal. Njëri nga ta zbriti në qytet për të blerë pak mish për një dërhem. Te kasapi e pa një prostitutë, ia nguli sytë, dhe u dashurua. E ftoi që të veçohen, bëri kurvëri, dhe qëndroi me të tri ditë e tri net. Nga gjynahu, i vinte turp të kthehej te vëllai. Vëllai tjetër e kërkoi, u brengos. Zbriti në qytet, dhe nuk ndaloi duke kërkuar vëllanë, derisa dikush e drejtoi. Hyri te ai, dhe e pa si po rrinte me prostitutën. U afrua, e përqafoi, u gëzua që e pa. Por, ky tjetri pretendonte se nuk e njohte, aq shumë turpërohej. Vëllai i tha:

- Çohu vëlla, e di çfarë ka ndodhur, e di tregimin tënd. Kur vëllai e pa se nuk ishte humbur në sytë e tij, pas të gjithave që kishin ndodhur, u ngrit dhe shkoi me të.

Disa preferojnë këso reagimi, dhe kjo është mënyrë më e butë dhe më e kuptueshme se sa reagimi i Ebu Dherrit r.a., por reagimi i Ebu Dherrit r.a, nga pikëpamja e selametit është më i bukur dhe më i drejtë.

Ti mund të pyesësh: “Pse po thua ‘më i butë’ dhe ‘më i kuptueshëm’? Ndërsa, miqësia me njerëz që janë kryengritës (gjynahqarë) është e papranueshme qysh nga fillimi, dhe duhet larguar prej tyre - a nuk është obligim të ndërpritet lidhja edhe me ata që pastaj bien në këtë gjendje? Meqë vendimet qëndrojnë me shkakun e vet, është e logjikshme që vendimet do të zhduken bashkë me zhdukjen e shkakut. Kurse shkak i vëllazërimit është ndihma në çështje të fesë. Ndërsa për atë që është dalldisur në kryengritje, kjo ndihmë nuk mund të vazhdojë.”

Në këtë vërejtje do të përgjigjesha:

Me termin ‘më i butë’ mendoj në kujdesin dhe afërsinë, kurse kujdesi shpie në kthim dhe pendim, si pasojë e turpërimit të vazhdueshëm të shprehur përmes shoqërimit. Aq sa ndërpritet marrëdhënia me të, aq ndërpritet edhe dëshira për shoqërim, kurse ai edhe më tutje këmbëngul dhe vazhdon në kryengritje.

Me termin ‘më i kuptueshëm’ mendoj në faktin që themeli i vëllazërimit është lidhja dhe afërsia shpirtërore. Kur krijohet kjo lidhje, forcohet edhe obligimi ndaj rregullave, rritet obligimi i përmbushjes së detyrave që dalin nga pranimi i lidhjes. Një mënyrë e përmbushjes së lidhjes është të mos neglizhohet vëllai në rast të ndonjë nevojë. Padyshim, nevoja në besim është më e rëndësishme se sa nevoja në pasuri. Kur e kaplon ndonjë e keqe, ka nevojë për ndihmë nga pikëpamja e fesë. Është obligim të kthehesh kah ai, t’i kushtohesh, kurrsesi mos ta neglizhosh. Aq më shumë, duhet vazhdimisht të jesh i butë ndaj tij në mënyrë që t’i ndihmosh për të zgjedhur problemin që e ka okupuar. Vëllazëri do të thotë ndihmë në kohë dhe ngjarje të vështira. A nuk është ky qëllimi në themelin e vëllazërisë? Kur një person i keq shoqërohet me të devotshmin, dhe vazhdimisht shikon frikë-respektin dhe qëndrueshmërinë e të devotshmit ndaj Allahut Teala, ai shpejt do të kthehet në rrugë të drejtë, dhe do të turpërohet nga këmbëngulja në gjynahe. Bile, nëse dembeli shoqërohet me të vyeshmin,

shumë shpejt do të turpërohet prej tij dhe fillon të punojë.
Xha'fer ibn Sulejman thotë:

“Sa herë dembelosem në veprim, do të shikoja Muhammed ibn Vasinë dhe me ndikimin e tij, menjëherë do të më kthehej dëshira për ibadete, e dembelizmi do të më kalonte. Kjo vazhdonte me javë.”

Këto shpjegime neve na tregojnë se personi që është në lidhje gjaku me dikë, nuk e lë të afërmin e vet për shkak të kryengritjes së këtij. Prandaj Allahu Teala rreth të afërmit të gjakut i tha Resulallahut s.a.v.s.:

“E, nëse nuk të dëgjojnë, thuaju: ”Unë nuk jam përgjegjës për ato që bëni ju’.” 26-Shuara: 216

Allahu urdhëroi respektimin e farefisit.

Në këtë udhëzoi edhe Ebu Derda r.a., kur dikush e pyeti:

- *Si ndodh që nuk e urren vëllanë tënd, kur ai ka bërë këtë e këtë?* Ebu Derda iu përgjigj:

- *E urrej veprën e tij, por jo vëllanë. E vëllazëria në fe është më e fortë se lidhja familjare!*

Hakimin e pyetën:

- *Cili të është më i dashur, vëllai yt apo shoku yt i sinqertë?* Ai u përgjigj:

- *Më të dashur e kam vëllanë tim, nëse më është shok i sinqertë.*

Hasani Basriu do të thoshte:

“Sa shumë vëllezër ka e që prej një nëne nuk kanë lindur.”

Për këtë është thënë:

“Farefisnia ka nevojë për dashuri, por dashuria nuk ka nevojë për farefisni.”

Xha'fer Sadiku r.a. ka thënë:

“Një ditë miqësi është mall për takim; një muaj miqësi - afërsi; një vit miqësi - fshehtësi personale. Kush e ndërprente këtë, Allahu Teala e largon nga rahmeti i Tij.”

Është kuptuar që duhet besnikëri në lidhjen e vëllazërisë e cila është krijuar më përpara.

Nga kjo përbëhet përgjigja jonë për dallimin mes miqësisë me ata që janë gjynahqarë (kryengritës) nga fillimi dhe me ata që pastaj dalldisen në gjynah. Sepse nuk është fjala për marrëveshje të vëllazërisë me atë qëkur është në rrugë të gabuar. Nëse ka afërsi farefisnore, kjo duhet respektuar. Por, ekziston edhe dëshmia që braktisja e vëllazërisë dhe shoqërimit me personin e tillë qysh në fillim, nuk është e papëlqyer, as e urryer. Aq më shumë, disa thonë që nuk është prioritet largimi nga një lidhje e tillë. Por, sa i përket ndërprerjes së vëllazërisë përgjithmonë, kjo është e ndaluar. Mospëlqimi i ndërprerjes së vëllazërisë vetëm në fillim, është e njëjtë me ndërprerjen e njëanshme të lidhjes martesore (talak) në krahasim me beqarinë (terkun-nikah). Ndërprerja e lidhjes martesore është më e urryer për Allahun Teala se sa beqaria. Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Robërit më të urryer tek Allahu Teala janë ata që bartin fjalët e huaja duke ndarë shokët dhe të dashurit.”⁷¹

Njëri nga gjenerata e parë e myslimanëve, për sa i përket fshehjes së gabimeve të vëllait, ka thënë:

“Ndërprerja e lidhjes me mikun duke e goditur atë në fytyrë me gabimet e veta, është një veprim që e dëshiron shejtani. Çka fitoni me përshtatje ndaj dëshirës së shejtanit?”

Shejtani, siç kënaqet duke i tubuar gjynahqarët (kryengritësit) në një vend, njëjtë kënaqet edhe me ndarjen e miqve. Nëse me tubimet e gjynahqarëve plotësohet një dëshirë e shejtanit, të paktën mos t'i plotësohet dëshira e dytë me ndarjen e miqve. Për këtë tregojnë fjalët e Resulallahut s.a.v.s. të drejtuara atij që mallkoi njeriun që pinte alkool, e Resulallahu s.a.v.s. i tha:

“Hesht... Mos u bëni ndihmës të shejtanit kundër vëllait tuaj.”⁷²

⁷¹ Ahmedi nga Esma bint Jezid.

Nga tërë ky sqarim i joni është kuptuar dallimi mes krijimit të miqësisë në fillim me njeriun e keq, dhe vazhdimin të miqësisë me gjynahqarin, pas krijimit të miqësisë me sinqeritet. Siç është gjë e ndaluar të hyhet mes gjynahqarëve, edhe ndarja e miqve është gjë e ndaluar. Ai që është i sigurt nga grindja me tjetërkënd, nuk është i njëjtë me atë që nuk është i sigurt nga kjo grindje. Në fillim njeriu është i sigurt nga grindja me njerëzit e këqij, e për këtë arsye është më mirë të jetë larg nga ta. Por, pas krijimit të miqësisë, është në gjendje të grindjes. Për këtë arsye është më mirë të vazhdohet vëllazërimi dhe besnikëria. Të gjitha këto janë gabime të vëllazërisë karshi fesë.

Kur është fjala për gabime karshi teje: këto gabime, sado që mundësojnë ndarjen, më mirë është të falen dhe të durohen. Bile, të kërkohen rrugët e interpretimit të mirë aq sa është e mundur, dhe në këtë mënyrë të mundohet të tolerohet miku; kjo është detyrë mu sikur e drejta e vëllazërisë.

Dikush pat thënë:

“Për një gabim të vëllait duhet të gjesh shtatëdhjetë arsyetime. Nëse zemra nuk ta pranon asnjërin nga to, atëherë drejtoju zemrës tënde, dhe thuaj: ‘Sa e ashpër je! Shtatëdhjetë arsyetime t’u ofruan për vëllanë tënd, dhe secilën e refuzove. Ti ke gabime, jo vëllai yt!’”

Nëse në asnjë mënyrë nuk bindesh, së paku zemërohesh. Por, edhe kjo është e vështirë.

Kështu që Imam Shafiu ka thënë:

“Ai që detyrohet të zemërohet dhe nuk zemërohet - është gomar. Ai që nuk lejon për t’ia hequr mërzinë - është shejtan.”

Njeriu nuk duhet të bëhet as gomar e as shejtan. Mundohu të kënaqësh zemrën tënde me përfaqësimin e vëllazërisë dhe largohu nga të qenit shejtan.

⁷² Buhariu nga Ebu Hurejre r.a.

Tregon Ahnefi:

“E drejta e vëllazërisë është durimi në tri gjendje: në zemërim, në naze (lazdrim), në gabim (rëshqitje e gjuhës kur nuk e mban fjalën).”

Dikush tjetër ka thënë:

“Kurrë nuk i kam thënë asnjë fjalë të keqe askujt. Sepse po të më thotë një fjalë të keqe personi i mirë, është e pahijshme mos t’ia fali. E po të më thotë një fjalë të keqe personi i keq, nuk e marr parasysht.”

E pas kësaj, këndoi:

*Fisnikut gabimet falja,
Atë mos e shaj,
E sharjet e të keqit leri,
Fisniku je ti, pastaj.*

Dikush tjetër ka kënduar:

*Merr nga shoku yt
Atë që të pëlqen
E hudhe atë që nuk t’pëlqen.
Ngase nuk mjafton jeta
Të përmirësohet ajo që të irriton
Mos preokupo veten me të.*

Dhe, sa herë që shoku yt të kërkon falje, pa marrë parasysht a e ka me sinqeritet apo jo, pranoje kërkim-faljen nga ai. Sepse Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Kujt i kërkon vëllai falje, e ky nuk e pranon, do t’i shkruhet gjynah, sikur atij që e ka bërë padrejtësinë.”⁷³

Resulallahu s.a.v.s. gjithashtu thotë:

“Besimtari, shpejt zemërohet, dhe shpejt pajtohet.”⁷⁴

⁷³ Ibn Maxhe dhe Ebu Davud në veprën *‘Merasil’* nga Xhevdani, dhe Taberani në veprën *‘Evsat’*, nga Xhabiri r.a..

⁷⁴ Version të ngjashëm shënon Tirmidhiu, nga Ebu Seid Hudri.

Pra, Resulallahu s.a.v.s. nuk e ka përshkruar besimtarin si dikush që fare nuk zemërohet. Edhe Allahu Teala thotë:

“të cilët e mposhtin zemërimin...” 3-Ali Imran: 134

e nuk thotë: *“të cilët nuk zemërohen.”* Nuk është qëllimi që njeriu të mos reagojë në dhimbje pas lëndimit, por që të durojë në të, ta bartë atë dhimbje. Ashtu siç është e natyrshme që lajmërohet dhimbje pas lëndimit, ashtu edhe reagimi me zemërim është natyrë e shpirtit. Nuk është e mundur të çlirohemi nga zemërimi, por është e mundur ta kontrollojmë atë, ta zotërojmë dhe të veprojmë të kundërtën e kërkesës së tij. Dhimbja kërkon shërim, hakmarrje dhe dëmshpërblim, e është e mundur që ashtu të mos veprohet. Poeti ka thënë:

“Mos e braktis shokun i cili nuk ka përmirësuar gabimet; ku do të gjesh plotësisht të përmirësuar?”

Ebu Sulejman Darani i tha nxënësit, Ahmed ibn Ebu Havariut:

“Në këto kohëra, nëse vëllazërohesh me dikë, mos e qorto për diçka që nuk të pëlqen. Nuk je i sigurt që si përgjigje nuk do të shohësh diçka edhe më të keqe se ajo për çka ankohesh.”

E Ahmed i ka thënë:

“E kam provuar këtë, dhe jam vërtetuar që ashtu është.”

Dikush pat thënë:

“Durimi i dhimbjes që të shkakton vëllai është më mirë se sa të qortosh vëllanë. E qortimi është më i mirë se sa ndërprerja e të gjitha lidhjeve. E ndërprerja e të gjitha lidhjeve është më e mirë se të jesh kundër tij. E kur je kundër tij nuk duhet tepruar.”

Ngase Allahu Teala thotë:

“Ndoshta Allahu do të lidhë miqësi midis jush dhe atyre me të cilët keni qenë armiq.” 60-Mumtehina: 7

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Duaje personin e dashur me dashuri të matur, ndoshta një ditë të bëhet personi që urren. Dhe urreje personin e urryer me urrejtje pa teprim, ndoshta një ditë të bëhet personi që e do.”⁷⁵

Hazreti Omeri r.a., ka thënë:

“Le të mos jetë dashuria jote vështirësi, dhe armiqësia zhdukje.”

E DREJTA E GJASHTË

DUAJA PËR VËLLANË, SA ËSHTË GJALLË DHE PAS VDEKJES

Në dua duhet lutur për gjithçka që do edhe vet, për vete dhe familjen tënde, dhe për gjithçka që është e lidhur me këtë. Të lutesh për vëllanë njëjtë si lutesh për vete, të mos bësh dallim mes vetes dhe tij. Duaja jote për të, në fakt është dua për veten tënde. Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Kur dikush lutet për vëllanë e vet, e ai nuk është prezent, një melek thotë: ‘edhe për ty njëjtë!’”⁷⁶

e në versionin tjetër:

“Allahu Teala thotë: ‘po filloj me ty, robi Im!’”

Kurse në hadithin tjetër thuhet:

“Lutjet që nuk pranohen për vetë personin pranohen për tjetrin.”⁷⁷

Në një transmetim thuhet:

“Duaja për vëllanë që nuk është prezent, nuk refuzohet.”⁷⁸

Ebu Derda r.a., thoshte:

“Në sexhde bëj dua për shtatëdhjetë vëllezërit e mi.”

⁷⁵ Tirmidhiu nga Ebu Hurejre r.a.

⁷⁶ Muslimi nga Ebu Derda r.a.

⁷⁷ Ebu Davud, kurse edhe Tirmidhiu ka një transmetim në këtë kuptim nga Abdullah ibn Omeri r.a..

⁷⁸ Darekutni në veprën *“ilel’*, nga Ebu Derda.

Muhammed ibn Jusuf Isfahani do të thoshte:

“E ku ka si vëllai i mirë?! Familja jote e ndanë trashëgiminë tënde, duke u kënaqur me atë që ti ke lënë pas. Vetëm ai është i pikëlluar për ty, brengoset për atë që ke përgatitur për ahiret, dhe ku do të jetë vendqëndrimi yt. Në pjesët më të shurdhra të natës, ai bën dua për ty, derisa ti je i shtrirë në tokën e zezë.”

Vëllai i mirë është si meleku, sepse në transmetim është thënë: *“Kur vdes njeriu, trashëgimtarët pyesin: ‘Çka la?’ E melaqet pyesin: ‘Çka solli?’. Nëse ka vepra - melaqet gëzohen dhe veprojnë me butësi.”*

Thuhet:

“Kujt t’i lajmërohet për vdekjen e vëllait, e ai duke ndjerë dhimbje kërkon falje prej Allahut për gabimet e tij, i shkruhet sikur të kishte falur xhenazen.”

Transmetohet se Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Shembulli i të vdekurit në varr është si shembulli i atij që po fundoset në ujë: kapet për gjithçka që sheh. I vdekuri pret duanë e pasardhësit, ose paraardhësit, ose vëllait, ose dikujt të afërt. Në të vërtetë, nga duatë e të gjallëve, në varret e të vdekurve hyn dritë sa malet.”⁷⁹

Dikush nga gjenerata e parë e myslimanëve ka thënë:

“Për të vdekurit, duaja është sikur dhurata për të gjallët. Melaqja zbret në varr te i vdekuri me një enë nga drita. Përmbi atë enë është një shami, gjithashtu nga drita. Melaqja thotë:

- Kjo është dhuratë për ty nga filan vëllai, nga filan i afërmi. I vdekuri i gëzohet asaj, ashtu siç i gëzohet i gjalli dhuratës.

⁷⁹ Ebu Hurejre Dejlemi në veprën *‘Musnedul-Firdevs’*, nga Ebu Hurejre r.a., si dhe Zehebi në veprën *‘Mizan’*.

E DREJTA E SHTATË VAZHDIMËSIA DHE NDERSHMËRIA

Vazhdimësi e dashurisë do të thotë besnikëri në dashuri dhe vazhdim i dashurisë deri në vdekje, e edhe pas saj, duke i dashur pasardhësit e tij dhe shokët e tij të singertë. Dashuria, në thelb është për ahiret. Nëse ndërpritet para vdekjes, i gjithë mundi humb. Prandaj Resulallahu s.a.v.s., duke i përmendur shtatë personat që do të jenë nën hijen e Arshit thotë:

“Dy persona që janë dashur mes vete për Allahun Teala, për atë arsye janë takuar, për atë arsye janë ndarë.”⁸⁰

Dikush ka thënë:

“Pak vazhdimësi e dashurisë pas vdekjes është më e vlefshme se sa dashuria gjatë gjithë jetës.”

Për këtë arsye transmetohet se Resulallahu s.a.v.s. i bëri shumë gosti një plake e cila erdhi te ai. Kur e pyetën për këtë, tha:

“Ajo vinte kur Hatixheja ishte gjallë, e shprehja e nderit ndaj të njohurve është pjesë e besimit.”⁸¹

Vazhdimësia e dashurisë ndaj vëllait nënkupton kujdes për shokët e tij të singertë, gjithë të afërmit e tij dhe gjithë personat e lidhur për të. Kujdesi ndaj tyre në zemrën e shokut të singertë është më e madhe se kujdesi ndaj vetvetes. Për më shumë, personi i tillë gëzohet kur gjurmon për dikë që ka qenë i lidhur me vëllanë e vet, sepse asgjë nuk jep ndjenjën e dhembshurisë dhe dashurisë më shumë se sa numri i madh i njerëzve ndaj të cilëve ndihet dashuria, e ku secili prej tyre

⁸⁰ Hadithin tashmë e kemi përmendur.

⁸¹ Hakimi nga Aisha r.anha.

është i lidhur në një mënyrë ose tjetrën me vëllanë. Bile edhe dashuria ndaj qenit para dyerve të tij, në zemër duhet të peshojë më shumë se dashuria ndaj qenve të tjerë.

Me ndërprerjen e dashurisë, shejtani gëzohet. Shejtani i mallkuar nuk i ka zili aq shumë dy persona që ndihmohen në bërjen e veprave të mira sa i ka zili dy persona që vëllazërohen për Allahun, që duhen për Allahun. Shejtani jep gjithçka nga vetja për të prishur këtë. Allahu Teala thotë:

“Thuaju robërve të Mi që të flasin atë që është më e mira. Në të vërtetë, shejtani mbjell ngatërresa në mes tyre.” 17-Isra: 53

E për gjendjen e Jusufit a.s., Allahu Teala na tregon:

“...pasi shejtani pati futur ngatërresë midis meje dhe vëllezërve të mi.” 12-Jusuf: 100

Thuhet: *“Nëse dy persona vëllazërohen për Allahun Teala, patjetër do të ndahen nëse njëri nga ta e do veprën e keqe (gjynahun).”*

Bishri thoshte:

“Kur personi bën mangësi në veprim, Allahu Teala nuk i shoqëron të tjerët me të.”

Vëllezërit janë ilaç për brengat, dhe ndihmesë në fe. Për këtë shkak, Ibn Mubareku ka thënë:

“Gjëja më e ëmbël është biseda (sohbet) me vëllezër dhe kënaqja me pak.”

Dashuria e përhershme ndodh vetëm përmes dashurisë për Allahun Teala, e jo për ndonjë qëllim tjetër; nëse është për këtë botë shpejt kalon. Mes frutash të dashurisë është edhe të mos kesh zili vëllanë, as për çështje të fesë, as të dynjallëkut. E si mund ta kesh zili, kur prej gjithçka që ka dobi vëllai, ke edhe ti?

Allahu Teala kështu i përshkruan ata që duhen për Allahun:

“...dhe në zemrat e tyre nuk ndejnë kurrfarë nevoje (për zili a tjetër), për atë që u është dhënë atyre, por duan t’u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes,” 59-Hashr: 9

Vazhdimësi në dashuri llogaritet edhe kur modestinë tënde nuk e ndërron kur je me vëllanë, e as nëse të rritet reputacioni, as nëse të jepet pozitë më e lartë, sepse ngritja sipër vëllait pas ndonjë përfitimi meriton gjithë qortimin. Për këtë arsye, poeti thotë:

*Fisnikët, ata të ndershmit,
Kur të mbushen me begati,
Kujtojnë kush ishte shoku i tyre,
Kur ishin në skamje e varfëri.*

Dikush nga gjenerata e parë e myslimanëve, i la porosi djalit të tij:

“Biri im, shoqërohu vetëm me atë i cili do të jetë afër teje kur ke nevojë për të, që nuk do të jetë lakmitar nëse nuk të nevojitet, dhe që nuk do të krenohet para teje nëse merr ndonjë pozitë të lartë.”

Një dijetar ka thënë:

“Nëse vëllai yt fiton ndonjë pozitë të lartë, e mbërrin të ruaj bile gjysmën e dashurisë ndaj teje, edhe kjo mjafton.”

Sylejman b. Abdulxhebar Rebi transmeton që Imam Shafiu u vëllazërua me një njeri nga Bagdadi. Pas një kohe, ai njeri fitoi pozitën e guvernatorit në Sibë, dhe plotësisht e ndërroi qëndrimin e tij ndaj Shafiut. Atëherë, Shafiu i dërgoi vargjet në vijim:

*Shko, se ajo dashuri e jotja
Në zemrën time ndërroi jetë,
Të bashkuara ato më s’janë,
Por, kjo nuk do të zgjatë përjetë.*

*Nëse megjithatë mbushesh mend,
Ndarja s' do të ketë fytyrë të vjetër,
Dashuria jote pas kësaj,
Te unë do të fitojë shansin tjetër.*

*Por, nëse vazhdon dashuria
Çmendi të njëjtë të ëndërojë,
Në një kohë prej dy muajsh,
Për herë të dytë do ta shkurojë,*

*Herën e tretë në ndodhtë e njëjta,
Shkurojëzim i prerë detyrohet,
Asgjë më nuk mund ta shpëtojë,
As pozita në Sibë nuk do të ndihmojë.*

Dije se nuk llogaritet si vazhdueshmëri e dashurisë pajtimi me vëllanë për atë që është në kundërshtim me të vërtetën (*hakk*), kur është në pyetje feja. Në fakt, vazhdueshmëria në dashuri në atë rast shihet në kundërshtimin e vëllait. Imam Shafiu u vëllazërua me Muhammed ibn Abdul-Hakemiun. E kishte shok të ngushtë dhe kalonte kohë me të. Pat thënë:

“Në Egjipt, vetëm me të shoqërohem.”

Një herë, Muhammedi u sëmur. Shafiu e vizitoi dhe i recitoi vargjet:

*U sëmur i dashuri një herë,
Drejt tij shkova fluturim,
E atje, vet u sëmura,
Se shumë u brengos shpirti im.*

*Atëherë i dashuri më erdh mua,
Në vizitë shokut të vet,
Sa e pashë veç një herë,
U shërova, plot shëndet.*

Njerëzit mendonin që Muhammedi, për shkak të sinqeritetit të dashurisë mes atij dhe Imam Shafiut, do ta zëvendësonte këtë në ligjërime. Kur Shafiu u sëmur për vdekje, e pyetën për këtë:

-Me kë do të ulemi në hallkë pas teje, o Abdullah?

Muhammedi u zgjat, që Shafiu të tregojë në të. E Shafiu tha:

- Subhanallah, edhe po pyetni?! Do të uleni në hallkë me Ebu Jakub Buvejtium.

Muhammedi atëherë braktisi hallkën e Shafiut, e nxënësit e Imam Shafiut ndoqën Buvejtium, pa marrë parasysh që ishte Muhammedi ai që përhap shkollën juridike (*medh'heb*) të Imam Shafiut. Por, Buvejtium ishte më i mirë, më i devotshëm dhe zahid më i madh. Pas vdekjes së Imam Shafiut, Muhammedi lëshoi *medh'hebin* e Shafiut, iu kthye *medh'hebit* Maliki të babait të tij dhe mbante ligjërata sipas mësimëve të imam Malikut, Allahu e mëshiroftë. Ai llogaritet ndër më të mëdhenjtë e *medh'hebit* Maliki.

Buvejtium i dha përparësi zuhdit dhe izolimit ndaj kallaballëkut dhe ndejave në hallka. U preokupua me ibadete dhe shkroi librin "*el-Umm*", e cila tash i atribuohet Rebi'i ibn Sulejmanit, dhe njihet si vepër e tij. E në fakt e ka shkruar Buvejtium, por nuk e ka përmendur veten në të, e as që e ka vendosur në çfarëdo lidhje me veten. Rebi'u e përpunoi, pak e ndryshoi, dhe e publikoi. Kam për qëllim të them: besnikëria e përkryer në muhabet (dashuri) është këshillë për rizanë e Allahut Teala.

Ahnefi ka thënë:

"Vëllazërimi është perlë delikate. Nëse nuk e ruan, i ekspozohet rreziqeve. Ruaje me përmbajtje nga zemërimi, deri në atë masë sa fillon të brengosesh për vëllanë, kur ai ushtron dhunë mbi ty. Vëllazërimin ruaje edhe me kënaqësi, deri në atë masë sa nuk i rritë as vlerat tua, as të metat e vëllait."

Si gjurmë, shenjë, besnikëri, sinqeritet dhe vazhdimësi e dashurisë është edhe të qenit shumë i pikëlluar në ndarje, dhe të ikësh nga shkaktarët e ndarjes, siç është thënë:

*Kuptova që të gjitha telashet,
Secila prej tyre që vjen në këtë jetë
Përveç ndarjes nga më i dashuri,
Nuk është gjë tjetër, pos bezdi e lehtë.*

Ibn Ujejne, i cili i kishte recituar këto vargje, ka thënë:

“Kam pasur shokë të sinqertë. U ndava prej tyre para tridhjetë vitesh, e pikëllimi për ta është ende në zemrën time.”

Vazhdimësi e dashurisë llogaritet edhe kur njeriu nuk dëgjon teprimet që njerëzit i flasin për shokun e tij. Sidomos të atij i cili një herë thotë që e do shokun e tij, që të mos akuzohet, e më pas fillon të flasë të kundërtën e kësaj dhe fillon të transmetojë gjëra që njollosin zemrën. Kjo është një nga dinakëritë më të mprehta që fusin përçarje. Kush nuk ruhet nga kjo, nuk do të ketë dashuri të përhershme.

Dikush i tha një dijetari:

- *Erdha të vëllazërohem me ty. Dijetari u përgjigj:*

- *Nëse i ofron tri vlera, do ta kesh. Personi pyeti:*

- *Cilat janë ato?, e dijetari tha:*

- *Të mos dëgjosh çfarëdolloj tregimesh, të mos më kundërshtosh në të drejtën, dhe të mos sillesh me mendjelehtësi.*

Vazhdimësi e dashurisë është edhe të mos shoqërohesh me armikun e mikut tënd të sinqertë.

Imam Shafiu ka thënë:

“Kur miku yt i sinqertë dëgjon armikun tënd, i është bashkangjitur armiqësisë.”

E DREJTA E TETË

DUHET LEHTËSUAR E JO VËSHTIRËSUAR, VETES DHE TJETRIT

Këtu mendohet në atë që të mos rëndosh vëllanë tënd me atë që i vije e vështirë. Duhet t'ia lehtësosh zemrën nga brengat dhe dëshirat, që asnjë problem të mos e mundojë. Prandaj, nuk do të duhej nga ai të kërkohet asgjë nga pozita ose pasuria. Mos insisto në të drejtat që i ke te ai. Për më shumë, duhet ta duash vetëm për Allahun, për bereqetin e duasë së tij, për kënaqësinë e takimit me të, për të ndihmuar në fe, me qëndrueshmëri në obligimet tua ndaj vëllait, dhe me durimin e shpërthimeve të tij, me qëllim për t'iu afruar Allahut Teala.

Dikush ka thënë:

“Kush kërkon nga vëllai atë që vëllai nuk kërkon nga ky, ai bën padrejtësi. E kush kërkon nga vëllai të ngjashmen që vëllai kërkon nga ky, ai po e lodh vëllanë. E kush nuk kërkon nga vëllai asgjë, ai është më i vlefshëm se vëllai i tij.”

Një dijetar pat thënë:

“Kush mundohet ta paraqes veten më lartë se sa është para vëllezërve, ai bëhet gjynahqar dhe e fut edhe vëllazërinë në gjynah. Nëse mundohet veten ta paraqesë aq sa është - ai lodhet, e edhe vëllezërit lodhen. Por me paraqitjen e tij më ultë se sa është, ai është i shpëtuar, e edhe vëllezërit janë të shpëtuar.”

Përmbushja e lehtësimit shihet përmes hezitimit në angazhimin e vëllait, deri në atë masë që të mos turpërohet para teje nga asgjë që nuk turpërohet para vetes.

Hazreti Alia r.a. ka thënë:

“Më i keqi ndër shokët e tu është ai që të vështirëson, ai i cili gjithmonë kërkon diçka nga ti, dhe ai që të detyron në kërkim-falje.”

Xhunejdi ka thënë:

“Kur dy njerëz vëllazërohen për rizanë e Allahut Teala, e më pas njëri kërkon të izolohet, ose thjesht izolohet, kjo nënkupton që te njëri nga ta ka të metë.”

Fudajli ka thënë:

“Vërtetë, njerëzit ndërpresin lidhjet kur i vështirësojnë njëri-tjetrit. Kur njëri viziton tjetrin dhe nëse vëllai ngarkohet në mikëpritje, personi nuk shkon prapë në vizitë.”

Aisha r.anha ka thënë:

“Besimtari është vëllai i besimtarit, nuk e shfrytëzon dhe nuk zemërohet me të.”

Xhunejd ka thënë:

“Jam shoqëruar me katër grupe sufi. Në secilin kishte nga tridhjetë njerëz: Haris Muhasibi me sufitë e tij, Hasan Mesuhi me të tijtë, Serri Sekati me sufitë e tij dhe Ibn Kurejbi me të tijtë. Meqë vëllazëria e tyre ishte për Allahun, asnjëri nuk ngurronte dhe nuk turpërohej prej tjetrit. Kur dy njerëz vëllazërohen për Allahun Teala, e më pas njëri kërkon të izolohet, ose thjeshtë izolohet, kjo nënkupton që ka të metë te njëri nga ta.”

Dikujt i është thënë:

- *Me kë të shoqërohemi?, e ai u përgjigj:*

- *Me atë që nuk bën propozime të panevojshme dhe nuk sillet i druajtur.*

Xhafer ibn Muhammed Sadik, Allahu qoftë i kënaqur me të, do të thoshte:

“Nga vëllezërit e mi, më së vështiri e kam me ata që mundohen dhe lodhen për mua, prandaj ruhem nga ta. E më së lehti e kam me ata me të cilët ndihem sikur të jem vetëm.”

Një sufi ka thënë:

“Shoqërohu vetëm me atë pranë të cilit as nuk i shton sjelljet e mira e as nuk i zvogëlon gabimet.”

Këtë e ka thënë, sepse kështu njeriu çlirohet nga obligimi dhe kujdesi i vazhdueshëm, duke qenë se natyra e shtynë njeriun në kujdes të shtuar, sepse kupton se bërja e të mirës ose e gjynaheve derisa është me të, e bëjnë më të vlefshëm ose më pak të vlefshëm në sytë e tij.

Dikush ka thënë:

“Ndaj të mëdhenjve sillu me edukatë, ndaj atyre të dhënë pas ahiretit sillu me dituri, e ndaj dijetarëve të vërtetë (arifun) sillu si të duash.”

E dikush tjetër ka thënë:

“Shoqërohu me atë që kur ti bën një gjynah, ai lutet që të falet gjynahu yt. Kur gabon kërkon falje në emrin tënd, në çaste të vështira të ndihmon dhe nuk bëhet ngarkesë për ty.”

Ai që ka thënë kështu, ka zvogëluar shumë rrugët e vëllezërve, por në esencë nuk është ashtu siç ka thënë ai. Aq më shumë, duhet vëllazëruar me secilin që është në fe, që është i kuptueshëm, duke respektuar kushtet e përmendura, në këtë mënyrë duhet vepruar me qëllim që të shtohet numri i vëllazërisë. Vëllazërimi duhet të jetë vetëm për Allahun Teala. Në të kundërtën, vëllazërimi bëhet vetëm për të përfituar nga vëllai.

Për këtë, njëri i kishte thënë Xhunejdit:

- *Vëllazëria është e pakësuar në këto kohëra. Ku ta gjej dikë që të më jetë vëlla për Allahun Teala? Xhunejdi nuk foli, njeriu tri herë e përsëriti, e në fund Xhunejdi i tha:*

- *Nëse dëshiron vëlla që do të durojë, dhe do të bartë shqetësimet tua, kjo është pak e vështirë të gjindet - më beso. E nëse dëshiron vëlla për Allahun Teala, që ti atë ta durosh, dhe ti të bartësh shqetësimet e tij, e kam xhematin tim, të prezantoj me ta. Pas këtyre fjalëve, personi heshti.*

Dije se ekzistojnë tri lloje njerëzish: ai prej të cilit ke dobi, ai prej të cilit ndoshta do të kesh dobi - nuk të dëmton por as që ke ndonjë dobi nga shoqërimi me të, dhe ai prej të cilit nuk mund të kesh dobi, e që të bën dëm. Ky i fundit është budalla dhe person me sjellje të keqe, e nga ai duhet të largohesh. Nga lloji i parë i njerëzve nuk ke nevojë të ruhesh sepse në ahiret do të kesh dobi nga ndërmjetësimi dhe duatë e tyre, si dhe me sevapin që do ta fitosh duke u munduar që të respektosh të drejtat e tyre te ti. Allahu Teala i shpalli Musait a.s.:

“Nëse duron vështirësitë e miqve të cilët më janë nënshtruar Mua dhe nuk i xhelozon, do të kesh shumë vëllezër”,

Dikush ka thënë:

“Jam vëllazëruar me njerëz për pesëdhjetë vite. Kurrë nuk ka pasur mospajtim mes meje dhe atyre. Ata i kam trajtuar si veten time.”

Kush posedon veti të këtilla, do të ketë shumë vëllezër.

Në lehtësim dhe mos-vështirësim bën pjesë edhe ajo që të mos pengosh vëllanë në kryerjen e ibadeteve nafile. Një grup dervishësh shoqërohej mes vete, por me respektimin e katër kushteve: Nëse dikush do të hante tërë ditën, askush nuk do t'i thoshte: *“Agjëro”,* e nëse dikush do të agjëronte

tërë ditën, askush nuk do t'i thoshte: *"Mos agjëro"*. Nëse dikush do të flinte tërë natën, askush nuk do t'i thoshte: *"Çohu"*, e nëse dikush do të rrinte zgjuar gjithë natën, askush nuk do t'i thoshte: *"Fli"*. Sido që të sillej, tjetri do ta pranonte, pa shtuar ose hequr gjë. Sjellja e tyre nuk ka ndërruar edhe mes njerëzve. Siç kanë vepruar mes vete ashtu kanë vepruar edhe mes njerëzve, kështu që janë ruajtur nga dyfytërsia (rija), e prej saj - s'ka dyshim - duhet ruajtur.

Kështu thuhet mes arabëve:

"Kushti i miqësisë është braktisja e vështirësisë. Prandaj me atë që nuk vështirëson dhe që nuk jep ngarkesë, edhe miqësia edhe dashuria vazhdon."

Njëri nga as'habët ka thënë:

"Vërtet, Allahu Teala ka mallkuar njerëzit që ua vështirësojnë të tjerëve."

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

"Unë dhe të devotshmit e ummetit tim jemi të shpëtuar nga të dhënit ngarkesë dhe vështirësi tjetrit."⁸²

Dikush ka thënë:

"Nëse dikush i bën katër gjëra në shtëpinë e vëllait të vet, do të thotë që është kompletuar afërsia mes tyre: nëse ushqehet te ai, nëse përdor tualetin e tij, nëse falet te ai dhe nëse fle te ai."

Kjo iu përmend njërit prej shehlerëve, e ai tha:

"Është edhe e pesta: të shkojë me bashkëshorten te shoku si mysafir dhe nëse dëshirojnë – të flenë aty. Sepse shtëpia ndërtohet për të bërë këto pesë gjëra fshehurazi. Përndryshe, vetëm për ibadet – xhamitë janë më të përshtatshme. Nëse këto pesë gjëra mund të bëhen në shtëpinë e vëllait - miqësia forcohet."

⁸² Darekutni në veprën *'Ifrad'*, nga Zubejre ibn Avam r.a.

Këtë më së miri e tregon mënyra se si arabët përshëndesin shokun:

“Merhaba, ehlen ve sehlen!”,

Domethënë: *Jemi të lumtur, gjerësisht i ke të hapura zemrën dhe vendin, ndjehi i afërt me ne, mos u ndjej i huaj; krejt kjo nuk është e vështirë për ne, çka do që dëshiron nuk e kemi të vështirë të të ofrojmë.*

E lehtësimi dhe mos-vështirësimi nuk do të kompletohen derisa nuk shikohet gjithmonë vetja e jo vëllai, derisa nuk ke mendim të mirë për ta, e të keq për veten. E kur personi sheh vëllezërit e vet si më të mirë se ai, atëherë ai në fakt është më i mirë se ata.

Ebu Muavi Esvedi ka thënë:

- *Të gjithë vëllezërit e mi janë më të mirë se unë.* Dikush e pyeti:

- *Si ashtu?*, e ai u përgjigj:

- *Secili prej tyre mendon se unë jam më i mirë se ai, e kush më sheh mua më të mirë se veten, ai është në fakt më i mirë se unë.*

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Njeriu është në fenë e shokut të vet të ngushtë, nuk ka dobi nga shoqërimi me atë që nuk mendon për ty më mirë se sa që ti mendon për të.”⁸³

Shkalla më e ulët është të shihet vëllai ashtu siç e sheh veten, e vlera më e lartë vjen kur vëllai shihet më i mirë se vetja. Prandaj Sufjani Sevriu ka thënë:

“Nëse dikush të thotë: ‘O më i keqi prej njerëzve!’ e ti hidhërohesh, atëherë vërtetë je më i keqi prej njerëzve.”

⁸³ Ibn Adijj në veprën *‘El-Kamil’*, nga Enesi r.a.

Pra, edhe duhet të konsiderosh veten më i keqi nga njerëzit. Për këtë inshallah, do të flasim në librat mbi mburrjen dhe vetëpëlqimin. Dikush i ka kënduar vargjet:

*Përulu para vëllait tënd,
Sikur t'i kishe bërë zi,
Këtë merre si vlerë,
Jo budallaki.*

*Dhe largohu nga shoqërimi
Me të tillin menjëherë,
Që shokëve u sheh gabimet,
E veten e sheh me vlerë.*

E dikush tjetër thotë:

*Një njeri e pashë,
E kishin hedhë si fletë,
Në zemër shtëpi i dhashë,
M'u bë mik i vërtetë.*

Sa herë që personi sheh ndonjë vlerë te vetja, ai ka përlulur shokun e vet. Kjo është e papëlqyer për myslimanin. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Për besimtarin mjafton si keqbërje ofendimi i vëllait mysliman.”⁸⁴

Në sinqeritet ndaj vëllezërve hyn edhe këshillimi me ta për gjithçka që duam të bëjmë, dhe në pranimin e këshillave të tyre. Allahu Teala thotë:

“...dhe këshillohu me ta...” 3-Ali Imran: 159

⁸⁴ Muslimi nga Ebu Hurejre r.a. E kemi cekur edhe më herët.

Asgjë nuk duhet fshehur nga vëllezërit, ashtu siç transmetohet se Jakub ibn Ebu Ma'ruf ka treguar:

“Esved ibn Salim erdhi te axha im, Ma'rufi dhe i tha:

- Bishr ibn Haris dëshiron të vëllazërohet me ty, por turpërohet të flasë me ty. Prandaj më porositi mua të të pyes të pranosh vëllazërinë mes jush. Por, ka një kusht, nuk do të donte që kjo të dëgjohej. Nuk do të donte që të vizitoni njëri-tjetrin, të takoheni, sepse nuk i do komplimentet. Ma'rufi iu përgjigj:

- Por unë, po të vëllazërohesh me dikë, nuk do të doja të ndahesha nga ai, as natë as ditë. Do ta vizitoja në çdo kohë, dhe do t'i jepja përparësi ndaj meje në gjithçka. Më pas i përmendi vlerën e lartë të vëllazërimit për Allahun Teala. Citoi shumë hadithe të Resulallahut s.a.v.s. e më pas tha:

- Pejgamberi a.s. u vëllazërua me Alinë r.a. dhe me të ndau diturinë⁸⁵, me të ndau kurbanin, e martoi me vajzën e tij më të dashur. Tani, ti bëhu dëshmitar që unë kam pranuar vëllazërimin me Bishrin, dhe që kam pranuar të fsheh faktin që të ka dërguar ty për të më përcjellë lutjen e tij, dhe që ai nuk do të më vizitojë, nëse nuk do, por unë do ta vizitojë atë sa herë të dua. Le të më takojë në vendet që ai zgjedh, dhe urdhëroje që nga unë të mos fsheh asgjë, dhe të më tregojë për të gjitha gjendjet e tij.

Ibn Salimi i përcolli këtë Bishrit, i cili ishte i kënaqur me këtë.

Këto janë të drejtat në vëllazërim. Në disa raste vetëm i përmendëm, e në raste tjera detajizua më shumë. Por, asnjëra nga to nuk do të kompletet derisa nuk anon kah ndihma vëllait, në vend të vështirësimit. Duhet t'i ndihmosh gjithmonë, me të gjitha gjymtyrët dhe të lidhesh i tëri për të drejtat që ai i ka mbi ty.

⁸⁵ Nesai në kapitullin 'el-Hasa'is' të veprës 'es-Sunen el-Kubra', nga hazreti Alia r.a., edhe Hakimi nga hazreti Ibn Abbasi r.a., si dhe Tirmidhiu nga Ibn Omeri r.a.

Për sa i përket shikimit të brendshëm, vëllanë gjithmonë shikoje me dashuri, ashtu që ai ta njeh atë shikim. Gjithmonë shih si t'i bësh mirë, dhe bëhu i verbër në të metat e tij. Vetëm kështu shikoi vëllezërit e tu, dhe mos ndërro, as kur i takon, as kur flet me ta.

Transmetohet se Resulallahu s.a.v.s., të gjithëve që uleshin me të, do t'iu dhuronte disa shikime⁸⁶. Do të kthehej kah secili person që ishte ulur me të dhe aq përkujdesej për atë sa që secili mendonte se është më i miri. Ndeja me të ishte ndejë e turpërimit, modestia, ndjenjë e përuljes, sigurisë dhe intimitetit. Resulallahu s.a.v.s., me buzëqeshje i takonte as'habët, kënaqej nga fjalët e tyre dhe me dëshirë i dëgjonte. Edhe as'habët buzëqeshnin kur buzëqeshte Resulallahu s.a.v.s., duke iu përshtatur edhe në këtë, në shenjë respekti.

Sa i përket dëgjimit, dëgjo të folurit e vëllait tënd duke u ëmbëlsuar me këtë, konfirmo vërtetësinë e asaj që ai flet dhe qartë shpreh kënaqësinë për atë që ai flet. Mos e ndërpre vëllanë derisa ai flet, duke dashur t'i thuash diçka, ose thjesht për ta kundërshtuar. E nëse fuqishëm dëshiron t'i shprehësh kundërshtim, fillimisht kërkoi falje. Ruaj veshët tuaj që të mos dëgjojnë atë që vëllai nuk e do.

Kur është fjala për gjuhën, kemi përmendur të drejtat e lidhura me këtë, prandaj të flitet prapë për këtë, do të bëhej shumë. Por, të përmendim që këtu bën pjesë edhe mosngritja e zërit drejt tyre, dhe të mos u flasësh ndryshe, pos ashtu si ata kuptojnë.

⁸⁶ Tirmidhiu në veprën '*esh-Shema'il'*, transmetuar nga hazreti Alia r.a.

E sa u përket duarve - të mos i mbyllësh në asgjë ku mund t'i ndihmohet, në çdo rast ku dora mund të ndihmojë.

Këmbët - të ecësh pas vëllait ashtu siç ecin ata që ndjekin, jo ata që udhëheqin. E nëse veç ecën përpara tyre, të mos bësh hapa ashtu që vëllai të mos mund të të arrijë, por as të mos i jesh aq afër që ai të mos mund të ecë.

Të ngrihesh në këmbë kur të vijë, të mos ulesh para se ai të ulet. E kur ulesh, ulu me modesti. E nëse do Allahu e bëheni një, lehtësoja që të mos i duhet aq rreptë t'i përmbahet rregullave ndaj teje, siç janë vigjilenca, ndjesa dhe lavdërimi, sepse këto bëjnë pjesë në të drejta që duhet respektuar në shoqërim, e duke pasur kujdes për to, lajmërohet një lloj tjetërsimi dhe ngarkese. E kur bashkimi të kompletohet, vështirësitë zhduken plotësisht, kështu që kur ec me të, je sikur të ecësh i vetëm.

Këto rregulla të dukshme të sjelljes (edebe) janë në fakt vetëm shenja të vetive të bukura të brendshme, dhe të pastërtisë së zemrës – kur zemra të pastrohet, nuk ka më nevojë t'ia vështirësojë tjetrit me atë që ka brenda.

Kush dëshiron të shoqërohet me njerëzit, nganjëherë do të gabojë, e nganjëherë do të respektojë të drejtat. Por kush e dëshiron Krijuesin, e ka obligim të respektojë të drejtat, si ato të manifestuara, ashtu edhe ato thelbësore. I tilli do të stolisë brendësinë e vet me dashuri për Allahun dhe ndaj krijesave të Tij.

Me sjellje të bukur, robi do të arrijë nivelin e namazliut dhe të agjëruesit, e edhe më shumë.

PËRFUNDIMI I KAPITULLIT TË DYTË

Këtu shkurtimisht do të përmendim rregullat e sjelljes, shoqërimit dhe miqësisit me njerëz të ndryshëm, duke i nxjerrë këto nga fjalët e dijetarëve.

Nëse dëshiron të kalosh mirë me njerëz, sillu me buzëqeshje edhe me miqtë edhe me armiqtë. Karshi çdokujt. Sillu me modesti por pa poshtërim dhe me respekt të thellë të çliruar nga mburrja. Meqë tejkalimi i masës është i papëlqyer, gjithmonë preferoni rrugën e mesme.

Mos mbaj shpresë në butësinë tënde, mos kundërshto vazhdimisht, mos iu kundërvë qëndrimit të shumicës, dhe mos i komplikoj gjërat në ndeja. Mos i kryqëzo gishtat, mos luaj me mjekër dhe me unazë, dhe mos i çukit dhëmbët. Mos fut gishtin në hundë. Mos pështyj, mos gërhit, mos i ndjek mizat para teje, mos përtyp, mos i hap gojën në fytyrë tjetrit, as në namaz, as jashtë tij. Sjellja jote në shoqëri le të jetë udhëzim për të tjerët, e të folurit tënd preciz dhe logjik. Të folurit zbukuroje në maksimum, pa mendjemadhësi. Mos kërko nga shoku që ai ty të të vizitojë. Mos reago zhurmshëm në tregime. Mos lavdëro djalin ose vajzën tënde, familjen tënde, vargjet tua, veprat e shkruara, dhe gjithçka tjetër që të bën të veçantë. Mos e tepro në çdo lloj zbukurimi. Mos këmbëngul në lutje. Askënd mos e inkurajo në kundërshtim. Mos i trego fëmijëve tu, e sidomos jo të të tjerëve, sa ke pasuri. Sepse, po të shohin që ke pak – të nënvlerësojnë, e po të shohin që ke shumë – nuk do të mund t’i kënaqësh gjithë kërkesat e tyre. Sillu ashtu që të të frikësohen, por pa dhunë. Bëhu i butë me ta, por jo i pafuqishëm. Mos u qesh me shërbëtorët tu, se nuk do të respektojnë.

Kur diskuton, shpreh besimin dhe ruaju nga mosdija jote. Evito nxitimin, dhe vazhdimisht mendo për dëshmitë që mendon se i ke. Mos bëj së tepërmi gjeste. Mos u kthe shpesh kah ata prapa teje. Fol pasi të kalon zemërimi.

Nëse je në afërsi të sundimtarit, të jesh pranë tij si mbi thikë. Nëse është i mirë me ty, mos mendo se situata nuk mund të ndërrojë. Të jesh i butë ndaj tij, siç je i butë me fëmijët. Foli atë që ai dëshiron të dëgjojë, derisa në atë që thua nuk ka ndonjë gjynah. Mos të të josh butësia e tij ndaj teje, e të ndërhysh mes tij dhe familjes së tij, fëmijëve të tij dhe shërbëtorëve të tij, qoftë edhe nëse ti në sytë e tij këtë e meriton. Mospajtimet përbrenda shtëpisë, në mes të kreut të familjes dhe familjarëve tjerë, nuk nxirren jashtë, e as që flitet për problemet e mundshme.

Ruaju nga shoku i cili vazhdimisht lëshon pe, ai është njëri ndër armiqtë më të mëdhenj. Mos të jetë prona më e vlefshme se nderi.

Kur shkon në ndejë, jep selam i pari, mos kalo para atij që ka mbërri para teje, ulu atje ku ka vend, që i përshtatet modestisë. Derisa je ulur, jepi selam atij që është afër teje. Mos u ul rrugës. E nëse detyrohesh të ulesh në rrugë, ruaj shikimet dhe mos shiko çdokënd që kalon, t'i ndihmosh atij që i bëhet dhunë, t'i zgjasësh dorën të përbuzurit, t'i japësh mbështetje të dobët, ta drejtosh të humburin dhe të përgjigjesh në selam. Duhet ofruar atë që kërkohet nga ti, të urdhërosh të mirën, të ndalosh të keqen. Kujdes mos qëndro aty ku dikush ka pështyrë, mos pështyj drejt kiblës, e as në të djathtë. Pështyj në anën e majtë, dhe atë nën këmbën tënde të majtë.

Mos rri me sundimtarët, e nëse këtë veç e bën, mos bëj telendisje (gibet), qëndro larg gënjeshtreve dhe zbulimit të fshehtësive. Kërko pak, dhe kujdes si shprehesh. Formulo

fjalitë në mënyrë të rregullt. Këshillohu bukur me sundimtarët, dhe sa më pak bëj shaka me ta. Ruaju nga ta, edhe nëse të lajmërohet dashuri ndaj tyre. Mos gromësisj, dhe kur je te ta mos i gërmo dhëmbët pas ngrënies.

Mos u shoqëro me njerëzit e pavlerë, e nëse veç e bën këtë, në bisedë me ta mos fol shumë. Mos dëgjo lajmet e rrejshme që i bartin, as të folurit e shëmtuar, dhe mos u shih shpesh me ta për ndonjë nevojë që mund të kesh.

Ruaju nga bërja shaka, si me njerëzit e matur ashtu edhe me ata që nuk janë të tillë. Për shkak të shakasë, i maturi mund të të urrejë, e i pamaturi të të sulmojë, sepse bërja shaka largon ndrojtjen, rrënon nderin, tërheq urrejtje dhe largon lezetin e dashurisë, të dijshmëve ua turbullon mendjen, e mendjelehtët i nxitë. Kështu njeriu humb pozitë të dijshmi, kurse besimtarët fillojnë ta përbuzin. Sjelljet e tilla e mbysin zemrën, largojnë nga Allahu Teala, me vete tërheqin neglizhencë dhe përcmim. Me sjellje të tilla zbulohen të fshehtat dhe humbin idetë, rriten të metat dhe zbulohen gjynahet. Është thënë: *“Shakaxhi mund të jetë vetëm budallai ose i pandershmi.”*

Kush sprovohet të shoqërohet me shakaxhinjë ose të zhurmshmin, le ta përkujtojë Allahun Teala. Sepse Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Kush me një ndejë (mexhlis) folë panevojshëm, por thotë para se të ngrihet këto fjalë: ‘subhaneke allahumme ve bi hamdike eshedu en la ilahe illa ente estagfiruke ve etubu ilejke’ (I Lartësuar je, Allahu im, hamdi të takon Ty, dëshmoj që nuk ka ilah tjetër pos Teje, nga Ti falje kërkoj dhe tek Ti pendohem)’, do t’i falet ajo që ka bërë në atë ndejë.”⁸⁷

⁸⁷ Tirmidhiu, nga Ebu Hurejre r.a.

Kapitulli i Tretë

MBI OBLIGIMET KARSHI TË TJERËVE DHE KOMUNIKIMIN ME NJERËZIT

Dije se njeriu ose është vetëm ose me të tjerët. Pasi që nuk mund të jetojë vetë dhe ka nevojë për të njëjtin lloj, njeriu duhet të mësojë rregullat e sjelljes (edeb) në lidhje me të tjerët.

Secili ka një sjellje dhe veprim karshi tjetrit. Kjo është sipas të drejtave të tjetrit, e të drejtat e njerëzve ndërrohen sipas afërsisë. Lidhjet e afërsisë janë:

1. Lidhja e afërt. Kjo është një lidhje më e veçantë.
2. Lidhja e vëllazërisë islame, që është më e përhapur.
3. Lidhja e fqinjësisë.
4. Lidhja e shoqërisë në udhëtim dhe mësim.
5. Lidhja e miqësisë dhe vëllazërimit.

Secila nga këto lidhje ka gradat veç e veç. Për shembull, edhe familja e ngushtë edhe farefisnia kanë të drejta, por e drejta e familjes ka përparësi. E drejta e gruas është e veçantë; por të drejtat e prindërve janë më të rëndësishme. Njëjtë, edhe të drejtat e fqinjëve ndërrojnë sipas afërsisë dhe largësisë së tyre. Padyshim që më së shumti të drejta kanë ata që janë më afër. Bile, dy veta që janë nga i njëjti shtet (vendlindje), jashtë shtetit llogariten si fqinj. Njëjtë edhe e drejta e myslimanit forcohet në proporcion me njohjen e ndërsjellë.

Edhe këto njohje kanë gradat e tyre. Një mysliman me të cilin nuk je njoftuar i posedon te ti të drejtat e tij islame. Kur ia dëgjon emrin, kjo e drejtë forcohet më shumë. Kurse e drejta e myslimanit me të cilin je njoftuar është më e fortë se

e atij të cilit vetëm ia ke dëgjuar emrin. Edhe njoftimi ka gradat e veta, dhe sipas këtyre gradave ekzistojnë të drejta të ndryshme. Me atë mysliman që je i përzemërt edhe të drejtat janë më të fuqishme. Edhe në shoqërim është njëjtë. Shoku i udhëtimit ka të drejtat e tij, por më të fuqishme janë të drejtat e shokut të mësimi. Njëjtë është edhe me miqësinë; kur forcohet miqësia, kalon në vëllazëri, e nëse edhe më shumë forcohet shndërrohet në dashuri. Halili (miku i përzemërt) është më i afërt se sa habibi (i dashuri). Muhabeti (dashuria/biseda miqësore), është një dashuri e vendosur në zemër. Ndërsa miqësia e përzemërt/sinqertë (hullet) është një dashuri që hyn në thellësitë e zemrës. Për këtë arsye çdo halil është habib, por çdo habib nuk është halil. Në krijimin e miqësisë dhe sinqeritetit ekzistojnë grada të ndryshme, dhe kjo bëhet e qartë nga vrojtimit dhe përvoja.

Të thuhet që miqësia e përzemërt është më e lartë se vëllazërimi është sikur të deklarohet që miqësia e përzemërt është më e përkryer se vëllazërimi. Kjo çështje kuptohet lehtë nga fjalët e Resulallahut s.a.v.s.:

“Nëse do të kisha marrë halil (mik të përzemërt), do të kisha zgjedhur Ebu Bekrin; por shoku i juaj (Muhammedi a.s.) është halil i Allahut.”⁸⁸

Do të thotë: halil është dashuria që ka mbyllur të jashtmen dhe të brendshmen e zemrës. Zembrën e Muhammedit a.s., e ka mbyllur vetëm dashuria e Allahut. E ky sinqeritet ndalon partneritet në atë dashuri. Por Muhammedi a.s., ka pranuar për vëllazëri hazreti Alinë r.a., dhe ka thënë:

“Si ka qenë Haruni për Musanë edhe Alia është për mua, përveç profetësisë (nubuvvet).”⁸⁹

⁸⁸ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Said el-Hadri.

⁸⁹ Buhariu dhe Muslimi nga Sa’d Ebi Vakkasi.

Siç nuk e pranoi si halil hazreti Ebu Bekrin r.a., edhe hazreti Alinë r.a. nuk e pranoi në nubuvvet. E i bashkoi Ebu Bekrin r.a., me Alinë r.a., në vëllazëri. Nga pikëpamja e afërsisë së përzemërt dhe sinqeritetit, Ebu Bekrin r.a. e vendosi më përpara. Në qoftë se *halili* do të pranonte ortakllëk: “...do të kisha zgjedhur Ebu Bekrin...”, Ebu Bekri r.a., këtë e kishte merituar.

Muhammedi a.s. është edhe habib edhe halil i Allahut Teala. Sipas transmetimit, një ditë Muhammedi a.s., u ngjit në minber i buzëqeshur e i lumtur, dhe tha:

“Allahu Teala më mori për halil. Edhe Ibrahimin a.s. e kishte marrë për halil. Tani, unë jam edhe habibi edhe halili i Allahut Teala.”⁹⁰

Po kuptohet që para njohjes (marifet) nuk ka lidhje (rabita), dhe pas sinqeritetit/përzemërsisë (hullet) nuk ka gradë. Të gjitha gradat janë në mes të marifetit dhe hullet-it. Të drejtat e shoqërimit dhe vëllazërisë i kemi treguar më herët. Edhe dashuria (muhabet) me miqësinë e përzemërt (hullet) hynë në këtë. Ndryshimet e gradave në këto të drejta ndahen në lidhje me ndryshimet e gradave në muhabet dhe vëllazëri. Bile, grada e fundit në vëllazëri është të preferosh pasurinë dhe jetën tënde për vëllain. Kështu është sjellur Ebu Bekri r.a., ndaj Resulallahut s.a.v.s.; Ebu Bekri r.a., edhe pasurinë edhe jetën ia kushtoi rrugës së Resulallahut s.a.v.s.. Edhe Talha r.a., në betejën e Uhudit është bërë strehë për Resulallahun s.a.v.s., me trupin e vet.

Tani do të flasim rreth të drejtave të vëllazërisë islame, të familjes së ngushtë: babai, nëna dhe të tjerë, fqinjët, dhe ata që myslimani i ka nën mbikëqyrje. Të drejtat mes burrit dhe gruas i kemi treguar në librin **“Rregullat e jetës martesore”**.

⁹⁰ Teberani nga Ebu Umama.

DETYRAT E MYSLIMANËVE

Detyrat më të rëndësishme të myslimanëve janë:

- Të përshëndetet kur takohet me tjerët;
- Kur ftohet, të pranojë ftesën;
- Kur tjetri teshtin dhe thotë *'Elhamdulillah'* të thuhet *'Jerhamukallah'*;
- Kur sëmuret tjetri, të vizitohet;
- Kur vdes – t'i falet xhenazja;
- Kur jep fjalën, ta mbajë;
- Kur kërkon këshillë, të thotë të drejtën;
- Të mbrohet tjetri kur nuk është prezent;
- Atë që do për vete, ta dojë edhe për tjetrin, dhe atë që nuk e do për vete të mos e dojë as për tjetrin.

Rreth të gjitha këtyre ekzistojnë hadithe dhe tregime të myslimanëve të gjeneratës së parë.

Sipas transmetimit të Enesit r.a., Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:"

"Myslimani ka katër detyra: të ndihmojë atë që është bamirës, të kërkojë falje për gjynahqarët, të bëjë dua për ata që nuk janë prezent dhe të dojë ata që janë penduar (kanë bërë teube)."⁹¹

Abdullah b. Abbas r.a. ka thënë në komentimin e ajetit **"...janë të mëshirshëm ndërmjet vete..."** (48:29), që të mirët bëjnë dua për të këqinjte dhe të këqinjte bëjnë dua për të mirët.

Të mirët nga ky ummet kur i takojnë të mirët luten: *"O Allah, këtë të mirë që ia dhurove bekoje, dhe këtë të mirë vazhdoje, dhe bëj që edhe të tjerët të kenë dobi nga kjo e mirë e tij."*

⁹¹ Transmetimin e këtij hadithi e shënon ed-Dejlemi, autori i veprës *'Firdevs'*.

E kur takojnë njerëz të këqinj thonë: *“O Allah, udhëzoje në rrugë të drejtë, dhuroi pendimin dhe falja gabimet.”*

Pra, detyrë e myslimanit është që të dojë për tjetrin atë që do për vete, dhe atë që nuk e do për vete të mos e dojë as për tjetrin.

Numan b. Beshir r.a., ka treguar që Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Besimtarët janë si një trup, edhe në dashuri dhe në dhimbje. Kur një pjesë e trupit sëmuret, tërë trupi është nën ethe dhe i shqetësuar; siç vepron njeriu për shërimin e asaj pjese të trupit, edhe myslimanët ashtu duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin.”⁹²

Sipas transmetimit nga Ebu Musa el-Esh’ari r.a., Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Besimtarët janë si gurët e ndërtesës, lidhen bashkë për të përkrahë njëri-tjetrin.”⁹³

Nga detyrat e myslimanëve është edhe të mos shqetësojë askënd - as me vepra, as me fjalë. Prandaj Muhammedi a.s., thotë:

“Mysliman është ai, nga dora dhe gjuha e të cilit myslimanët e tjerë janë të sigurt.”⁹⁴

Në një hadith të gjatë ku urdhëron virtytet, Muhammedi a.s., thotë:

“Nëse nuk ke fuqi për të bërë mirësi, së paku mos bëj keq, edhe mosbërja keq është një sadaka e dhënë për veten.”⁹⁵

⁹² Buhariu dhe Muslimi.

⁹³ Buhariu dhe Muslimi.

⁹⁴ Buhariu dhe Muslimi nga Abdullah b. Omeri.

⁹⁵ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Dherr.

Gjithashtu thotë:

“Myslimani më i mirë është ai, nga dora dhe gjuha e të cilit myslimanët e tjerë janë të sigurt.”⁹⁶

Edhe me një transmetim tjetër, Resulallahu pyeti:

- **Kush është mysliman, a e dini?** As’habët thanë:

- *Allahu dhe Resuli i Tij e dinë.* Resulallahu s.a.v.s. tha:

- **Mysliman është ai, nga dora dhe gjuha e të cilit myslimanët e tjerë janë të sigurt.** As’habët e pyetën:

- *O Resulallah! E kush është besimtar (mumin)?*

Resulallahu s.a.v.s, tha:

- **Besimtar është ai, prej të cilit jeta dhe pasuria e besimtarëve të tjerë është e sigurt.** As’habët e pyetën:

- *Kush është muhaxhir?* Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Ai që braktis dhe largohet prej të këqijave.** E një as’hab tjetër e pyeti:

- *Çka është Islami?* Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **T’ia dorëzosh zemrën Allahut, dhe myslimanët e tjerë të gjejnë lumturi nga dora dhe gjuha jote.”⁹⁷**

Muxhahidi ka thënë:

- *Banorët e xhehenemit i godet sëmundja e zgjebes. Tërë mishi u këputet nga eshtrat (prej kruarjes).* Ata pyeten:

- *A nuk jeni të shqetësuar nga kjo sëmundje?* E ata përgjigjen:

- *Po, dhe atëherë u thuhet:*

- *Ja, ky është dënimi për pengimet ndaj besimtarëve.*

Edhe Muhammedi a.s., thotë:

“E pashë një njeri si kënaqet në xhenet, për degën që e largoi nga rruga, e që i pengonte myslimanët.”⁹⁸

⁹⁶ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Musa.

⁹⁷ Tebarani dhe Hakimi nga Fudal ibn Ubejde.

⁹⁸ Muslim nga Ebu Hurejre r.a.

Ebu Hurejre r.a., tregon që i ka thënë Muhammedit a.s.:

- *O Resulallah! A më mëson një vepër të dobishme?*
Resulallahu s.a.v.s., i tha:

-Largoj nga rruga gjërat që pengojnë myslimanët.⁹⁹

Prapë Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Ai që largon nga rruga diçka që pengon myslimanët, Allahu Teala ia shkruan një vepër të mirë. E kujt ia shkruan Allahu Teala një vepër të mirë, për hir të asaj veprë e vendos në xhenet.”¹⁰⁰

Përsëri Muhammedi a.s., thotë:

“Nuk është e lejuar për myslimanin të frikësojë myslimanin tjetër.”

Me një hadith tjetër thotë:

“Nuk është e lejuar për myslimanin të shqetësojë me shikim myslimanin tjetër.”¹⁰¹ dhe:

“Allahu Teala përbuzë pengesat e bëra besimtarëve.”¹⁰²

Rebi b. el- Hajsem ka thënë:

“Ka dy lloje njerëzish: Besimtari - atë mos e pengo, dhe i padituri (xhahil) - ndaj tij mos vepra vrazhdë.”

Nga të drejtat (detyrat) e myslimanëve është edhe modestia karshi secilit mysliman dhe mos-mburrja:

“Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se Allahu nuk i do mendjemëdhentë e mburracakët!” 31-Lukman: 18

⁹⁹ Muslimi nga Ebu Berze.

¹⁰⁰ Ahmed b. Hanbel nga Ebu ed-Derda.

¹⁰¹ Ibn Mubarek në veprën **‘Zuhud’** nga Hamza b. Ubejde.

¹⁰² Ibn Mubarek në veprën **‘Zuhud’** nga Ikrime b. Halid.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:
“Allahu Teala më njoftoi që të jeni modest. Askush të mos u lavdërohet të tjerëve.”¹⁰³

Prandaj, nëse ndokush të mburret ty, mos u shqetëso. Sepse Allahu Teala urdhëroi Muhammedin a.s.:

“Ti (Muhammed) merre të lehtë, urdhëro për mirë dhe hiq prej të padijshmëve.” 7-A’rafë: 199

Abdullah b. Ebi Evfa ka thënë:
“Resulallahu s.a.v.s., ishte modest ndaj çdokujt, shëtiste me të varfrit dhe iu ndihmonte.”

Edhe një nga detyrat e myslimanëve është që të mos dëgjojë fjalët e këqija që bartin njerëzit për njëri-tjetrin dhe mos të përcjellë atë që dëgjon prej të tjerëve. Sepse Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Ngatërrestarët, nuk hynë në xhenet.”¹⁰⁴

Halil b. Ahmed ka thënë:
“Ai që i bartë te ti fjalët e tjetrit, një ditë do t’i bartë fjalët tua te ai.”

Gjithashtu, nga të drejtat (detyrat) e myslimanëve është që të mos ndërpres lidhjen me myslimanin për më gjatë se tri ditë, kur të zemërohet me të. Në transmetimin e Ebu Ejub el-Ensarit, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Nuk është hallall për myslimanin të braktisë vëllanë mysliman për më gjatë se tri ditë, ashtu që kur takohen, njëri e kthen fytyrën në një anë e tjetri në anën tjetër. E më i miri prej tyre është ai që fillon me selam.”¹⁰⁵

¹⁰³ Ebu Davud dhe Ibn Maxhe nga Ijad b. Xhemmaz.

¹⁰⁴ Buhariu dhe Muslimi nga Huzejfe.

¹⁰⁵ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Ejub-i.

Resulallahu s.a.v.s. gjithashtu thotë:
**“Kush e fal një mysliman për dhunën që ia ka bërë,
Allahu Teala ia falë gabimet në Ditën e Gjykimit.”**¹⁰⁶

Ikrimë r.a., ka thënë:
**“Allahu Teala i tha Jusufit a.s.: “Për arsye se i fale
vëllezërit në këtë dynja dhe ahiret, Unë të lartësova famën.”**

Aisha r.anha., thotë:
**“Resulallahu s.a.v.s. kurrë nuk është hakmarrë për asnjë
të keqe të bërë ndaj tij. Por, për mos-respektimet ndaj Allahut,
është hakmarrë.”**

Ibn Abbasi r.a., ka thënë:
**“Kur njeriu falë padrejtësitë e bëra atij, Allahu ia
lartëson nderin.”**

Resulallahu s.a.v.s., me një hadith thotë:
**“Sadakaja nuk pakëson asgjë nga pasuria. Kur robi
falë, Allahu Teala ia shton nderin. Kur robi tregon modesti,
Allahu e lartëson.”**¹⁰⁷

Edhe një nga detyrat e myslimanëve: sa ka mundësi t’ju
bëjë të mira dhe ndihmë çdokujt. Alia r.a., transmeton nga
babai Husejni dhe ai nga babai Alia (Allahu Teala qoftë razi me
të tre) që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

**“Meriton tjetri apo jo, ti bëji mirë. Nëse i bën mirë atij
që meriton, e ka merituar. E nëse i bën mirë atij që nuk
meriton, ti prej tij meriton mirësi.”**¹⁰⁸

Prapë në transmetimin e Alisë, Resulallahu s.a.v.s., ka
thënë:

**“Pas besimit (imanit), detyrë kryesore e mendjes
është që të krijojë miqësi me secilin, dhe çdokujt t’i bëjë
mirë.”**¹⁰⁹

¹⁰⁶ Edu Davud dhe el-Hakim-i. Hadhithi i përmendur edhe më herët.

¹⁰⁷ Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

¹⁰⁸ Darekutni në veprën *‘El-ilade’*

Ebu Hurejre r.a., ka thënë:

“Resulallahu s.a.v.s., kur ka kapur dikë për dore, nuk e ka tërhequr, përderisa ky tjetri t’i tërhiqte dorën Resulit. Para askujt nuk i ka zgjatur këmbët. I drejtohej atij që fliste dhe nuk largohej pa e përfunduar tjetri fjalën.”

Nga detyrat e myslimanëve është edhe të mos hyjë në shtëpi të tjetrit pa marrë leje. Tri herë mund të trokasë në derë, dhe nëse as në herën e tretë nuk i lejohet hyrja, kthehet mbrapa. Ebu Hurejre r.a., na lajmëron që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Leja duhet kërkuar tri herë. Herën e parë për të tërhequr vëmendje, herën e dytë për t’u pregaditur familjarët, dhe herën e tretë për pranim ose refuzim.”¹¹⁰

Detyrë e myslimanëve është edhe që të kalojë mirë me të gjithë, dhe me secilin të veprojë sipas meritës. Të mos lavdërohet me dituri kundrejt të paditurit (xhahilit), ose me artin e të shkruarit kundrejt analfabetit. Kjo nuk është gjë tjetër pos mundim edhe ndaj tjetrit edhe ndaj vetes.

Nga detyrimet e myslimanëve është gjithashtu të tregojë respekt ndaj të moshuarve dhe dhembshuri ndaj fëmijëve. Sipas transmetimit nga Xhabiri r.a., Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Nuk është prej neve ai i cili nuk u tregon respekt të moshuarve dhe dhembshuri fëmijëve.”¹¹¹

Respektim i plotë i të moshuarve është të mos flitet para tyre pa lejen e tyre.

¹⁰⁹ Teberani në veprën *‘Evsat’*, Hattabi në *‘Tarihu’t-Talibin’* dhe Ebu Naim në *‘Hilje’*.

¹¹⁰ Darekuti në veprën *‘Ifrat’*, dhe Buhariu e Muslimi nga Ebu Musa.

¹¹¹ Teberani në *‘Evsat’*, dhe Ebu Davud e Buhariu nga Abdullah b. Omeri.

Sipas tregimit të Xhabirit r.a., një delegacion nga fisi i Xhuhajnes erdhi që të vizitojë Muhammedin a.s.. Deri sa një i ri bëhej gati që të flasë, Muhammedi a.s., i tha:

“Ti ndalu, ku është i moshuari i juaj? Ai le të flasë.”¹¹²

Dhe me një hadith tjetër:

“Ai që u tregon respekt të moshuarve, Allahu Teala e bën person që të tjerët do ta respektojnë kur ai të plakët.”¹¹³

Kjo është një myzhde për ata të cilët tregojnë respekt ndaj të moshuarve që do të jetojnë gjatë. Respekt ndaj të moshuarve Allahu Teala u përcakton vetëm atyre që do të jetojnë gjatë. E Resulallahu s.a.v.s, ka thënë:

“Nuk do të bëhet kijameti deri sa fëmija nuk e zemëron babanë, deri sa nuk pakësohet shiu, deri sa nuk shumohen njerëzit e këqinj, deri sa nuk pakësohen njerëzit e mirë, deri sa nuk humb respekti ndaj të moshuarve dhe deri sa të këqinjët nuk kundërshtojnë të mirët.”¹¹⁴

Sjellja e urtë ndaj fëmijëve është adet i mirë i Resulallahut s.a.v.s.. Kur kthehej nga udhëtimi, fëmijët e prisnin Resulallahun s.a.v.s., e ai ndalej me ta. Pastaj i lejonte edhe t’i ngjiteshin: disa në krahë, disa në shpinë, e disa u ngjiteshin as’habëve. Pastaj fëmijët lavdëroheshin duke i thënë njëri-tjetrit: *“ty vetëm në shpinë të mbajti Resulallahu s.a.v.s., e mua në krah, kurse këtë e mbajti as’habi.”*

Fëmijët i sillnin te Resulallahu s.a.v.s., për t’u dhënë emrin dhe për dua. Resulallahu s.a.v.s., i merrte fëmijët në krahë dhe nganjëherë ndodhte që fëmia të urinojë, e kur e shihnin këtë, as’habët u bërtisnin fëmijëve.

¹¹² Transmeton Hakimi dhe thotë që hadithi është sahih.

¹¹³ Tirmidhiu nga Enesi.

¹¹⁴ Muslimi nga Aisha r.a.

Por, Resulallahu s.a.v.s, u thoshte:

“Mos i pengoni të bëjnë urinën duke i frikësuar.”¹¹⁵

Dhe kështu e linte fëmijën të lirë deri sa të përfundonte, pastaj bënte dua dhe i jepte emrin. Prindi gëzohej që Resulallahu nuk shqetësohej kur fëmija urinonte. E pasi ata shkonin, Resulallahu s.a.v.s. e lante urinën.

Një ditë Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **A e dini për kë është zjarri haram?** As’habët thanë:

- *Allahu dhe Resuli i Tije dinë.* Resulallahu s.a.v.s tha:

- **Për atë që me secilin sillet butë, që është i dashur.**¹¹⁶

Në transmetimin e Ebu Hurejres r.a., Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Allahu Teala i do personat e butë, të urtë dhe fytyrë-qeshur.”¹¹⁷

Njëri nga as’habët i tha Resulallahut s.a.v.s.:

- *O i Dërguari i Allahut, më mëso një vepër që do të më vendos në xhenet.* Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **T’i japësh selam secilit dhe të flasësh mirë është shkak i faljes.**¹¹⁸

Abdullah ibn Omeri r.a., ka thënë:

“Mirësia është e lehtë: fytyrë-qeshur dhe fjalë të mira.”

¹¹⁵ Harati në *‘Mekarim-i Ahlak’* nga Aisha r.a. dhe Teberani nga Ibn Mesud.

¹¹⁶ Tirmidhiu nga Ibn Mesudi r.a..

¹¹⁷ Bejhaki në veprën *‘Shuabu’l- Iman’*.

¹¹⁸ Ibn Ebi Shejbe në veprën *‘Musannef’*, Taberani dhe Harati në *‘Mekarim-i Ahlak’* dhe Bejhaki në *‘Shuabu’l- Iman’* nga Hani b. Jezid.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Mbrojeni veten nga xhehenemi qoftë edhe me gjysmë hurme. Nëse as këtë nuk e gjeni, mbrojeni veten me fjalë të ëmbla.”¹¹⁹

Në një hadith tjetër, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Vërtet në xhenet ekzistojnë dhoma që nga brenda shihet e jashtë dhe nga jashtë shihet e brendshme.” Kur e dëgjoi këtë një beduin e pyeti:

- *O Resulallah, të kujt janë ato dhoma?* Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Janë për ata që flasin mirë, ushqejnë të tjerët dhe falen natën, kur të tjerët janë në gjumë.**¹²⁰

Muadh b. Xhebal r.a., tregon që Resulallahu s.a.v.s., i tha:

“O Muadh! Të këshilloj të frikësohesh prej Allahut, të flasësh të vërtetën, të mbash premtimet, të meritosh besimin, të mos tradhëtosh, të mbrosh komshin, të tregosh mëshirë ndaj jetimit, të flasësh butë, t’i japësh selam çdokujt dhe të jesh modest.”¹²¹

Sipas transmetimit të Enesit r.a., një ditë, deri sa Pejgamberi ishte në mesin e disa as’habëve, erdhi një grua dhe tha:

- *O Resulallah! Dua të bisedoj me ju për disa çështje.* Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Ulu ku të duash; unë aty të dëgjoj.** Dhe duke u ulur edhe ai në një vend përshtatshëm dëshirës së gruas, e dëgjoi shqetësimin e saj dhe ia plotësoi kërkesën.¹²²

¹¹⁹ Buhariu dhe Muslimi nga Adij b. Hatemi.

¹²⁰ Tirmidhiu nga Alia r.a.

¹²¹ Harati në veprën *‘Mekarim-i Ahlak’*, Bejhaki në *‘Zuhd’* dhe Ebu Naim në *‘Hilje’*.

¹²² Shenon Muslimi.

Vehb b. Munebbih tregon:

“Një person nga Beni Israilët agjëroi për shtatëdhjetë vite duke ngrënë iftar vetëm njëherë në javë. Ky abid i lutej Allahut Teala që t’i tregojë se si shejtanët i devijojnë njerëzit. Kur kaloi një kohë e gjatë dhe lutja nuk iu pranua, u mendua dhe tha me vete:

‘Si duket, më e dobishme do të ishte të kërkoja të mësoj gabimet e mia të bëra karshi Allahut.’ Atëherë, Allahu Teala ia dërgoi një melek dhe meleku i tha:

*‘Allahu Teala të thotë: **‘Këtë që tani e the është më e dashur për Mua se sa tërë ibadetet e tua.’** Megjithatë, Allahu Teala ka ngritur perden nga syri yt, dhe të thotë: **‘Çile syrin dhe shiko si shejtanët i devijojnë njerëzit.’***

Duke parë se si shejtanët kanë pushtuar sipërfaqen e tokës sikur mizat kur e sulmojnë njeriun, tha:

- ‘Allahu im! Kush mund të shpëtojë nga sherri i tyre?!’ Allahu Teala tha:

*- **‘Ata që largohen nga gjërat e dyshimta, që sillen butë dhe janë modestë, ata shpëtojnë nga sherri i tyre.’***

Një nga detyrat e myslimanit është edhe të mbajë fjalën e dhënë. Resulallahu s.a.v.s., me një hadith thotë:

“Premtimi është dhuratë.”¹²³

dhe me një hadith tjetër:

“Premtimi është borxh.”¹²⁴

Dhe me një hadith tjetër:

“Tri gjëra gjenden te hipokriti: kur flet - gënjen, kur premtion - nuk e mbanë premtimin, kur i besohet - tradhëton.”¹²⁵

¹²³ Teberani në *‘Evsat’* nga Kabas b. Ushejme.

¹²⁴ Teberani në *‘Evsat’* dhe në *‘Esgar’* nga Alia r.a., dhe Ibn Mes’udi

r.a..

¹²⁵ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

Prapë Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Te kush gjenden këto tri cilësi (pra, gënjeshtria, mosmbajtja e premtimit dhe tradhëtia), edhe po të agjërojë dhe të falë namazin, prapë është hipokrit.”¹²⁶

Detyrë e myslimanit është gjithashtu që të sillet mëshirshëm dhe me drejtësi ndaj secilit, dhe atë që dëshiron për vete t’ua dëshirojë edhe të tjerëve. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Nuk kompletohet imani (besimi) pa poseduar këto tri veti: dhënie në varfëri, mëshirë, dhe dhënie selam çdokujt.”¹²⁷

Prapë Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Ai që dëshiron të largohet nga xhehenemi dhe të hyjë në xhenet, duke shqiptuar shahadetin: “Esh-hedu en la ilahe illallah ve esh-hedu enne Muhammeden abdu-hu ve resuluhu.” (Dëshmoj që nuk ka ilah tjetër përveç Allahut dhe dëshmoj që Muhammedi (s.a.v.s.) është rob dhe i dërguar i Allahut), le të mbyllë sytë në këtë jetë dhe atë që ia dëshiron vetes le t’ia dëshirojë edhe tjetrit.”¹²⁸

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“O Ebu Derda! Sillu mirë me komshiun, do të bëhesh mu’min, dhe dua edhe për të tjerët atë që do për vete - do të bëhesh mysliman.”¹²⁹

¹²⁶ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a. Por, te Buhariu nuk është pjesa për agjërim dhe falje të namazit.

¹²⁷ Harati në *‘Mekarim-i Ahlak’* nga Ammar b. Jasir.

¹²⁸ Muslimi nga Abdullah b. Amr b. el-As dhe Harati në *‘Mekarim-i Ahlak’*.

¹²⁹ Harati në *‘Mekarim-i Ahlak’* mirënjohur është transmetimi i Ebu Hurejres r.a.

Hasani Basriu tregon:

“Allahu Teala urdhëroi Ademin a.s. të jetë posedues i katër vetive dhe ka bërë të njohur që të gjitha cilësitë e mira janë në këto katër veti. Allahu Teala i tha Ademit a.s.: Nga këto katër veti - njëra është për Mua, tjetra për ty, e treta mes Meje dhe teje dhe e katërta mes teje dhe njerëzve:

E para: të më adhurosh vetëm Mua, askënd tjetër.

E dyta: do të të shpërblej për veprat që do të bësh, në ditën më të vështirë.

E treta: ti me bëj dua (lutje) e Unë e pranoj lutjen tënde.

E katërta: siç dëshiron që njerëzit të jenë miq me ty, edhe ti njejtë sillu ndaj tyre.”

Musa a.s., e pyeti Allahun Teala:

- *O Rabbi im! Cili rob i Yti është më i drejtë?* Allahu Teala i tha:

- ***Ai i cili është më i mëshirshëm.***

Edhe një nga detyrat e myslimanit është që çdokujt t'i tregojë respekt dhe të respektojë atë pozitë që meriton. Transmetohet se Aisha r.a., kur ishte duke pushuar gjatë një udhëtimiti, i erdh një lypës në derë të çadrës. Aisha r.a., tha:

- *Jepini një kafshatë bukë.* Pas pak erdhi një njeri në kalë, që ishte i uritur. Aisha r.a., tha:

- *Ftojeni në çadrën e kuzhinës dhe ushqejeni.* Në këtë, Aishes r.a. i thanë:

- *Të dytë janë robë të Allahut; njërin e përcolle me një copë bukë, e tjetrin e ftove në ushqim. A është kjo barazi?* Aisha r.a., tha:

- *Allahu Teala secilës krijesë njeri i ka dhuruar pozitë, veç e veç. Detyrë e jona është t'i tregojmë respekt pozitës së çdokujt. Qëllimi kryesor është që t'a gëzojmë vizitorin. Lypësi bëhet i kënaqur me një kafshatë bukë, por të sillesh me një udhëtar që ndjen uri njëjtë si me një lypës për udhëtarin është vuajtje (mundim).*

Transmetohet se Muhammedi a.s., hyri në një dhomë. Erdhën edhe as'habët dhe hynë aty, e dhoma u mbush plot. Pikërisht në atë kohë erdhi edhe Abdullah el-Bexheli. Pasi që nuk pati vend, u ul në prag të derës. Kur e pa këtë Muhammedi a.s., e hoqi shallin e vet nga koka, e paloi, dhe duke ia hedhur Abdullahut, i tha:

- **Merre ulu mbi këtë.** Abdullahu e mori shallin, e vendosi në fytyrë, e puthi, nisi të qajë dhe tha:

- *E si mund të ulem mbi këtë shall!* E paloi dhe ia ktheu Muhammedit s.a., duke thënë:

- *Si më nderove ti mua, edhe Allahu Teala të nderoftë ty.* Muhammedi a.s., duke shikuar në të majtë dhe në të djathtë, tha:

- **Kur t'ju viziton ndonjë pjesëtar i një fisi tjetër, nderojeni.**¹³⁰

Njëjtë duhet nderuar edhe miqtë e vjetër.

Sipas transmetimit, një ditë erdhi nëna e gjirit e Muhammedit a.s.. Muhammedi a.s. e shtroi shallin e vet dhe tha:

- **Mirë se erdhe nënë, urdhëro ulu.** E pyeti për gjendje dhe shëndet, dhe tha:

- **Nëse ke ndonjë kërkesë - trego.** Ajo tha:

- Erdha të kërkoj nga ti robë të luftës nga lufta e Havazit akrabat (bijtë e Sa'dit). Në këtë, Muhammedi a.s., tha:

- **Do t'i liroj ata që janë në pronën time dhe të Hashimive** (bijve të Hashimit). Kur dëgjuan këtë, as'habët, thanë:

- Edhe ne do t'i lirojmë ata që janë në duart tona. Përveç kësaj, Muhammedi a.s., i dhuroi nënës së gjirit edhe të mira materiale nga hisja e vet, dhe duke e bërë të lumtur, e përcolli. Pastaj hazreti Osmani r.a., gjatë hilafetit të vet i bleu këto gjëra për njëqindmijë dërhëm.¹³¹

¹³⁰ Hakimi nga Xhabiri.

¹³¹ Transmetojnë Ebu Davudi dhe Hakimi.

Çdoherë kur vinte dikush në mexhlisin e Muhammedit a.s., dhe nuk gjente vend për t'u ulur në shilte, Muhammedi a.s., menjëherë ia shtronte shilten e vet. Nëse personi nuk pranonte, Resulallahu s.a.v.s. insistonte deri sa ky të pranonte.

Detyrë tjetër e myslimanit është të ndërmjetësojë dhe pajtojë myslimanët mes vete, sa të ketë mundësi. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

- A dëshironi t'ju tregoj një gradë më të vlefshme se falja e namazit, agjërimi dhe sadakaja? As'habi Kiram-ët thanë:

- *Tregona, O Resulallah,* e Resulallahu s.a.v.s., tha:

- Të pajtohen dy vetë (ndërmjetësimi për pajtim). **Sepse grindja e shkatërron fenë në rrënjë.**¹³²

Edhe me një hadith:

"Sadakaja më e vlefshme është të pajtohen dy vetë (ndërmjetësimi për pajtim)."¹³³

Enesi r.a., ka thënë:

"Një ditë Resulallahu s.a.v.s., ishte mes nesh dhe ashtu buzëqeshi që iu panë dhëmbët. Hazreti Omeri r.a., tha:

- *O Resulallah, ti që je për mua më i dashur se nëna dhe babai, çka ishte kjo buzëqeshje?* Resulallahu s.a.v.s., tha:

- Dy vetë nga umeti im dolën në prani të Allahut Teala. Njëri tha:

- *O Rabbi im! Merr nga ky person të drejtën time dhe ma jep mua.* Allahu Teala i tha këtij tjetrit:

- Jepi atij të drejtën, e personi tha:

- *O Rabbi im! Nuk më mbeti asnjë mirësi, çka të jap?* Duke iu drejtuar personit që kërkoi të drejtën, Allahu Teala tha:

¹³² Ebu Davud dhe Tirmidhiu nga Ebu Derda r.a.

¹³³ Taberani në veprën **'Kebir'** nga Abdullah b. Amr.

- **Çfarë do të bësh? Këtij nuk i ka mbetur asnjë mirësi.**
 Në këtë, personi i parë tha:
 - *Së paku le të m'i merr gjynahet.* Pastaj Resulallahu s.a.v.s., i shkuan lotët, e tha:
 - **Vërtet ajo ditë është dita e madhe në të cilën njerëzit kërkojnë dikë që t'ia heqë gjynahet dhe vazhdoi:**
 - **Allahu i thotë të parit: Ngrite kokën dhe shiko pallatin tënd të mahnitshëm në xhenet.** Personi thotë:
 - **O Rabbi im! Po shoh në xhenet qytete nga argjenti dhe pallate nga dukati të përpunuar me brilantë. Cilëve Pejgamberë, dëshmorë, ose të sinqertë ju takojnë këto?**
 Allahu Teala tha:
 - **U takojnë atyre që paguajnë vlerën e tyre.** Personi tha:
 - **O Rabbi im! Kush mund të paguaj vlerën e tyre?**
 Allahu Teala thotë:
 - **Ti mundesh.** Personi thotë:
 - **O Rabbi im! Çka kam unë që të mund të paguaj?**
 Allahu Teala i thotë:
 - **Duke ia falë të drejtën tënde këtij vëllai, mund të posedosh këto.** Person thotë:
 - **O Rabbi im! Ia fala.** Allahu Teala i thotë:
 - **Merre vëllanë për dore dhe hyni bashkë në xhenet.**
 Dhe duke vazhduar, Resulallahu s.a.v.s., tha:
Ken i frikë Allahun dhe mundohuni të pajtoni njerëzit mes vete. Sepse edhe Allahu Teala në ditën e kiametit i pajton besimtarët.”¹³⁴

Me një hadith tjetër Resulallahu s.a.v.s., thotë:
“Fjala e hairit për të pajtuar dy vetë nuk është gënjeshtër.”¹³⁵

¹³⁴ Harati në veprën *'Mekarim-i Ahlak'*. Hakimi nga Ebu Ja'la el-Musili.

¹³⁵ Burahiu dhe Muslimi nga Ummu Gulsum bint Akabe b. Ebi Muaje.

Ky hadith shpjegon detyrimin e pajtimit. Braktisja e gënjeshtres është vaxhib (detyrim), por një detyrim anulohet me një detyrim më të vlefshëm.

Resulallahu s.a.v.s, thotë:

“Të gjitha gënjeshttrat shënohen, vetëm gënjeshttra në luftë (propaganda) nuk shënohet sepse lufta është një taktikë; nuk shënohen as gënjeshttra me qëllim që të pajtohen dy vetë, e as gënjeshttra për të bërë gruan të lumtur.”¹³⁶

Detyrë e myslimanit është edhe të fshehen mangësitë e vëllait mysliman. Me një hadith, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Atij që i fshehë mangësitë e myslimanit, Allahu Teala ia fshehë mangësitë në dynja dhe ahiret.”¹³⁷

Dhe me një hadith tjetër:

“Atij që i fshehë mangësitë e dikujt, Allahu Teala ia fsheh mangësitë në Kiamet.”¹³⁸

Në transmetimin e Ebu Said el-Hudrit r.a., Resulallahu s.a.v.s., kështu thotë:

“Nëse një mu’min (besimtar) e sheh një mangësi të vëllait i vet dhe e fshehë, hyn në xhenet.”¹³⁹

Muadhi r.a., i tregoi Resulallahut s.a.v.s. një përjetim të tij, e Resulallahu s.a.v.s., i tha:

“Do të ishte më mirë për ty nëse do ta kishe mbuluar me veshjen tënde dhe ta fshihje.”¹⁴⁰

¹³⁶ Harati në *‘Mekarim-i Ahlak’* nga Nevvas b. Sem’ani dhe Muslimi nga Ummu Gulsun bint Ukbe.

¹³⁷ Muslimi nga Ebu Hurejrer.a., dhe Buhariu e Muslimi nga Ibn Omeri r.a..

¹³⁸ Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

¹³⁹ Taberani në *‘Evsat’* dhe *‘Sagir’* dhe Harati në *‘Mekarim-i Ahlak’* nga Ebu Said el-Hudri.r.a.

Kjo na tregon se njeriu, siç duhet të fshehë mangësitë e të tjerëve, duhet të fshehë edhe mangësitë e veta. Ebu Bekri r.a., ka thënë:

“Po të takoja rastësisht dikë duke pirë alkool, do të dëshiroja që Allahu Teala ta fshehë atë prej meje. Po të takoja rastësisht vjedhësin, përsëri do të dëshiroja që Allahu Teala ta fshehë atë prej meje.”

Hazreti Omeri r.a., gjatë hilafetit të tij, kohë pas kohe e kontrollonte qytetin (Medine) natën. Një natë i zuri dy vetë në ziná. Të nesërmen iu drejtua popullit:

- *Nëse imami (pra, ai vetë) sheh një mashkull dhe një femër duke bërë zina dhe mbështetur në këtë zbaton mbi ta dënimin për ziná (hadd-i ziná), çfarë do të thoshit për këtë? Të pranishmit thanë:*

- *Ti je Imami dhe Halife i jonë! Nëse i ke parë me sytë tu, ke kompetenca për t'a zbatuar (hadd-i ziná). Hazreti Alia r.a., tha:*

- *Jo, ti nuk ke kompetencë për këtë. Nëse bën diçka të tillë, do të dënohesh. Sepse Allahu Teala kërkon katër dëshmitarë në këtë çështje. Omeri r.a., priti një kohë, pastaj përsëriti pyetjen e njëjtë dhe Alia r.a., njëjtë kundërshtoi. Dëshira e Omerit r.a., ishte të mësojë a ka apo nuk ka kompetencë për zbatimin e dënimit, e jo për të njoftuar njerëzit për atë ziná. Ai vetë ishte në dilemë. Më pas përvetësoi mendimin e Alisë r.a..*

Kjo është dëshmia më e fuqishme që përshtatje në shariat është të mbulohet marrëdhënia e ndaluar. E më e keqja e e marrëdhënies së ndaluar është zinája. Por për ziná është caktuar kushti i dëshmisë së katër personave të drejtë - kushti është të shihet vepra sikur kur sheh briskun të hyjë në këllëf. Vetëm kështu mund të zbatohet dënimi (hadd) për

¹⁴⁰ Ebu Davud dhe Nesai nga Naim b. Hizali. Edhe Hakimi transmeton nga Hizali dhe thotë që është 'sahih'.

ziná. Nuk mjafton të dijë vetëm gjykatësi. Shih këtë urtësi; marrëdhënies së ndaluar iu dha dënimi më i madh - vrasja me gurë (rexhm), kurse zinásë iu mbyll rruga, pastaj shiko si Allahu Teala mbi robët e Tij problematik vendosi mbulesën, si e ngushtoi rrugën për të mos dalë në shesh gjynahi. Duke u ruajtur nga zbulimi, ne dëshirojmë dhe shpresojmë që edhe në ditën e kiametit Allahu Teala na ruan nga dalja në shesh e të gjitha veprave tona të fshehta. Sepse në hadith është thënë:

“Nëse Allahu Teala e fsheh turpin e robit të Tij në dynja (në këtë botë), atë e fshehë edhe në ahiret. Por edhe nëse e zbulon në dynja, prap në ahiret nuk e zbulon.”

Abdurrahman b. Avf r.a., tregon:

- Një natë me Omerin (r.a.) dolëm për kontrollë. Duke ecë, pamë dritë në një shtëpi, u afruam, dera ishte e mbyllur dhe nga shtëpia vinte zhurmë. Omeri më kapi për dore dhe më tha:

- *A e di se e kujt është shtëpia?*

- *Nuk e di, i thashë. Omeri tha:*

- *Kjo është shtëpia e Rebi b. Umejje b. Half-it. Këta janë duke pirë alkool. Çka mendon ti, si të veprojmë me ta?*

- *Unë mendoj se jemi duke bërë atë që Allahu Teala na ka ndaluar, duke thënë: “Mos hulumtoni për zbulimin e mangësisë së njëri-tjetrit!” (49-Huxhurat: 12)*

Omeri menjëherë u tërhoq, dhe u larguam prej aty.

Kjo dhe ndodhitë e ngjashme, na shpjegojnë që na është e ndaluar të zbulojmë mangësitë dhe që duhet fshehur ato. Ngase edhe Muhammedi a.s., i tha Muavisë r.a.:

“Nëse ti hulumton mangësitë dhe gjendjet e fshehta të njerëzve, i bën ata të grinden dhe bëhesh shkaktar i dëmtimit të tyre.”¹⁴¹

¹⁴¹ Ebu Davud nga Muavije r.a.

Muhammedi a.s., thotë:

“O ju që besoni vetëm me gjuhë, të cilëve ende nuk u ka hyrë besimi (imani) në zemër! Mos kritikoni pas shpine, mos hulumtoni gjendjet e fshehta të njerëzve! Sepse ai që hulumton gjendjet e fshehta të të tjerëve, Allahu Teala ia zbulon gjendjet e tij të fshehta, edhe nëse ato fshehtësi gjinden brenda në shtëpinë e vet, dhe duke i nxjerrë ato në shesh - e poshtëron.”¹⁴²

Hazreti Ebu Bekri r.a., ka thënë:

“Nëse vetëm unë do të shihja dikë duke bërë një krim (vepër kundër urdhërave të Allahut Teala, e cila dënohet), nuk do ta kisha dënuar as nuk do të thërrisja tjetrin për të parë krimin (veprën e tij.)”

Një person ka treguar:

“Isha ulur me Abdullah Mesudin, hyri brenda një person duke sjellë një person tjetër me vete dhe tha që është i dehur. Abdullah Mesudi urdhëroi t’i merret erë gojës, u kuptua që është i dehur dhe e arrestoi deri sa t’i kalojë dehja. Pastaj urdhëroi të rrihet me kamxhik dhe i tha ekzekutuesit:

- *Godite këtë person për dënimin e alkoolit. Dënimi u ekzekutua duke qënë personi veshur me gunë. Pastaj e pyeti personin që e solli të dehurin:*

- *Çfarë lidhje ke me të? Personi tha:*

- *Jam xhaxhai i tij. Duke e qortuar, Abdullahu i tha:*

- *Si nuk e respektove edebin, dhe nuk ia fshehe të metën! Dhe në vazhdim tha:*

- *Detyrë e imamit është të zbatojë dënimin i cili vërtetohet, por Allahu falë, dhe i do ata që falin, dhe lexoi ajetin:*

“...po le t’ua falin (gabimin) dhe mos t’ua zënë për të madhe...” 24-en-Nur: 22

¹⁴² Ebu Davud nga Ebu Burde dhe Tirmidhiu nga Ibn Omeri r.a.

Pastaj tha:

- *Më kujtohet kur për herë të parë u pre dora e vjedhësit, Resulallahut s.a.v.s. i erdhi keq. Ata që ishin prezentë aty (as'habët) thanë:*

- *Si duket jeni brengosur nga kjo ngjarje. Resulallahu s.a.v.s., tha:*

- *Si të mos brengosem, mos u bëni ndihmës të shejtanit kundër vëllezërve myslimanë! As'habët thanë:*

- *Atëherë t'a kishe falë. Resulallahu s.a.v.s., tha:*

- *Imamit (Kryetarit të umetit) i takon që të zbatojë dënimin për krimin që vërtetohet. Por Allahu Teala falë dhe e do faljen. Pastaj e lexoi ajetin:*

"...po le t'ua falin (gabimin) dhe mos t'ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që Allahu t'ju falë ju? Allahu falë dhe mëshiron shumë." 24-en-Nur: 22

Me një transmetim tjetër për prerjen e parë të dorës, Resulallahu s.a.v.s., aq shumë ishte mërzitur sa që ishte zbehur.

Përsëri, sipas një transmetimi, hazreti Omeri r.a., një mbrëmje kishte dalë për kontrollë në Medinë. Nga një shtëpi dëgjoi një zë mashkulli duke kënduar. U afrua në dritare, pa një femër dhe një shishe të alkoolit pranë një mashkulli dhe bërtiti:

- *O kundërshtar i urdhrave të Allahut! A mendon që Allahu Teala do ta fshehë këtë kundërshtim?! Personi tha:*

- *O Emiri i mu'minve (besimtarëve)! Ndal, mos u ngut! Nëse unë kam bërë një kundërshtim ndaj urdhrave, ti i bërë tri. E para:*

"Mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njërit-tjetrit..." (49:12), e ti po hulumton. E dyta, Allahu Teala thotë:

"Nuk është mirësi të hyni nga mbrapa në shtëpitë..." (2:189), e ti nuk hyre nga dera por po shikon nga dritarja. Dhe e treta:

"O besimtarë! Mos hyni në shtëpitë e huaja pa marrë leje." (24:27), e ti as nuk dhe selam, as nuk kërkove leje.

Në këtë, Omeri r.a., e pyeti:

- Nëse të fali, a do të ketë ndonjë hair prej teje? Personi tha:

- Nëse më falë, unë nuk do ta përsëris këtë vepër. Pastaj Omeri r.a., u largua nga aty.

Një person i tha Abdullah b. Omerit r.a.:

- O babai i Abdurrahmanit! Na trego çfarë ke dëgjuar, çka ka thënë Resulallahu s.a.v.s., rreth llogarisë së fshehtë të robit? Abdullahu tha:

- Kam dëgjuar Resulallahun s.a.v.s., duke thënë:

- Allahu Teala i afrohet robit besimtar me rahmetin e Tij dhe duke e mbuluar me rahmetin e Tij i thotë:

- “O robi Im! A po të kujtohen këto gjynahe?” Robi thotë: “Po”, dhe duke e treguar të vërtetën për të gjitha gjynahet, e kupton që është shkatërruar. Në këtë, Allahu Teala thotë:

- “O robi Im! Arsyeja pse i kam mbuluar këto gjynahe në dynja është që të të fal ty sot.” Dhe do t’i jepet libri i të mirave. Sa u përket qafirëve dhe hipokritëve, për ta thuhet:

“Këta janë ata që kanë gënjyer kundër Rabb-it të tyre. Mallkimi i Allahut qoftë mbi të padrejtët.”¹⁴³ 11- Hud: 18

Prapë me një hadith, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Të gjithë nga ummeti im falen, përpos atyre që bëjnë gjynahe haptas. Gjynahe të bëra haptas llogariten edhe gjynahet që janë bërë fshehtas, e më pas ato bëhen të ditura.”¹⁴⁴

dhe:

“Ai që dëgjon fshehtas dikë që nuk dëshiron të dëgjohet, në ditën e kiametit në vesh i derdhet plumb.”¹⁴⁵

¹⁴³ Buhariu dhe Muslimi.

¹⁴⁴ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

¹⁴⁵ Buhariu nga Ibn Abbasi r.a.

Nga detyrat e myslimanit është edhe që të largohet nga vendet e dyshimta për të shpëtuar myslimanët e tjerë nga mendimet e këqija dhe kritikën. Sepse ai bëhet shkaktar për thashethëme dhe kryengritje ndaj Allahut Teala. Allahu Teala urdhëron:

“Mos i shani idhujt që ata i adhurojnë në vend të Allahut, në mënyrë që ata të mos e shajnë Allahun armiqësisht nga padija.” 6-En’am: 108.

Resulallahu s.a.v.s., pyeti:

- Çfarë mendoni për atë që i shajnë prindërit e vet?

As’habët u përgjigjën:

- *Vallë, a ka të tillë që i shajnë prindërit e vet?!”*

Resulallahu s.a.v.s. tha:

- Ka. I shanë prindërit dikujt, pastaj ai dikushi ia shanë këtij prindërit.”¹⁴⁶

Enes ibn Malik r.a. tregon: *“Resulallahu s.a.v.s. po fliste me njëren nga gratë e tij, dhe një njeri u kaloi pranë. Resulallahu s.a.v.s. e thirri dhe i tha:*

- O Filan, kjo është gruaja ime, Safija.

Atëherë, njeriu tha:

- O Resulallah, edhe po të mendoja keq për dikë, për ty nuk do të mendoja.

Muhammedi s.a.v.s. iu përgjigj:

- Vërtet shejtani qarkullon në pasardhësit e Ademit ashtu siç qarkullon gjaku në trupin e njeriut!¹⁴⁷

Në një transmetim tjetër Safija bint Hujejj ibn Ahtab ka treguar: *“Shkova te Resulallahu s.a.v.s. që ishte në itikaf në xhami, dhe i fola. Para iftarit u largova dhe ai u nis pas meje. Pranë tij kaluan dy ensarë të ri, i quan selam dhe vazhduan tutje, e ai i thirri dhe u tha:*

¹⁴⁶ Buhariu dhe Muslimi nga Abdullah ibn Omeri.

¹⁴⁷ Shënon Muslimi.

- **Kjo është Safijja bint Hujejj!**
- Ata u përgjigjën:
- O Resulallah! Ne për ty mendojmë vetëm të mirën! E ai u tha:
- **U frikësova që edhe në ju të mos fus dyshim.**¹⁴⁸

Hazreti Omeri r.a., ka thënë: *‘Kush bjen viktimë e thashethëmeve, le të fajësojë veten’.*

Hazreti Omeri r.a., po kalonte pranë një njeriu, i cili në mes të rrugës po fliste me një grua. Hazreti Omeri e ngriti shkopin të godasë, e njeriu tha:

- *Kjo është gruaja ime.* Omeri r.a., iu përgjigj:
- *Le të jetë, por largohu nga rruga që njerëzit të mos të të shohin.*

Detyrë e myslimanit është edhe që të ndërmjetësojë te dikush që ka mundësi të plotësojë nevojën e ndonjë myslimani, e edhe vet të mundohet që ta plotësojë atë nevojë, aq sa ka mundësi.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

Do të vijmë, do të lutem dhe do të kërkojmë nga unë për nevojat e tyre, edhe ju ndihmoni të tjerët që të shpërbleheni. E Allahu, përmes Resulit të Tij do të japë atë që Ai do.¹⁴⁹

Muaviu r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Kërkoni nga unë, do të shpërbleheni. Unë dua diçka, por këtë e zgjas, që ju të kërkoni dhe të jeni të shpërblyer.”¹⁵⁰

¹⁴⁸ Buhariu dhe Muslimi.

¹⁴⁹ Buhariu dhe Muslimi (*muttefekun alejhi*), nga hazreti Ebu Musa.

¹⁵⁰ Ebu Davudi, Nesai dhe ibn Asakir, nga Hemmama ibn Munebbiha, i cili e përcjellë nga Muaviu. Hadithi ka një zinxhir të besueshëm të transmetuesve (sahih).

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

- **Nuk ka sadaka më të vlefshme se sadakaja e gjuhës.**

Dikush pyeti:

- *E si?* e Resulallahu s.a.v.s. u përgjigj:

- **Përmes sadakasë së gjuhës ndalohet derdhja e gjakut, sigurohen dobitë dhe largohet dëmi.**¹⁵¹

Ikrimë r.a., tregon:

Burri i Burejres, Mugisi, ishte skllav i zi. Kur Aisha r.a., e bleu Burejren, e liroi nga skllavëria, dhe i dha lirinë. Ibn Abbasi tha:

- *Më duket sikur po e shoh tash Mugisin duke qarë pas Burejres. Atëherë Resulallahu s.a.v.s., i tha Ibn Abbasit:*

- **A nuk të habitë fuqia e dashurisë së Mugisit për Burejren, dhe urrejtja e Burejres ndaj Mugisit?,**

dhe pastaj iu drejtua Burejres:

- **Përsërit kurorën me Mugisin, është babai i fëmijës tënd.**

Burejre pyeti:

- *O i Dërguari i Allahut, a po më urdhëron që t'i kthehem?,* e Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Jo, vetëm po të këshilloj.**¹⁵²

Detyrë e myslimanit është edhe që secilit mysliman, para bisedës t'i japë selam, dhe t'i shtrëngojë dorën. Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

Kush fillon bisedën para dhënies së selamit, mos iu përgjigjini deri sa të japë selamin.¹⁵³

¹⁵¹ Haraiti në veprën '*Mekarim-i Ahlak*' dhe Taberani në veprën '*Kebir*', përcjellë nga Semur ibn Xhundub.

¹⁵² Buhariu.

¹⁵³ Taberani, në veprën '*Evsat*', dhe Ebu Nuajm në veprën '*El-jevum vel-lejla*,' versioni i të cilës edhe është përmendur këtu.

Kilde ibn Hanbel tregon: “*Shkova te Muhammedi s.a.v.s. dhe nuk i dhashë selam as nuk kërkova leje për të hyrë. Atëherë Resulallahu s.a.v.s., më tha:*

Kthehu dhe thuaj: ‘Esselamu alejkum’, e pastaj hyr brenda’.¹⁵⁴

Xhabiri r.a. tregon që Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

Kur hyni në ndonjë shtëpi, jepni selam banorëve të shtëpisë, sepse kur dikush prej jush të jep selam, shejtani nuk hyn në atë shtëpi.¹⁵⁵

Enesi r.a. tregon: “*Kam bërë hizmet për tetë vjet te Pejgamberi a.s., e më tha:*

O Enes, merr abdes si duhet, do të zgjatet jeta. Jepi selam atij që e takon nga ummeti im, do të shtohen veprat e mira. E kur të hysh në shtëpinë tënde, jepu selam familjarëve tu, do të shtohet bereqeti i shtëpisë tënde.¹⁵⁶

Enesi r.a. tregon që Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

Kur takohen dy besimtarë (mu’min) dhe i shtrëngojnë dorën (musafaha) njëri-tjetrit, mes tyre shpërndahen shtatëdhjetë falje për gjynahet, gjashtëdhjetë e nëntë për atë i cili është fytyrë qeshur dhe një për tjetrin.¹⁵⁷

¹⁵⁴ Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, i cili e vlerëson si transmetim me zinxhir të mirë të transmetuesve (hasen), duke e përcjellë nga Kelda ibn Hanbel.

¹⁵⁵ Haraiti në veprën ‘*Mekarim-i Ahlak*’.

¹⁵⁶ Haraiti në veprën ‘*Mekariim-i Ahlak*’, dhe Bejhekiu në veprën ‘*Shuabu-l Iman*’. E shënon edhe Tirmidhiu, dhe e vlerëson si transmetim të besueshëm (*sahih*), në këtë version: *Kur hyn te familjarët tu dhe iu jep selam, do të fitosh bereqet, e edhe familjarët e tu do të fitojnë.*

¹⁵⁷ Teberani në veprën ‘*Evsat*’ nga Ebu Hurejre r.a.

Allahu Teala thotë:
Kur ju përshëndet dikush me respekt, kthejani me një përshëndetje më të mirë ose në të njejtën mënyrë!

4-Nisa: 86

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

- Pasha Atë, në Dorën e të Cilit është shpirti im, nuk do të hyni në xhennet deri sa nuk jeni besimtarë (mu'min). E nuk do të jeni besimtarë deri sa të mos duheni mes vete. A dëshironi të ju udhëzoj në veprën, përmes së cilës – nëse e praktikoni – do të duheni mes vete? As'habët thanë:

- *Duam!*, e Resulallahu s.a.v.s. tha:

- Jepni selam njëri-tjetrit.¹⁵⁸

Gjithashtu, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kur myslimani i jep selam myslimanit e ky ia kthen, melaqet këtij i japin shtatëdhjetë selame.”¹⁵⁹

E me një hadith tjetër:

“Vërtetë melaqet habiten me myslimanin i cili kalon pranë myslimanit tjetër, e nuk i jep selam.”¹⁶⁰

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

Kalorësi i jep selam këmbësorit, e kur një person prej grupit jep selamin, përgjegjësia hiqet nga të tjerët.¹⁶¹

Katade ka thënë:

“Përrulja ka qenë përshëndetje e atyre që ishin para jush, e më pas Allahu Teala këtij ummeti i dha selamin ‘Es-Selamu alejkum ve Rahmetu’llah’. Kjo është përshëndetje e banorëve të xhennetit.”

¹⁵⁸ Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

¹⁵⁹ Shënon autori i veprës ‘*Firdevs*’ (Dejlemi), nga Ebu Hurejre r.a.

¹⁶⁰ Burimi nuk është gjetur.

¹⁶¹ Shënojnë imam Maliku në veprën e tij ‘*Muvatta*’, (mursel), dhe Ebu Davudi, i cili e përcjellë nga hazreti Alia r.a., në këtë version: *“Hiqet përgjegjësia nga grupi në kalim, nëse njëri prej tyre jep selam. Dhe hiqet përgjegjësia nga grupi që është ulur, nëse njëri prej tyre jep selam.”*

Ebu Idris el-Havlani po kalonte pranë një grupi njerëzish dhe nuk u dha selam. Kur u pyet pse nuk u dha selam, pat thënë: “Nuk u dhashë selam sepse u frikësova që nuk do të përgjigjen, e për këtë melaqet do t’i mallkonin.”

Gjithashtu është sunnet të shtrëngohet dora (*musafaha*) kur jepet selami. Një njeri erdhi te Resulallahu s.a.v.s., dhe i tha: “*Es-selamu alejkum!*” Resulallahu s.a.v.s.pasi që pranoi selamin, i tha:

- **Ty të takojnë dhjetë sevape.** Erdhi tjetri dhe tha:

- *Es-Selamu alejkum ve Rahmetu’llah!*, e Resulallahu s.a.v.s. tha:

- **Ty të takojnë njëzet sevape.** Erdhi edhe i treti dhe tha:

- *Es-Selamu alejkum ve Rahmetu’llahi ve Berekatuh*”, e

Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **E ty të takojnë tridhjetë sevape.**¹⁶²

Enesi r.a., do t’u jepte i pari selam fëmijëve kur kalonte pranë tyre. Edhe Pejgamberi s.a.v.s., - sipas transmetimit – vepronte njëjtë.¹⁶³

Abdulhamid ibn Behrami tregon se Resulallahu s.a.v.s. po kalonte pranë xhamisë ku po qëndronin një grup njerëzish, dhe u dha selam me dorë. Më pas, Abdulhamidi i dha selam me dorë Hukaji-ut (hebre), e Resulallahu s.a.v.s., tha:

“Mos u jepni selam të parët hebrenjve dhe të krishterëve. Kur t’i takoni, detyroni të largohen nga rruga juaj.”¹⁶⁴

¹⁶² Shënojnë Ebu Davud dhe Tirmidhiu nga Imran ibn Husain. Tirmidhiu thotë që është hadith *hasen dhe garib*. Në veprën e vet ‘*Shu’abul-Iman*’, Bejhekiu këtë hadith e cilëson si hadith me zinxhir të mirë të transmetuesve (*hasen*).

¹⁶³ Buhariu dhe Muslimi.

¹⁶⁴ Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

Aisha r.anha. tregon:

- *Një fis hebre erdhi te Muhammedi s.a.v.s., dhe i thanë:*

- *Essamu alejk (Të goditë helmi)!’, e Hazreti Pejgamberi s.a.v.s. u përgjigj:*

- **Alejkum (Juve)! Unë thash:**

- *More, le t’ju godasë juve, helmi dhe mallkimi! Atëherë, Muhammedi s.a.v.s. më tha:*

- **O Aisha, Allahu e do butësinë – në gjithçka. E pyeta:**

- *A nuk i dëgjove çfarë thanë?’ Resulallahu s.a.v.s. m’u përgjigj:*

- **U thashë: Alejkum!**¹⁶⁵

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Kalorësi i jep selam këmbësorit, këmbësori atij që është ulur, grupi më i vogël i (njerëzve) grupit më të madh, dhe të rinjtë i japin selam të vjetrit.”¹⁶⁶

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Mos i imitoni hebrenjtë dhe të krishterët. Hebrenjtë përshëndeten me gishta, e të krishterët me pëllëmbë të dorës.”¹⁶⁷

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Kur dikush nga ju arrin në takim, le të japë selam. E nëse i tregohet vendi – le të ulet. Kur të ngritet, le të japë prapë selam. Selami i parë nuk është më i vlefshëm se i dyti; të dyja kanë vlerë të njëjtë.”¹⁶⁸

¹⁶⁵ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

¹⁶⁶ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a., me atë që te Muslimi nuk ndodhet pjesa: *“dhe të rinjtë i japin selam të vjetrit”*.

¹⁶⁷ Tirmidhiu nga Amr ibn Shuajb, i cili e përcjell nga babai i tij, e ky nga gjyshi i Amr-it.

¹⁶⁸ Ebu Davudi dhe Tirmidhiu nga Ebu Hurejre r.a.

Enesi r.a., tregon që e ka dëgjuar Resulallahun s.a.v.s. të ketë thënë:

“Kur takohen dy myslimanë, dhe të dytë japin selam dhe i shtrëngojnë dorën njëri-tjetrit, mes tyre lëshohen shtatëdhjetë rahmete – atij që ka dhënë selam i pari i shkojnë gjashtëdhjetë e nëntë rahmete, e atij që i pari ka zgjatë dorën, një.”¹⁶⁹

Hazreti Omeri r.a. tregon që e ka dëgjuar Resulallahun s.a.v.s. të ketë thënë:

“Kur takohen dy myslimanë, dhe të dytë japin selam dhe i shtrëngojnë dorën njëri-tjetrit, mes tyre lëshohen njëqind rahmete – atij që ka dhënë selam i pari i shkojnë nëntëdhjetë rahmete, e atij që i pari ka zgjatë dorën, dhjetë.”¹⁷⁰

Hasan Basriu thotë: *“Zgjatja e dorës (musafaha) rritë dashurinë”*.

Ebu Hurejre r.a., tregon që Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Shtrëngimi i duarve (musafaha) është plotësim i përshëndetjeve tuaja.”¹⁷¹, dhe në një hadith tjetër:

“Shtrëngimi i dorës paraqet puthjen e vëllait mysliman.”¹⁷²

Nuk ka asgjë të keqe që të puthet fizikisht dora e dijetarit, për lumturi/bereqet dhe për shprehje të nderimit. Ibn Omeri r.a., tregon:

“Ne i puthnim dorën Resulallahut s.a.v.s..”

¹⁶⁹ Teberani në *‘Evsat’* nga Ebu Hurejre r.a.

¹⁷⁰ Bezzar-iu në veprën e tij *‘Musned’*, Haraiti në veprën *‘Mekarim-i Ahlak’* nga ku është marrë ky version, dhe Bejheki në veprën *‘Shuabu’l-Iman’*.

¹⁷¹ Shënon Haraiti në *‘Mekarim-i Ahlak’* dhe Tirmidhiu nga Ebu Umame .

¹⁷² Shënojnë Harati dhe Ibn Adij nga Enes.

Ka'b ibn Malik ka thënë: *"Kur u shpall që më është pranuar pendimi, i shkova Resulallahut s.a.v.s. dhe ia putha dorën."*

Tregohet se një beduin kishte thënë: *"O i Dërguar i Allahut, më lejo të të puth kokën dhe dorën"*. Resulallahu s.a.v.s., e kishte lejuar e ky e kishte puthur.¹⁷³

Ebu Ubejde r.a kur e takoi hazreti Omerin r.a., në Sham i shtrëngoi duart me të, Ebu Ubejde r.a., i puthi dorën Omerit r.a., dhe (të dytë) qanë.

Bera' ibn Azib r.a., tregon që i dha selam Resulallahut s.a.v.s., deri sa Resulallahu ishte duke marrë abdes, e ai nuk iu përgjigj deri sa përfundoi abdesin. Atëherë ia ktheu selamin, i zgjati dorën dhe i shtrënguan duart. Azibi tha: *"O Resulallah, vetëm të huajt i kam parë të veprojnë kështu."* Resulallahu s.a.v.s. tha:

"Kur dy myslimanë takohen dhe i shtrëngojnë dorën njëri-tjetrit, gjynahet u bien."¹⁷⁴

Edhe fjalët në vazhdim transmetohen nga Resulallahu s.a.v.s.:

"Kur dikush të kalojë pranë një grupi njerëzish dhe ju jep selam, e këta ia kthejnë, ka një dobi më shumë se ata, sepse ai iu dha selam atyre. E nëse nuk ia kthejnë selamin, do t'i përgjigjen një shoqëri më e mirë e më e bukur se ata; ose ka thënë:

e më e vlefshme se ata."¹⁷⁵

¹⁷³ Shënon Hakimi, nga Burejde, me atë që në atë version thuhet: *"këmbën"*, në vend se *"dorën"*. Hadithi ka një zinxhir të besueshëm të transmetuesve (*sahih*).

¹⁷⁴ Shënon Haraiti e zinxhir të dobët të transmetuesve (*dhaif*). Hadithin e shënojnë edhe Ebu Davud, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe, në formë të shkurtuar: **"Kur dy myslimanë takohen dhe i shtrëngojnë dorën njëri-tjetrit, do t'u falet, para se të ndahen."**

¹⁷⁵ Shënon Haraiti, si edhe Bejhekiu në veprën e tij '*Shuabu'l- Iman'* nga Ibn Mesuda r.a.

Përrulja gjatë dhënies së selamit është e ndaluar. Enesi r.a., tregon:

- *Ne pytëm: 'O i Dërguari i Allahut, a do t'i përulemi njëri-tjetrit kur japim selam? Resulallahu s.a.v.s. na tha:*

- **Jo.** *A do ta puthim njëri-tjetrin?*

- **Jo.** *A do t'i shtrëngojmë duart njëri-tjetrit (musafaha)?*

- **Po.** *(shtrëngoni duart njëri-tjetrit)*¹⁷⁶

Lidhur me përqaftimin, shfaqjen e nderimit dhe pritjen e personit me rastin e kthimit nga rruga janë përmendur shumë transmetime. Ebu Dherr r.a., ka thënë: *"Sa herë që të takoja Pejgamberin a.s., do të ma shtrëngonte dorën. Bile, një ditë, më kishte kërkuar, e unë nuk isha në shtëpi. Kur më treguan që Muhammedi a.s. më ka kërkuar, shkova te ai dhe e gjeta ulur. U përqaftuam. Ishte shumë i lumtur."*

Për mbajtjen e yzengjisë së kalit deri sa dijetari të hip në kalë, si shenjë nderimi për dijetarët, ka disa transmetime nga as'habët. Ibn Abbasi ka mbajtur yzengjinë e kalit të Zejd ibn Sabitit. Edhe hazreti Omeri ka bërë të njëjtën, dhe ka thënë: *"Kështu të silleni me Zejdin, dhe me shokët e tij, (pra me dijetarët)."*

Ngritja në shenjë madhërimi është e papëlqyeshme, por jo edhe ngritja në shenjë respekti. Enesi r.a. ka thënë: *"Asnjë person nuk ishte më i dashur për ne se sa Resulallahu s.a.v.s., por kur as'habët e shihnin, nuk ngriteshin në këmbë, sepse e dinin që kjo nuk i pëlqente atij."*

Tregohet se Resulallahu s.a.v.s. një herë ka thënë:

"Kur të më shihni, mos u ngritni në këmbë, siç bëjnë të huajt".¹⁷⁷ Ose ... **'siç ngriten të huajt'.**

¹⁷⁶ Shënon Ibn Maxhe dhe Tirmidhiu, i cili e cilëson si hadith me zinxhir të mirë të transmetuesve (*hasen*).

¹⁷⁷ Ebu Davud dhe Ibn Maxhe nga Ebu Umame.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush gëzohet që njerëzit qëndrojnë në këmbë (kijam) për të, le t’i përgadisë vetes një vend në xhehenem.”¹⁷⁸

Gjithashtu, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Asnjëri të mos kërkojë që tjetri t’i lëshojë vendin për t’u ulur, por bëni vend për të tjerët duke u ngushtuar.”¹⁷⁹

As’habët ishin shumë të kujdeshëm në këtë çështje. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kur një grup njerëzish ulen bashkë në një mbledhje, nëse njëri nga ta e thërret vëllanë dhe i bën vend, vëllai le të pranojë. Ky është një ikram (gostitje/dhuratë). Por, nëse nuk i bën vend, atëherë ai person le të kërkojë ku në atë mbledhje ka vend, dhe aty le të ulet.”¹⁸⁰

Tregohet se një person i dha selam Muhammedit s.a.v.s., deri sa ky ishte duke kryer nevojën e vogël, dhe nuk ia kishte kthyer selamin. Prandaj është e papëlqyeshme (*mekruh*) t’i jepet selam dikujt kur është duke kryer nevojën. E papëlqyeshme është gjithashtu të jepet selam me fjalët *“alejkes-selam!”*, sepse një person ashtu kishte vepruar ndaj Resulallahut s.a.v.s., në çka ky ishte përgjigjur:

- ‘Alejkes-selam’ është përshëndetje e të vdekurit.

Këtë e përsëriti tri herë, e më pas tha:

- Kur dikush nga ju të takojë vëllanë e vet, le t’i thotë: ‘Es-selamu-alejkum ve Rahmetu’llahi!’¹⁸¹

¹⁷⁸ Ebu Davud dhe Tirmidhiu nga Muaviu. Tirmidhiu thotë që është hadith *hasen*.

¹⁷⁹ Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Omer r.a.

¹⁸⁰ Begaviu në veprën e tij *‘Mexhemu’s-Sahabe’*, transmetuar nga Ibn Shejbe. Zinxhiri i transmetuesve është i besueshëm.

¹⁸¹ Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, si dhe Nesai në veprën *‘El-Jevm ve’l-Lejle’*, nga Ibn Xheri el-Huxhemiu, i cili e tregon ngjarjen. Tirmidhiu, këtë transmetim e cilëson si të besueshëm (*hasen dhe sahih*).

Është e lavdërueshme (*mustehab*) që personi që hyn në një mbledhje dhe jep selam por nuk gjen vend, të mos kthehet, por të ulet në fund.

Resulallahu s.a.v.s., ishte ulur një herë në xhami. Hynë tre burra. Dy u afruan. Njëri nga ta e pa një vend të zbrazët dhe u ul aty. I dyti u ul mbrapa, e i treti u kthye dhe u largua. Kur Resulallahu s.a.v.s., përfundoi fjalimin, tha:

“A dëshironi t’ju tregoj gjendjen për këta të tre? Njëri nga ta kërkoi strehim te Allahu Teala, e Allahu e pranoi nën rahmetin e Tij. I dyti u turpërua, prandaj edhe Allahu Teala u turpërua nga ai. I treti u largua, e edhe Allahu Teala u largua prej tij.”¹⁸²

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kur dy myslimanë takohen dhe i shtrëngojnë duart njëri-tjetrit, u falen gjynahet enda pa u ndarë.”¹⁸³

Ummu Hani i dha selam Resulallahut s.a.v.s. e Resulallahu pyeti:

- **Kush është kjo?** As’habët iu përgjigjën:

- *Kjo është Ummu Hani.* Atëherë, Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Mirë se erdhe, Ummu Hani.**¹⁸⁴

Ndër detyra të myslimanit llogaritet edhe mbrojtja e nderit të vëllait mysliman, mbrojtja e jetës dhe pronës së tij nga dhuna e tjetrit, kur kjo të jetë e mundur, si në mungesë ashtu edhe në prani. Kjo hyn në kategorinë e domosdoshmërive (*vaxhib*), në përputhje me kërkesat e vëllazërimit në islam. Ebu Derda r.a., tregon që një person në prani të Resulallahut s.a.v.s., filloi të mallkojë një tjetër, dhe dikush u ngrit që ta mbrojë atë. Atëherë, Resulallahu s.a.v.s., tha:

¹⁸² Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Vakidi el-Lejsi.

¹⁸³ Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe, nga Bera ibn Azib.

¹⁸⁴ Muslimi, nga Ummu Hani.

“Kush ngritët në mbrojtje të nderit të vëllait të vet, kjo do t’i bëhet perde që do ta mbrojë nga zjarri.”¹⁸⁵

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Atë mysliman që mbron nderin e myslimanit tjetër, Allahu ka marrë obligim ta mbrojë nga zjarri i xhehenemit në Ditën e Gjykimit.”¹⁸⁶

Nga Enesi r.a., tregohet se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Para kujt flitet me qëllim poshtërimi të vëllait mysliman, e ky është në gjendje ta mbrojë por nuk e mbronë, në të njëjtën mënyrë Allahu Teala do ta poshtërojë, në dynjallëk dhe ahiret. E para kujt flitet me qëllim poshtërimi vëllai mysliman, e ky është në gjendje ta mbrojë dhe i ndihmon, atij do t’i ndihmojë Allahu Teala në dynjallëk e ahiret.”¹⁸⁷

Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Kush mbron nderin e vëllait mysliman në dynjallëk, Allahu Teala do t’i dërgojë një melaqe që në Ditën e Gjykimit ta mbrojë nga zjarri.”¹⁸⁸

Xhabiri dhe Ebu Talha r.a., tregojnë se e kanë dëgjuar Resulallahun s.a.v.s., të thotë:

“Ai person që e ndihmon vëllanë mysliman aty ku ai poshtërohet dhe mbrohet nderi i tij, Allahu Teala do t’i ndihmojë kur do t’i nevojitej ndihma. E ai person që vëllanë mysliman në mesin e një tubimi e poshtëron edhe Allahu Teala do ta poshtërojë atë në ditën kur dëshiron ndihmë.”¹⁸⁹

¹⁸⁵ Shënon Tirmidhiu, dhe e cilëson si transmetim me zinxhir të mirë të transmetuesve (*hasen*).

¹⁸⁶ Hadithin e shënon Ahmedi, transmetuar nga Esma bint Jezid, dhe Haraiti në veprën e vet **‘Mekarim-i Ahlak’**.

¹⁸⁷ Ibn Ebi’d Dynja.

¹⁸⁸ Ebu Davud nga Muadh ibn Enes,

¹⁸⁹ Ebu Davud.

E drejtë e myslimanit është gjithashtu kur të teshtinë dhe thotë *'Elhamdulillah'* t'i thuhet *'Jerhamukallah'*. Resulallahu s.a.v.s., ka thënë që, kur njeriu teshtinë, e thotë:

'Elhamdulillah ala kulli hal' (Falënderim Allahut për secilën gjendje), ai që dëgjon këtë le të thotë:

'Jerhamukallah' (Allahu të mëshiroftë),

E ai që ka teshtirë duhet të thotë:

'Jehdikumullahu ve juslihu balekum' (Allahu të udhëzoftë dhe të përmirësoftë gjendjen).¹⁹⁰

Ibn Mesud r.a., tregon që Resulallahu s.a.v.s., i ka mësuar as'habët:

"Kur dikush nga ju të teshtijë, le të thotë: *'Elhamdulillah'* (Falënderimi i qoftë Allahut). E kur të thotë kështu, ai që është afër tij le të thotë *'Jerhamukallah'* (Allahu të mëshiroftë). E kur t'i thonë kështu, ai që ka teshtirë le të thotë: *'Jagfirallahu li ve lekum'* (Allahu na faltë, mua dhe juve)."¹⁹¹

Një personi që teshtiu dhe tha *'Elhamdulillah'* Resulallahu s.a.v.s., i tha *'Jerhamukallah'*, e një tjetri që teshtiu nuk i tha asgjë. Personi e pyeti për këtë, e Resulallahu s.a.v.s., tha:

- Ai iu falënderua Allahut, e ti heshte.¹⁹²

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

"Le t'i dëshirohet shëndet myslimanit që teshtinë, deri në tri herë, e nëse teshtinë më shumë se kaq, kjo është ftohje (grip)."¹⁹³

¹⁹⁰ Buhariu dhe Ebu Davudi, transmetuar nga Ebu Hurejre r.a.

¹⁹¹ Shënon Nesai në veprën *'El-Jevm ve'l-Lejle'*, dhe Ebu Davud e Tirmidhiu, nga Salim ibn Abdullah.

¹⁹² Buhariu dhe Muslimi nga Enesi r.a.

¹⁹³ Hadithin e shënon Ebu Davudi nga Ebu Hurejre r.a.

Tregohet se një person kishte teshtirë tri herë. Më pas kishte teshtirë edhe një herë, e Resulallahu s.a.v.s., i kishte thënë:

“Tani u kuptua, je i ftohur.”¹⁹⁴

Ebu Hurejre r.a., thotë: *“Kur Resulallahu s.a.v.s. teshtinte, ulte zërin, e mbulonte gojën me dorë, bile ndonjëherë e mbulonte edhe fytyrën.”*¹⁹⁵

Ebu Musa el-Esh’ari tregon: *“Hebrenjtë qëllimisht do të teshtinin para Resulallahut s.a.v.s. që ky t’ju thotë ‘Jerhamukallah’ (Allahu ju mëshiroftë). Por, ai do t’ju përgjigjej:*

‘Jehdikumullah’ (Allahu ju udhëzoftë)!”¹⁹⁶

Abdullah ibn Amir ibn Rebia r.a., përcjellë nga babai i vet që një njeri kishte teshtirë para Pejgamberit s.a.v.s., në namaz, dhe kishte thënë: *“Elhamdulillah hamden kethiren tajjiben mubareken fihi kema jerda Rabbuna ve ba’de ma jerda vel-hamdulillahi ala kulli halin”* (Falënderimi i takon Allahut, shumë falënderim, në mënyrën më të mirë, në mënyrë të bekuar me të cilën Rabbi jonë është i kënaqur, dhe me të tjerat Ai të jetë i kënaqur, dhe falënderimi Allahut për secilën gjendje). Kur Muhammedi s.a.v.s., dha selamin, tha:

- **Kush i tha ato fjalë?** Personi tha:

- *Unë, o i Dërguari i Allahut, e me to vetëm të mirën kam dëshiruar.* Resulallahu s.a.v.s., iu përgjigj:

- **I pashë dymbëdhjetë melaqe se si nguten cili do t’i shënojë më parë ato fjalë.**¹⁹⁷

¹⁹⁴ Hadithin e shënon Muslimi nga Selema ibn el-Ekve.

¹⁹⁵ Shënojnë Ebu Davudi dhe Tirmidhiu dhe e cilësojnë si *hasen dhe sahih*.

¹⁹⁶ E shënon Ebu Davudi, si dhe Tirmidhiu, i cili e vlerëson si *hasen dhe sahih*.

¹⁹⁷ Ebu Davudi, transmetuar nga Abdullah ibn Amir ibn Rebi r.a., e ai nga i ati, me zinxhir të mirë të transmetuesve (*xhejjid*).

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush teshtinë dhe ngutet të falënderojë Allahun (elhamdulillah), nuk do të ankohet për dhimbje në ije.”¹⁹⁸

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Teshtima është prej Allahut, e hapja e gojës (gogësima) prej shejtanit, prandaj kur dikujt t’i hapet goja, le ta vendos dorën para gojës. E nëse thotë: “Aaa, aaa”, ky është shejtani duke qeshur nga brendia e tij.”¹⁹⁹

Ibrahim Nehai r.a., ka thënë:

“Nëse dikush teshtinë gjatë kryerjes së nevojës fiziologjike, nuk ka asgjë të keqe që në atë rast të përmend Allahun në vete.”

E Hasani Basriu ka thënë:

“Le t’i falënderohet Allahut në vete.”

Ka’abu’l- Ahbar ka thënë: *“Musa a.s. ka pyet:*

- O Rabb! A më je afër, e Të lus me zë ulët? Apo më je larg, e të Të lus me zë lartë?’ E Allahu Teala iu përgjigj:

- Unë jam bashkëfolës i atij që Mua më bën dhikër (më përmend). Atëherë, Musa a.s., tha:

- O Rabb! Ne nganjëherë jemi në gjendje xhunub ose duke kryer nevojën dhe na vie turp të Të përmendim Ty në këtë gjendje. E Allahu Teala u përgjigj:

- Më përmendni në çdo gjendje.”

¹⁹⁸ Taberani në veprën e vet **‘Evsat’** dhe në **‘ed-Dua’**, përcjellë nga hazreti Alia r.a.

¹⁹⁹ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a., pa fjalët: *“Teshtima është nga Allahu”*. Hadithin e shënojnë edhe Tirmidhiu, i cili e cilëson si *hasen*, dhe en-Nesai në veprën **‘El-Jevm ve’l-Lejle’** Në versionin të cilin e shënon Buhariu thuhet: *“Allahu e do teshtimën, dhe e përbuzë hapjen e gojës (gogësimën).”*

Si detyrë e myslimanit llogaritet edhe ajo nëse sprovohet me atë (person) që është i keq, ta përballojë dhe të përpiqet të ruhet prej tij. Dikush ka thënë: *“Me besimtarin të jesh i sigurtë, e me të keqin përpiqu të kalosh mirë.”* Me këtë ka thënë që personat e këqij kënaqen në të jashtmen.

Ebu'd Derda r.a., ka thënë:

“Me njerëzit e këqij kemi qenë fytyrë-qeshur, e me zemër i kemi mallkuar.”

Një veprim i tillë nuk është hipokrizi, është largim me fytyrë të buzëqeshur. Allahu Teala thotë:

“Largoje të keqen me atë që është më e mira.”

23-Mu'minun: 46

Ibn Abbasi r.a., në komentimin e ajetit:

“...dhe me të mirë e largojnë të keqen.” (13-Ra'd: 22), ka thënë që me buzëqeshje dhe përshëndetje e largojnë atë i cili ofendon. E në komentimin e ajetit:

“...dhe sikur Allahu të mos i mbronte njerëzit me disa prej disa të tjerëve...” (2-Bekare: 251), ka thënë: me frikë, me turp dhe me buzëqeshje.

Aisha r.anha ka thënë:

- *Një person kërkoi leje nga Muhammedi s.a.v.s. për të hyrë, e Muhammedi a.s., na tha:*

- **Lerëni të hyjë, ai është njeriu më i keq prej fisit të tij.** Kur hyri, Resulallahu s.a.v.s. fliste butë me të, në atë masë sa mendova mos ky person ka një vend të posaçëm te Resulallahu s.a.v.s. Kur doli, i thashë Resulallahut s.a.v.s.:

- *E the atë që e the, e më pas butësisht flisje me të?! Në këtë, Resulallahu tha:*

- **O Aisha, te Allahu, në Ditën e Gjykimit, vendin më të keq do ta ketë njeriu të cilin të tjerët e kanë lënë, duke u frikësuar nga mos-njerëzia e tij.**²⁰⁰

²⁰⁰ Buhariu dhe Muslimi nga Aisha r.a.

Në transmetimin tjetër thuhet:

“Ajo me çka njeriu e ruan nderin, atë e ka sadaka.”²⁰¹

Në një transmetim nga as’habët thuhet:

‘Shoqërohuni me njerëz përmes punëve, e braktisni me zemra.’

Muhammed ibn Hanefiu thotë:

“Nuk është i mençur ai që nuk sillet mirë me atë me të cilin është i detyruar të shoqërohet, deri sa Allahu ta shpëtojë nga ai.”

Si detyrë e myslimanit llogaritet edhe largimi nga shoqërimi me të pasurit, dhe shoqërimi me të varfrit, dhe që në mënyrën më të mirë të sillet me jetimët. Resulallahu s.a.v.s. do të thoshte:

“Allah, më bëj që të jetoj i varfër, dhe më bëj që të vdes i varfër, dhe më ngjall në shoqëri të të varfërve.”²⁰²

Ka’abu’l- Ahbar ka thënë:

- Sylejmani a.s., kur hynte në xhami (mesxhid) dhe shihte ndonjë të varfër, do të ulej afër tij. Thoshte:

- Fukaraja ulet me fukaranë.

Thuhet që nga të gjitha fjalët drejtuara hazreti Isasë a.s., më të dashurat i kishte kur dikush i thoshte: *‘O fukara!’*

Ka’abu’l- Ahbar ka thënë: *‘Ajo që është e shkruar në Kur’an: ‘O ju që besoni (Ja ejjuhelledhine amenu)’, në Teurat ka qenë e shkruar: ‘O fukara’ (Ja ejjuhel-mesakin).’*

Ubade ibn Samit r.a., ka thënë:

“Xhehenemi i ka shtatë dyer, tri janë për të pasurit, tri për gra, e një për të varfrit dhe të pastrehët.”

²⁰¹ Ebu Ja’la dhe Ibn Adijj nga Xhabiri r.a.

²⁰² Ibn Maxhe dhe Hakimi nga Ebu Seidi. Hadithin e shënon edhe Tirmidhiu, nga Aisha r.anha.

Fudajl r.a., ka thënë:
- *Njëri nga Pejgamberët ka thënë:*
- *O Allah, si mund ta dijë se çka është ajo me të cilën do të jesh i kënaqur me mua?’ E Allahu iu përgjigj:*
- *Shiko se me çka janë të varfrit të kënaqur me ty, edhe Unë ashtu bëhem i kënaqur (razi) me ty.*

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:
- **Ruajuni nga ndeja me të vdekurit!** As’habët e pyetën:
- E, kush janë të vdekurit?, e Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:
- **Të pasurit.**²⁰³

Musa a.s. ka thënë:
- *O Allah, ku të Të kërktoj?’ Allahu Teala iu përgjigj:*
- **Në zemrat e thyera.**

Resulallahu s.a.v.s., thotë:
“Mos lakmo pasurinë që posedon njeriu i keq, sepse ti nuk e di çka do të ndodhë pas vdekjes së tij. Pas saj ekziston vërtetë kërkesë prej tij.”²⁰⁴

E në lidhje me jetimët, Resulallahu s.a.v.s., thotë:
“Kush pranon jetimin, prindërit e të cilit kanë qenë myslimanë, deri sa ky të bëhet i pavarur, gjithsesi se do të hyjë në xhennet, kjo është e pashmangshme.”²⁰⁵

²⁰³ Hadithin e shënon Tirmidhiu, që e cilëson si transmetim me zinxhir të dobët të transmetuesve (*daif*) dhe Hakimi nga Aisha r.a., i cili e cilëson si transmetim me zinxhir të besueshëm të transmetuesve (*sahih*), kurse te Hakimi fillon me: *“Ruajuni nga ndeja me të pasurit!”*

²⁰⁴ Shënojnë Buhariu në veprën *‘Tarih’*, Taberani në veprën *‘Evsat’* dhe Bejhëkiu në veprën *‘Shuabu’l-Iman’*, nga Ebu Hurejre r.a.

²⁰⁵ Ahmedi dhe Taberani, nga Malik ibn Omer.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Unë dhe kujdestari i jetimit në xhenet jemi si këta të dy (i ka treguar dy gishtat e vet).”²⁰⁶

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Kush i përkëdhel kokën jetimit nga mëshira, do të ketë sevape për secilën qime që dora i ka prekur.”²⁰⁷

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Shtëpia më e mirë e myslimanit është ajo shtëpi ku gjendet një jetim ndaj të cilit ka sjellje të mirë. E shtëpia më e keqe e myslimanit është ajo në të cilën gjendet një jetim ndaj të cilit ka sjellje të keqe.”²⁰⁸

Si detyrë e myslimanit është edhe dhënia e këshillave secilit mysliman, dhe të mundohet t’i kënaqë ata. Muhammedi s.a.v.s., thotë:

“Besimtari do për besimtarin atë që do për vete.”²⁰⁹

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Secili prej jush është pasqyrë e vëllait të vet, prandaj kur të shihni te ai një njollë, largojeni (nga ai).”²¹⁰

Gjithashtu, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush e plotëson nevojën e vëllait të vet, sikur t’i kishte shërbyer Allahut gjithë jetën.”²¹¹

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush e gëzon një besimtar, Allahu do ta gëzojë në Ditën e Gjykimit.”²¹²

²⁰⁶ Buhariu nga Sehl ibn Sa’d, dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

²⁰⁷ Ahmedi dhe Taberani nga Ebu Umame dhe Ibn Hibban në veprën e tij *‘Dhuafa’* nga Ibn Ebu Evfa.

²⁰⁸ Ibn Maxhe nga Ebu Hurejre r.a.

²⁰⁹ Tashmë kemi folur për hadithin: **“Asnjëri nga ju nuk do të besojë deri sa nuk dëshiron për vëllanë atë që do për vete.”**

²¹⁰ Ebu Davudi dhe Tirmidhiu.

²¹¹ Buhariu në veprën e tij *‘Tarih’*, si dhe Taberani dhe Haraiti në veprën *‘Mekarim-i Ahlak’*, nga Enesi r.a.

²¹² Ibn Mubarek në veprën *‘Duhud’*.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush ecë për një orë duke u munduar që të plotësojë nevojën e vëllait të vet, ditën apo natën, e plotësoi atë apo jo, është më mirë për të se sa të kalojë dy muaj në i'tikaf.”²¹³

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush ia largon besimtarit ndonjë brengë, ose i ndihmon personit të cilit i është bërë e padrejtë, Allahu do t'i dhurojë shtatëdhjetë e tri falje.”²¹⁴

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

- Ndhimoi vëllait tënd, kur ai bën zullum (zalim) dhe kur i bëhet zullum atij (mazlum). As'habët pyetën:

- Si ta ndihmojmë zullumqarin?

- I ndihmoni duke e ndaluar atë nga zullumi.²¹⁵

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Ndër veprat më të dashura për Allahun është mbjellja e kënaqësisë në zemrën e besimtarit, largimi i ndonjë brengje nga ai, heqja e borxhit, ose të ushqyerit kur është i uritur.”²¹⁶

Resulallahu s.a.v.s., thotë edhe këtë:

“Kush e mbron besimtarin nga vuajtja prej hipokritit, Allahu Teala do t'i dërgojë një melek në Ditën e Gjykimit, që t'ia mbrojë mishin e tij nga zjarri i xhehenemit.”²¹⁷

²¹³ shënon Hakimi dhe e vlerëson si të besueshëm (sahih), përcjellë nga Ibn Abbasi r.a. Hadithin e shënon edhe Taberani, në veprën **'Evsat'**, në version pak më ndryshe.

²¹⁴ e shënojnë Haraiti, në veprën **'Mekarim-i Ahlak'**, Ibn Hibban, në veprën **'Dhu'afa'**, dhe Ibn Adij nga Enesi, me fjalët: **“Kush heq mërzinë...”**

²¹⁵ Buhariu dhe Muslimi (*muttefekun alejhi*), nga Enesi r.a

²¹⁶ Taberani në veprat e tij **'Sagir'** dhe **'Evsat'**, nga Ibn Omeri r.a.

²¹⁷ Ibn Mubarek, Ahmed, Ebu Davud, Ibn Ebi'd Dynja në temën e telendisjes dhe Teberani nga Sehl b. Muadhi.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Janë dy veti, që s’ka më të këqija se to: bërja shirk Allahut dhe bërja dëm robërve të Tij. E janë edhe dy veti tjera, që s’ka më të mira se to: besimi Allahut dhe të qenit i dobishëm ndaj robërve të Allahut.”²¹⁸

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush nuk interesohet për shqetësimet e myslimanëve, nuk është prej tyre.”²¹⁹

Ma’ruf Kehri ka thënë: *‘Kush thotë për çdo ditë: ‘Allahumma rahmeti ummeti Muhammedin’ (Allah, bëj rahmet mbi ummetin e Muhammedit), Allahu do ta lartësojë ndër evliatë. Me një transmetim tjetër: ‘...çdo ditë tri herë.’*

Një ditë, Ali ibn Fudajl po qante, dhe kur dikush e pyeti pse po qanë, ai u përgjigj:

- Po qaj për atë që më ka bërë zullum; kur të dalë nesër para Allahut Teala, e do të pyetet për atë zullum, e s’do të ketë kurrfarë përgjigje, më dhemb gjendja e tij, dhe për këtë po qaj.

Detyrë e myslimanit llogaritet edhe vizita myslimanëve të sëmurë. Dituria dhe Islami mjaftojnë si bazë për këtë detyrë, dhe për arritjen e dobisë nga ajo. Ai që viziton të sëmurin duhet të qëndrojë shkurt te i sëmuri, të pyet pak, të mos shprehet ndjenja e detyrës, të bëjë dua për shërimin e të sëmurit, të ulë shikimin nga vendet e fshehura.

Kur kërkon lejen për të hyrë, personi që viziton të sëmurin, nuk do të kapë menjëherë dorëzën e derës, por do të trokasë butësisht, dhe nuk do të përgjigjet me *“Unë!”*, kur

²¹⁸ Shënon autori i veprës *‘Firdavs’* (Dejlemi), nga Alia r.a..

²¹⁹ Hakimi nga Huzejfe r.a., si edhe Taberani në veprën e tij *‘Evsat’*, nga Ebu Dherri r.a.

të pyetet: “Kush është?”. Nuk do të thotë: “Ku je o djalë i ri”, por do të thotë *elhamdulillah* dhe *subhanallah*. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Tërësia e vizitës së të sëmurit është në pyetjen ‘si je’, derisa i vendosim dorën në ballë ose duke ia mbajtur dorën. Edhe tërësia e selamit është t’i shtrëngohen duart njëri-tjetrit (*musafaha*).”²²⁰

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush viziton të sëmurin është sikur të jetë ulur në bahçen e xhennetit. E kur të largohet, shtatëdhjetëmijë melaqe, do të luten për faljen e tij, deri në mbrëmje.”²²¹

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kur dikush shkon në vizitë te i sëmuri, është futur në detin e rahmetit. E kur ulet pranë të sëmurit, është zhytur plotësisht në detin e rahmetit.”²²²

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Kur myslimani viziton vëllanë e vet mysliman, Allahu Teala thotë: ‘Ti je i mirë, rruga që ke bërë është e mirë, dhe të është përgatitur një vend në xhennet.’”²²³

²²⁰ Ahmedi dhe Tirmidhiu.

²²¹ Hadithin e shënojnë autorët e veprës ‘*Sunen*’, dhe Hakimi nga hazreti Alia r.a. Ibn Maxhe dhe Hakimi këtë hadith e vlerëson si *sahih*, kurse Tirmidhiu si *hasen*. Hadithin e shënon edhe Muslimi, përcjellë nga Sevban: “Kush viziton të sëmurin, pandërprerë është në bahçen e xhennetit.”

²²² Hadithin e shënojnë Hakimi dhe Bejhekiu nga Xhabiri r.a., ku thuhet: “...zhytet në të.” Hakimi e konsideron si transmetim të besueshëm (*sahih*), me kushtet e Muslimit. Këtë hadith *sahih* e vlerëson edhe Ibn Abdulberr. Hadithin e shënon edhe Malikiu në veprën e vet Muvetta’, me fjalët: “...rrënjaset në të.” E shënon edhe Vakidi, me fjalët “...forcohet në të.” Në veprën e tij, **Sagir**, Taberani e shënon hadithin nga hazreti Enesi: “...e kur të ulet te ai, e mbulon rahmeti.” E në veprën e tij **Evsat**, Taberani këtë hadith e shënon nga Ka’ba ibn Malik dhe Amr ibn Hazma: “... lahet në te (*istenki’a fiha*).”

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

Kur sëmuret robi, Allahu Teala i dërgon dy melaqe:

- 'Shikoni ju të dy se çka po ju thotë ky atyre që i vijnë në vizitë!' Nëse ky falënderon dhe lartëson Allahun, dy melaqet këtë ia tregojnë Allahut, e Ai tashmë e di për këtë dhe thotë:

- 'Robi im ka të drejta te Unë, që, nëse e vdes, ta dërgoj në xhennet, dhe nëse i jap shërim, mishin t'ia zëvendësoj me mish më të mirë, gjakun me gjak më të mirë, t'ia falë veprat e këqija.'²²⁴

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

"Kujt ia do Allahu të mirën, e bën të sëmuret."²²⁵

Hazreti Osmani r.a., tregon:

- *Kur u sëmura, më erdh Resulallahu s.a.v.s. në vizitë, dhe tha:*

- **O Osman, lexoje këtë dua:**

Bismil'lahi'r-rahmani'r-rahim kërkoj strehim te Allahu nga kjo e keqe, Ai është një dhe i Vetëm.

Ai që çdo krijesë i derjtohet (i mbështetet) për çdo nevojë.

As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur.

Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!'²²⁶

²²³ Hadithin e shënojnë Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe nga Ebu Hurejre r.a.

²²⁴ Hadithin e shënon Imam Maliku, në veprën '*El-Muvetta'*, si hadith mursel, përcjellë nga Ata ibn Jesar dhe Ibn Abdalberr nga Ebu Seid el-Hudriu.

²²⁵ Buhariu nga Ebu Hurejre r.a.

²²⁶ Ibn Suni në veprën '*El-Jevm ve'l-Lejle'*, Taberani, si dhe Bejhekiu në veprën '*Edije'*, përcjellë nga Osman ibn Affan me zinxhir të mirë të transmetuesve (*hasen*).

Resulallahu s.a.v.s., shkoi te hazreti Alia r.a., që ishte i sëmurë, dhe i tha:

Thuj: ‘Allah, kërkoi prej Teje shërim të shpejtë, ose sabër (durim) në telashe, ose largim nga dynjallëku drejt rahmetit Tënd’, e të jesh i bindur – se Allahu do të të japë diçka nga kjo.²²⁷

Për atë që është i dobët, gjithashtu është e lavdërueshme (*mustehab*) të thotë: “*Strehohem në fuqinë e Allahut nga e keqja dhe frika me të cilën ndeshem.*”

Hazreti Alia r.a., ka thënë:

“Kur dikush nga ju të ankohet nga dhimbjet në bark, le të kërkojë nga bashkëshortja e vet një pjesë të dhuratës për martesë, me vlerën e kësaj le të blejë mjaltë, le ta përziejë me ujë e shiut dhe le ta konsumojnë bashkë. Paratë hallall nga kurora, bashkë me bereqetin dhe pastërtinë e ujit të shiut, bëhen shërim.”

Ebu Hurejre r.a. tregon:

“Muhammedi s.a.v.s., më tha:

- O Ebu Hurejre, a dëshiron të të mësoj një dua, e që kush (e lexon) i thotë ato fjalë kur është i shtrirë nga sëmundja, e fiton të drejtën që Allahu ta shpëtojë nga Zjarri.

I thashë: ‘Dua, o Resulallah’, e Muhammedi s.a.v.s., tha:

- Kush thotë: ‘Nuk ka ilah tjetër pos Allahut i Cili jep jetën dhe vdekjen, Ai është i Gjalli, nuk vdes. Lavdëruar qoftë Allahu, Rabbi i njerëzve dhe popujve. Falënderimi i takon vetëm Allahut, shumë falënderim, të bukur, të bekuar, në secilën gjendje i qoftë Allahut. Allahu është më i madhi, madhështia dhe fuqia e Tij janë në secilin vend. O Allah, nëse më ke bërë të sëmurë për të më marrë shpirtin në këtë sëmundje, bëj që shpirti im të jetë nga ata shpirta që ju ke dhënë të mirën, dhe më largo nga Zjarri, ashtu siç i ke larguar robërit e Tu të mirë.’²²⁸

²²⁷ Ibn Eb’i Dunja në veprën ‘*Maradh*’ nga Enesi r.a.

²²⁸ Ibn Eb’i Dynja, në veprën ‘*Ed-Dua ve’l-Maradh ve’l-Kefarat*’.

Tregohet që Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:
“I sëmuri vizitohet pas tri dite, e vizita duhet të jetë shumë e shkurtë.”²²⁹

Tavus-i ka thënë:
“Vizita më e pëlqyshme është ajo që është më e shkurta.”

Ibn Abbas r.a., ka thënë:
“Të vizitosh të sëmurin një herë, është sunnet, e gjithçka më shumë është nafile (vepër vullnetare).”

Resulallahu s.a.v.s., thotë::
“Vizitoni të sëmurin çdo tri ditë, ose çdo katër ditë.”²³⁰

Me një fjalë, sjellje që i përshtaten (edeb) i të sëmurit duhet të jetë sabri, sa më pak ankesa dhe mllef, kthim kah duaja, dhe mbështetje te Ai që krijon sëmurdjen dhe jep shërimin.

Detyrim i myslimanit llogaritet edhe përcjellja e xhenazeve. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush përcjellë xhenazen, ka shpërblimin e një kirati. E nëse pret deri sa të varroset xhenazja, ka shpërblimin e dy kiratëve.”²³¹

Në një transmetim tjetër thuhet:
“Një kirat është sa kodra Uhud.”²³²

²²⁹ Ibn Eb'i Dynja, në veprën *‘Kitabu’l-Maradh’* nga Enesi r.a.

²³⁰ shënon Ibn Ebu ed-Dun’ja, ku në zinxhirin e transmetuesve gjendet edhe Ebu Ja’la, kurse hadithin e përcjellë Xhabiri.

²³¹ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

²³² Muslimi nga Sevbani dhe Ebu Hurejre r.a.

Kur Ebu Hurejre r.a., e ka treguar këtë hadith, e ka dëgjuar Ibn Omeri r.a., dhe ka thënë:

- *Deri tash nuk kemi vlerësuar shumë kiratët. Me termin 'teshji' – përcjellje e xhenazes, mendohet në përmbushjen e obligimit të myslimanit dhe në marrjen e mësimit.*

Mekhul Dimishkiu, kur të shihte ndonjë xhenaze, do të thoshte: *"Ju shkoni në mëngjes, e ne do të shkojmë në mbrëmje. Para syve të të gjithëve është një këshillë e qartë dhe një pavëmendshmëri e shpejtë. Ata shkojnë, e këta mbrapa nuk tregojnë vëmendje."*

Malik ibn Dinari po përcillte xhenazen e vëllait të vet. Qante, dhe thoshte:

- *Vallahi, sytë nuk do të më qetësohen deri sa të marr vesh se çka do të ndodh me ty. Vallahi, këtë nuk do ta di deri sa të vdes.*

A'meshi Kufiu ka thënë:

- *Ne merrnim pjesë në varrime, por nuk e dinim cilin ta ngushëllojmë nga ata që ishin prezentë, sepse të gjithë ishin mërzitur.*

Ibrahim Zejjadi, duke parë disa njerëz që po vajtonin shumë një xhenaze u tha:

- *Më e hairit është të vajtoni veten. Sepse ai (i vekuri) tani ka kaluar- tri etapat: shikimin e Azrailit a.s., shijen e idhët të vdekjes dhe frikën e përfundimit me besim apo pa besim.*

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

"Të vdekurin e përcjellin tri gjëra: familja, pasuria dhe veprat, nga këto dy kthehen, e një mbetet. Familja dhe pasuria kthehen, kurse veprat mbetin me të."²³³

²³³ Muslimi nga Enesi r.a.

Detyrë e myslimanit është edhe vizita varrezave. Qëllim i kësaj është këndimi i duasë, nxjerrja e mësimit dhe zbutja e zemrës. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Nga të gjitha vendet që i kam parë, varri është më i tmerrshmi.”²³⁴

Hazreti Omeri r.a., tregon:

- *Dolëm me Resulallahun s.a.v.s., dhe shkuam në varreza. Ai u ul te një varr, e unë isha afër tij. Ai qante, e qanim edhe ne. Na pyeti:*

- **Pse po qani? Iu përgjigjëm:**

- *Qajmë sepse ti qanë’, e ai na tha:*

- **Ky është varri i Emines (nënës) e bija e Vehbit. E luta Allahun të më lejojë që ta vizitoj, dhe më lejoi. E luta që të më lejojë të bëj istigfar për të, e këtë ma refuzoi. Për këtë, po qaj me dhembshuri të evladit.”²³⁵**

Omeri r.a., kur ndalej të varrezat, qante deri sa mjekra t’i lagej, dhe do të thoshte: *“E kam dëgjuar Resulallahun s.a.v.s., të thotë:*

“Varri është vendqëndrimi i parë në ahiret. Nëse personi shpëton nga vuajtja e varrit, ajo çka pason është më e lehtë. E nëse nuk shpëton, ajo që pason është edhe më e rëndë.”²³⁶

Muxhahidi ka thënë:

- *I biri i Ademit (njeriu), fillimisht do të flasë me varrin e tij, i cili do t’i thotë:*

- *Unë jam shtëpi e krimbave, shtëpi e vetmisë dhe errësirës. Po ti, çka ke përgatitur karshi këtyre?*

²³⁴ Shënojnë Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Hakimi nga Osmani. Hakimi e vlerëson si hadith me zinxhir të besueshëm të transmetuesve.

²³⁵ Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

²³⁶ Shënon Tirmidhiu. Ibn Maxhe ka thënë që është ‘hasen’, E Hakimi ‘sahih’.

Ebu Dherri r.a., kishte thënë:

“A dëshironi t’ju flasë për ditën e varfërisë sime? Ajo është dita kur të më vendosin në varr.”

Ebu Derda r.a., në përgjithësi rrinte te varrezat. Dikush e pyeti pse, e ai u përgjigj:

- Po rri me njerëzit që më përkujtojnë kthimin tim, e kur largohem prej tyre, ata nuk flasin kundër meje.

Hatem Essami ka thënë:

“Kush kalon pranë varrezave e nuk mendon për vete dhe nuk i bën dua Allahut për ata që janë të varrosur aty, ai ka tradhtuar edhe veten edhe ata.”

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

- Çdo natë një telall u drejtohet të vdekurve:

- Kujt i keni lakmi? E ata (të vdekurit) përgjigjen:

- I kemi lakmi njerëzve që shkojnë në xhami, sepse ata agjërojnë e ne jo, ata falin namazin, e ne jo, ata i bëjnë dhikër Allahut, e ne jo.²³⁷

Sufjan Sevriu ka thënë:

‘Kush mendon shpesh varrin dhe për këtë pregaditet, do ta gjejë atë si një bahçe të xhenetit. E ai që nuk e mendon dhe është i pakujdesshëm për këtë, do ta gjejë atë si një gropë të xhehnemit.’

Rebi b. Hasjemi kishte hapur një varr në oborrin e vet. Kur ndjente ngurtësi në zemër, hynte në atë varr, dhe qëndronte i shtrirë aty për një orë. Më pas thoshte:

“O Rabbi im, më kthe, që të bëj vepra të mira e të kompensoj atë që lëshova!” (23: 99, 100)

e më pas do t’i përgjigjej vetes: *‘Rebi, u ktheve, tash puno, para se të vish përsëri këtu.’*

²³⁷ Burimi i hadithit nuk është gjetur.

Mejmun ibn Mihran tregon:

- *Shkova me Omer ibn Abdulazizin në varreza. Kur Omeri i shikoi varrezat, filloi të qajë. Më tha:*

- *O Mejmun, këto janë varret e paraardhësve të mi, Emevi. Sikur të mos kishin marrë pjesë fare me banorët e dynjallëkut në kënaqësi. Të gjithë erdhën e shkuan. Tani kufomat e tyre janë duke i ngrënë krimbat nën tokë. Dhe vazhdoi të qajë. Më pas, tha:*

- *Vallahi nuk di kush është në këto varreza i mbrojtur nga dënimi i Allahut.*

Edebi i atij që ngushëllon të pikëlluarit shihet në atë që të jetë i butë, të shfaq dhimbje, të flasë pak dhe të mos qesh.

Kurse edebi i atij që përcjellë xhenazen shihet në atë që është i pikëlluar, nuk flet, shikon drejt xhenazes, të mendojë për vdekjen dhe të përgatitet për të, dhe të ecë para xhenazes, por jo larg. Është sunnet, ngutja në varrimin e xhenazes.²³⁸

Kjo është një përmbledhje e edebeve që tërheqin vërejtjen se si duhet sjellë me njerëz. Dhe krejt kjo tregon që nuk duhet të përçmohet askush, i vdekur a i gjallë, sepse ajo çon në shkatërrim. Ti nuk e di se a është dikush më i mirë se ti. Sepse, nëse ai ka qenë gjynahqar, ndoshta Allahu Teala ty të jep përfundim të gjynahqarit, e atij përfundim të mirë. Mos i shih si të rëndësishëm njerëzit për shkak të pasurisë së tyre në në këtë botë (dynja), sepse kjo botë, në sytë e Allahut, është e pavlefshme. Mos e humb imanin tënd për të arritur dynjallëkun e tyre, kur çmon dynjallëkun e tyre – je nënçmuar tek Allahu. Mos sakrifiko fenë për të arritur dynjallëkun; nëse kështu vepron, nënçmohesh nga poseduesit të dynjallëkut dhe kështu e shkatërron fenë dhe dynjallëkun tënd. Edhe nëse arrin dynjallëkun e tyre, ke dhënë të mirën e ke marrë të

²³⁸ Ecja para xhenazes është sipas Shafive, e sipas Hanefive ecet mbrapa. Te të dy medh'hebet ka dëshmi.

keqen; e në këtë tregti tënde mashtrohesh. Mos ushqe armiqësi haptas ndaj tyre ngase mund të mbetesh në situatë të vështirë. Armiqësia të hakmerret, dhe për shkak të kësaj mund të humbasësh imanin, kurse edhe ata mund të humbasin besimin e vet për shkakun tënd. Përrjashtim bëhet nëse ke vërejtur diçka të keqe që është e ndaluar në fe. Atëherë, urren veprat e tyre të këqija, e ata vet shikoj me dhimbje, sepse ata janë duke iu ekspozuar përbuzjes së Allahut Teala dhe dënimit të Tij për shkak të gjynaheve të tyre. Fundi i tyre do të jetë xhehenemi, në të do të digjen, e ti, nuk ke nevojë të ushqesh më shumë urrejtje për ta.

Mos u habit nga dashuria dhe interesimi i tyre i pasinqertë, në mesin e njëqind prej tyre do të gjesh një të sinqertë, e nganjëherë asnjë. Mos iu anko atyre për gjendjet tua, sepse Allahu Teala do të të lë me ta, pastaj bëhesh më shumë pishman. Mos prit që ata të jenë me të tjerët ashtu siç janë me ty; sepse-kjo është një shpresë e kotë. Mos kërko atë që është në duart e tyre; të pritet diçka prej tyre, e poshtëron njeriun. Mos rrit mendjen karshi të tjerëve duke menduar se nuk ke nevojë për asgjë, ngase një ditë Allahu Teala bën që të kesh nevojë për ta, dhe vuan dënimin e mendjemadhësisë. Nëse kërkon nga ndonjë vëlla diçka, e ai ta plotëson nevojën, ai është vëlla i dobishëm; e nëse nuk ta plotëson, mos e ofendo, sepse do të të bëhet armik dhe do ta shpreh armiqësinë për kohë të gjatë. Mos harxho kohë duke ia tërhequr vërejtjen atij për të cilin e sheh se nuk do të pranojë këshillën, sepse nuk do të të dëgjojë, do të zemrohet nga fjalët tua dhe do të shfaq armiqësi.

Tërheqja e vërejtjes dhe këshilla jote duhet të jetë e përgjithshme, mos merr asnjë person si synim.

Kur te dikush të vëresh ndonjë mrekulli (keramet) dhe të mirë, falëndero Allahun Teala që ka shfaqur ato, dhe kërko strehim te Ai që njerëzit mos të mendojnë se këto janë prej teje. Nëse kupton që po shpifin për ty, ose kupton për ndonjë të keqe të tyre, ose të godet ndonjë e keqe nga ta, mbështetu Allahut Teala, strehoju te Ai nga e keqja e tyre. Leje hakmarrjen, vetëm do të të rritet dëmi, dhe do ta harxhosh gjithë jetën tënde në këtë. Mos u thuaj: *'Ju nuk dini sa di unë'* por kupto mirë nëse meriton, Allahu Teala vendos një pozitë në zemrat e tyre për ty, sepse është Allahu Teala Ai që të bën të dashur ose të urryer në zemrat e të tjerëve. Kur je në mesin e tyre dëgjo fjalët e drejta të tyre dhe hesht karshi fjalëve të padrejta të tyre, mbroj të drejtat e tyre dhe hesht për gabimet e tyre.

Mos u shoqëro me çdokë; sepse shumica e njerëzve nuk falin rrëshqitjen padashje të gjuhës, kërkojnë llogari edhe për një gabim të vogël, nuk i mbulojnë turpet dhe të gjitha i masin deri në imtësinë më të vogël. Të tillët kanë lakmi, edhe për pak edhe për shumë, duan që gjithçka të ndahet me ta, kurse nuk duan të ndajnë asgjë të veten.

E marrin për të keq secilin gabim, të bërë nga pakujdesi ose harresa, dhe nuk falin. I provokon vëllezërit e vet, duke bartë fjalë për ta. Shoqërimi me një të tillë, kryesisht nënkupton shkatërrim, kurse ndërprerja e lidhjes me të nënkupton përparësi në jetë.

Nëse janë të kënaqur me diçka, do të bëjnë lajka, e nëse diçka nuk u jepet, inati u del nga përbrenda. Nuk besojnë kur janë të zemëruar, nuk kanë shpresë kur bëjnë lajka. E jashtëmja e tyre është lëkurë deleje, kurse e brendshmeja ujk.

Për gjëra të dyshimta japin gjykim të prerë, pas shpinës tënde kërkojnë gabimet tua. E për shkak të zilisë, kërkojnë gjëra të dyshimta te shokët.

Vazhdimisht presin rrëshqitjen e gjuhës tënde në biseda, që kur zemërohen të të turpërojnë.

Mos e rrit dashurinë ndaj dikujt që e njeh pak, deri sa të kalosh një periudhë shoqërimi me të, në shtëpi ose në një vend tjetër, që të kuptosh se çfarë është kur është vetëm, kur përfaqëson dikë, çfarë është në pasuri dhe në varfëri. Ose deri sa të udhëtosh me të, ose të jesh partner me të në punë të dynjasë dhe me para. Ose deri sa nuk futet në ndonjë telashe, e nëse i kërkon diçka, e ai në atë gjendje ta plotëson kërkesën, atëherë pranoje për vëllazëri, le të bëhet babai yt nëse është më i vjetër se ti, ose djali yt - nëse është më i ri se ti, ose merre për vëlla, nëse është moshatar i yti.

Kjo është përmbledhja e edebeve të shoqërimit me njerëz të ndryshëm.

TË DREJTAT E KOMSHIUT

Dije se: ndër të drejtat e myslimanëve bëjnë pjesë edhe të drejtat e komshillëkut. Një komshi mysliman ka më shumë të drejta nga myslimanët e tjerë sepse Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Ka tri lloje të komshive: komshiu që ka një të drejtë, komshiu që ka dy të drejta, dhe komshiu që ka tri të drejta. Komshiu që ka tri të drejta është komshiu mysliman që është edhe farefis, prandaj ai ka të drejtën e komshiut, të drejtën e islamit dhe të drejtën e farefisnisë. Dy të drejta ka komshiu mysliman, të drejtën e komshiut dhe të drejtën e islamit. Kurse një të drejtë ka komshiu idhujtar.”²³⁹

Shih madhështinë e Islamit - si merren parasysh të drejtat e idhujtarit, vetëm pse është komshi! Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Sillu më së miri me komshiun, do të jesh mysliman.”²⁴⁰

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Xhebraili, më këshilloi rreth të drejtave të komshiut, sa që mendova se komshiu trashëgon komshiun.”²⁴¹

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit le ta nderojë komshiun (e vet).”²⁴²

²³⁹ Hadithin e shënojnë Hasan ibn Sufjan dhe Bezzari në *‘Musned’* e tyre, Ebu esh-Shejh në veprën e vet *‘Kitab’s-Sevab’*, si edhe Ebu Naim në veprën e vet *‘Hilje’*, përcjellë nga Xhabiri. Hadithin e shënon edhe Ibn Adijj, nga Abdullah ibn Omer r.a.

²⁴⁰ Tashmë e kemi përmendur këtë hadith.

²⁴¹ Buhariu dhe Muslimi nga Aisha r.anha dhe Ibn Omeri r.a.

²⁴² Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Shurejh.

Resulallahu s.a.v.s., tutje thotë:
“**Robi nuk do të besojë, derisa komshiu t’i jetë i sigurt nga e keqja e tij.**”²⁴³

Resulallahu s.a.v.s., thotë:
“**Kundërshtarët e parë në Ditën e Gjykimit, do të jenë komshitë.**”²⁴⁴

Resulallahu gjithashtu s.a.v.s. thotë:
“**Kur e gjuan me gur qenin e komshiut, ke bezdisë komshiun.**”²⁴⁵

Tregohet se një person erdhi te Ibn Mesudi r.a., dhe i tha:

- *Kam një komshi që më bezdisë, më ofendon dhe më maltreton.*” Ibn Mesudi i tha:

- *Shko, përmes teje ai bën gjynah ndaj Allahut, dhe përmes teje ai i bindet Allahut.*

I thanë Resulallahut s.a.v.s.:

- *Një grua agjëron ditën, rri pa gjumë natën, kurse i shqetëson komshitë.* Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:

- **Ajo është në xhehnem.**²⁴⁶

Një person erdhi te Resulallahu s.a.v.s., dhe iu ankua në komshiun e vet, e në këtë Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Ki durim.**

Më pas personi iu ankua edhe tri-katër herë, në çka Resulallahu u përgjigj:

- **Nxjerri moubilet tua në rrugë.**

²⁴³ Buhariu nga Ebu Shurejh.

²⁴⁴ Ahmedi dhe Taberani nga Akabe ibn Amir.

²⁴⁵ Burimi i hadithit nuk është gjetur.

²⁴⁶ Ahmedi dhe Hakimi nga Ebu Hurejre r.a., duke e vlerësuar si hadith me zinxhir të besueshëm të transmetuesve (*sahih*).

Personi i nxori mobiljet. Njerëzit që kalonin pranë mobiljeve të tij pyetnin se çfarë ka ndodhë. Do të thoshin:

- *Po e shqetëson komshiu.* Atëherë njerëzit filluan të mallkojnë komshiun që e shqetësonte personin. Komshiu që e shqetësonte, iu afrua personit dhe i tha:

- *Kthei mobiljet në shtëpi. Vallahi, kurrë më nuk do të të shqetësoj.*²⁴⁷

Zuhriu tregon se një person erdhi te Resulallahu s.a.v.s., dhe u ankua në komshiun e vet. Resulallahu s.a.v.s., urdhëroi që në dyert e xhamisë të shkruhet:

“Komshillëku përfshinë katërdhjetë shtëpi.” Zuhriu ka thënë:

- *Katërdhjetë këndeje, katërdhjetë andej, katërdhjetë në këtë anë, katërdhjetë në atë anë* – duke treguar në të katër anët.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Fatbardhësia dhe fatkeqësia gjenden te gruaja, banimi dhe kali. Fatbardhësia te gruaja është në masën e vogël të mehr-it (dhuratës martesore) të saj, në martesën e lumtur me të dhe në edukimin e saj të mirë. Fatkeqësia te gruaja është në masën e madhe të mehr-it të saj, në martesën e vështirë me të dhe në edukimin e saj të keq. Fatbardhësia në banim është në gjerësinë e shtëpisë dhe në marrëdhëniet e mira me komshitë. Fatkeqësia në banim është në shtëpinë e ngushtë dhe në marrëdhënie të këqija me komshitë. Fatbardhësia në kalin është nënshtrimi i tij dhe natyra e butë e tij, kurse fatkeqësia në kalin është në mos-nënshtrimin e tij dhe në natyrën e egër të tij.”²⁴⁸

²⁴⁷ Ebu Davudi, Ibn Hibbani dhe Hakimi, përcjellë nga Ebu Hurejre r.a., dhe e vlerësojnë si hadith me zinxhir të besueshëm të transmetuesve (*sahih*), sipas kushteve të Muslimit.

²⁴⁸ Muslimi, përcjellë nga Ibn Omeri r.a.

Dije se: nuk do të thotë që e drejta e komshiut mjafton vetëm në atë që mos t'i bëhet keq. Duhet të durohen edhe shqetësimet e tij. Edhe komshiu mundet mos të të shqetësojë; kjo nuk do të thotë që e zbaton të drejtën e komshillëkut. Bile nuk mjafton vetëm durimi i shqetësimit. Ndaj komshiut duhet sillur butë, e t'i bësh mirë. Ngase thuhet se komshiu i varfër, në Ditën e Gjykimit do të kap për zverku komshiun e tij të pasur dhe do të thotë: *'Rabbi im, pyete këtë, përse nuk më ndihmoi.'*

I shkoi lajmi Ibn Mukafeas, që komshiu i tij po e shet shtëpinë për shkak të borxhit që kishte. E Ibn Mukafea kishte shfrytëzuar hijen e asaj shtëpie. Për të paguar këtë të drejtë të komshiut ia ofroi shumë për shtëpi, dhe i tha: *"Mos e shit."*

Një person ankohej për shumë minj në shtëpi. Dikush i tha:

- *Përse nuk merr një mace?, e personi u përgjigj:*

- *Frikësohem se miu dëgjon zërin e maces, dhe ikë në shtëpinë e komshiut. Në atë rast do t'i dëshiroja komshiut atë që nuk ia dua vetes.*

Pra, obligimet ndaj komshiut shihen në atë që t'i japësh selam, të mos zgjatësh bisedën me të, të mos pyesësh shumë për gjendjen e tij, ta vizitosh kur është i sëmurë, ta ngushëllosh kur është në telashe. Të pikëllosh bashkë me të, të ndash kënaqësinë me të, të gëzohesh me të. Të mbyllësh sytë para gabimeve të tij, të mos e shikosh tinëz nga kulmi (tarraca), të mos i bësh telashe duke mbjellë rrënjë (lule) afër murit të tij. Të mos hedhësh asgjë në oborrin e tij, të mos i ngushtosh rrugën që çon në shtëpinë e tij. Të mos shikosh se çka fut në shtëpi. Të fshehësh turpin (intimen) e tij që e ke zbuluar, të kujdesesh vazhdimisht për shtëpinë e tij, nëse ai udhëton diku. Të mos dëgjosh tregime gjithfarë për të. Të ulësh shikimin, në shenjë respekti. Të mos e shikosh me sy të keq hyzmeqaren e tij, në bisedë të jesh i butë me fëmijët

e tij. Ta udhëzosh në gjërat që nuk i di, lidhur me besimin dhe dynjallëkun e tij. Këto janë shkurtimisht të gjitha obligimet që i kemi përmendur, e që kanë të bëjnë me përditshmërinë myslimane.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“A e dini çka është e drejta e komshiut? Nëse ai kërkon përkrahje nga ti, ti ta përkrahësh. Nëse kërkon ndihmë nga ti, ti ta ndihmosh. Nëse kërkon t’i huazosh diçka, ta bësh atë, e nëse varfërohet, t’ia falësh borxhin. Nëse sëmuret, ta vizitosh. Nëse vdes, t’i përcjellësh xhenazen. Nëse i ndodh diçka e mirë, ta urosh, e nëse i ndodh diçka e keqe, ta ngushëllosh. Mos ta ngritësh shtëpinë tënde mbi të tijën, e me këtë ta privosh nga fryrja e erës, përpos nëse ai të lejon. Mos ta shqetësosh. Nëse blenë pemë, ti dhurosh disa, e nëse nuk i dhuron, të mos tregosh se ke blerë, por tinëz t’ia hedhësh disa në shtëpi. Mos i lejo fëmijët e tu të dalin jashtë me pemë në dorë, që të mos lakmojnë fëmijët e tij. Mos e shqetëso me avull nga tenxherja jote, përveç nëse i jep edhe atij nga gjella.”

Më pas, Resulallahu s.a.v.s., tha:

“A e dini çka është e drejta e komshiut? Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, të drejtën e komshiut do ta plotësojë vetëm ai të cilin Allahu e mëshiron.”²⁴⁹

Muxhahidi tregon:

- *Isha te Abdullah ibn Omeri. Djali i tij po copëtonte një dele. Abdullahu i tha:*

- *Kur të përfundosh, fillo ndarjen nga komshiu ynë hebre. Këtë e përsëriti disa herë. Dikush i tha:*

- *Sa herë e thua këtë?, e ai u përgjigj:*

- *Resulallahu s.a.v.s., aq shumë na fliste për komshiun, sa që menduam se komshiu do të na trashëgojë pasurinë.²⁵⁰*

²⁴⁹ Haraiti në veprën *‘Mukarim-i Ahlak’*, dhe Ibn Adijj në veprën *‘El-Kamil.’*

Hishami ka thënë:

“Hasan Basriu nuk e shihte të keqe që të hahet kurhani me komshiun hebre dhe të krishterë.”

Ebu Dherri r.a., tregon:

‘Më porositi Pejgamberi im i dashur a.s. duke thënë:

- Kur zien në tenxhere, shto më shumë ujë. Më pas shih dikë nga komshitë, dhe jepu edhe atyre.”²⁵¹

Aisha r.anha tregon: *“Thash:*

- O Resulallah, i kam dy komshi. Njëri është afër derës time, e tjetri më larg, e nganjëherë nuk kam mundësi të ju jap të dyve. Cili ka më shumë të drejta?’ Pejgamberi a.s., m’u përgjigj:

- Ai që është më afër.”²⁵²

Ebu Bekër es-Siddik r.a., e pa të birin Abdurrahmanin se si me komshiun e vet grindej e i tha:

- Mos u grind me komshiun; të tjerët largohen, por ai qëndron këtu.

Hasan ibn Isa Nishaburi ka thënë: *‘E pyeta Abdullah ibn Mubarek:*

- Komshiu po më ankohet në djalin tim, se i ka bërë këtë e këtë, e djali im e mohon. Nuk do të doja ta dënoj, sepse ndoshta është i pafajshëm, por nuk do të doja as ta lë këtë punë, e ai të takohet prapë me komshiun. Çfarë të bëj?’ M’u përgjigj:

- Ndoshta djali yt flet fjalë të shëmtuara, prandaj duhet ta mësosh drejt dhe ta ruash nga kjo. Kur komshiu të ankohet në djalin tënd, jepi atij një mësim. Kështu, edhe do ta kënaqësh komshiun, edhe do ta mësosh djalin’.”

²⁵⁰ Ebu Davud dhe Tirmidhiu.

²⁵¹ Muslimi.

²⁵² Buhariu.

Ky paraqet një qasje të mençur për plotësimin e dy të drejtave, dy obligimeve.

Aisha r.anha ka thënë:

“Janë disa veti të mira – dikush i ka, e babai i tij jo; skllavi i ka e pronari i tij jo. Allahu Teala ia jep ato kujt të dojë: të folurit drejt, sinqeriteti me njerëzit, të japurit atij që kërkon, shpërblimi i punës, mbajtja e lidhjeve farefisnore, ruajtja e asaj që i besohet, sjellja e këndshme me shokun dhe komshitë, gostitja e mysafirëve – e bazë e të gjitha këtyre është turpi.”

Ebu Hurejre r.a., tregon: ‘Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

- O gra myslimane, komshikja mos ta ofendojë komshiken, bile as sa thundra e deles.”²⁵³

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Si fat i myslimanit llogaritet edhe shtëpia e gjerë, komshiu i mirë dhe karroca e rehatshme.”²⁵⁴

Abdullahu r.a., tregon: “Një person pyeti:

- O Resulallah s.a.v.s., si ta di kur kam vepruar mirë e kur kam gabuar? Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:

- Nëse i dëgjon komshitë tu të thonë ‘ke bërë mirë, atëherë dije që ke bërë mirë. E nëse dëgjon komshitë tu të thonë ‘ke bërë keq’, atëherë dije që ke bërë keq.”²⁵⁵

Xhabiri r.a., tregon: “Ka thënë Resulallahu s.a.v.s.:

- Çdokush që në shtëpi (ose bahçe) ka ortak - ose komshi, kur dëshiron ta shesë, mos ta shesë para se t’ia ofrojë atij së pari.”²⁵⁶

²⁵³ Buhariu.

²⁵⁴ Hadithin e shënon Ahmedî, përcjellë nga Nafi ibn Abdulharis dhe Sa’d ibn Ebu Vekkas r.a. Versionin të cilin e përcjellë Nafiu e shënon edhe Hakimi, duke e vlerësuar si transmetim me zinxhir të besueshëm të transmetuesve (*sahih*).

²⁵⁵ Hadithin e shënojnë Ahmedî dhe Taberani, fjala është për Abdullah ibn Mesud. Zinxhiri i transmetuesve është i mirë (*xhejjid*).

Ebu Hurejre r.a., tregon:
'Resulallahu s.a.v.s., ka gjykuar që komshiu mund të vendos pemë në murin e komshiut, pranoi ky apo jo.'

E vet Resulallahu s.a.v.s., thotë:
"Asnjëri nga ju të mos e pengojë komshiun që të vendos tra në murin tuaj."²⁵⁷

E Ebu Hurejre r.a., do të thoshte:
"Çka është kjo? Po shoh se nuk po respektoni këtë gjykim?! Vallahi, do ta vendos (traun) në mes të shtyllave tua." Bile, disa dijetarë këtë e kanë pranuar si rregull të obligueshëm (vaxhib).

Resulallahu s.a.v.s., thotë:
- **Kujt Allahu ia do të mirën, e ëmbëlson.** As'habët pyetën:
- *E çka do të thotë: 'E ëmbëlson'?* Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:
- **E bën të dashur për komshitë e tij.**²⁵⁸

²⁵⁶ Hadithin e shënon Hakimi, pa përmendje të fjalës 'komshi', dhe e cilëson si hadith me zinxhiri të besueshëm të transmetuesve (sahih). Hadithin e shënon edhe Haraiti, në veprën '**Mekarim-i Ahlak'** me tekst identik si këtu. Një transmetim e shënon edhe Ibn Maxhe, transmetuar nga Ibn Abbasi r.a: '*Kush ka tokë që dëshiron ta shesë, le t'ia ofrojë komshisë se vet.*' Personat që gjenden në senedin e këtij transmetimi janë të besueshëm (sahih).

²⁵⁷ Hadithin e shënon Haraiti në veprën '**Mekarim-i Ahlak'**, në këtë formë. Një hadith në këtë kuptim e shënojnë edhe Buhariu dhe Muslimi.

²⁵⁸ Hadithin e shënon Ahmedi, transmetuar nga Havlani. Hadithin e shënon edhe Haraiti në veprën '**Mekarim-i Ahlak'**, dhe Bejhekiu në veprën '**Zuhd'**, nga Amr ibn Hamik. Te Haraiti është shënuar: "*As'habët pyetën: 'E çka do të thotë – 'e ëmbëlson'?' Pejgamberi a.s., u përgjigj: 'Bën që komshitë ta duan.'*" Te Bejhekiu është shënuar: "*la hapë veprat e mira para vdekjes, deri sa me të të jenë*

OBLIGIMET NDAJ FAREFISIT DHE FAMILJES

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

Allahu Teala thotë: 'Unë jam er-Rahman (Mëshiruesi), dhe kjo është rahm, lidhjes së gjakut/lidhjes familjare i kam dhënë emrin nga Emri Im. Prandaj, kush mban marrëdhënie të mira me familjen, Unë do të mbaj marrëdhënie të mira me atë dhe do t'i pres marrëdhëniet me atë që i ndërpret marrëdhëniet me familjen.'²⁵⁹

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

"Kush gëzohet me jetë të gjatë dhe rritje të furnizimit, le t'i mbajë lidhjet familjare." Në transmetim tjetër thuhet:

"Kush dëshiron jetë të gjatë dhe rritje të furnizimit, le të ketë frikë Allahun dhe le t'i mbajë lidhjet familjare."²⁶⁰

Resulallahu s.a.v.s., është pyetur:

- *Kush janë njerëzit më të vlefshëm?* Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:

- **Ata që më së shumti i frikësohen Allahut, ata që më së shumti i mbajnë lidhjet familjare, ata që urdhërojnë të mirën, kurse ndalojnë të keqen.**²⁶¹

të kënaqur ata rreth tij." Zinxhiri i transmetuesve të këtij hadithi është i mirë (*xhejjid*).

²⁵⁹ Buhariu dhe Muslimi nga Aisha r.a.

²⁶⁰ Buhariu dhe Muslimi nga Enesi r.a., por pa fjalët: *"le t'i frikësohet Allahut."* Me këto fjalë hadithin e shënojnë Ahmedi dhe Hakimi, nga Alia r.a., me zinxhir të mirë të transmetuesve (*xhejjid*).

²⁶¹ Hadithin e shënojnë Ahmedi dhe Taberani, përcjellë nga Durra bint Ebu Leheb, me zinxhir të mirë të transmetuesve (*hasen*).

Ebu Dherri tregon:

“Më ka këshilluar shoku im Alejhisselam që të mbroj lidhjet familjare, edhe nëse familja e kthen shpinën, dhe të flas të vërtetën - edhe në qoftë se është e hidhët.”

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

Lidhja e gjakut është e varur në Arsh. Nuk llogaritet si mbajtje e lidhjeve dikush që vetëm kthen në masë të njëjtë, por mbajtës i lidhjeve është ai që, kur t’i ndërpritet lidhja, prapë e vendos.²⁶²

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Nënshtrimi i cili më së shpejti sjell sevap është mbajtja e lidhjeve familjare, qofshin familjarët edhe gjynahqarë. Pasuria do t’u shtohet, dhe numri i tyre do të rritet, nëse i mbajnë lidhjet familjare mes vete.”²⁶³

Zejd ibn Eslem ka thënë:

- *Kur Muhammedi a.s., e shpalli Pejgamberllëku në Mekë, doli një person dhe tha:*

- *Nëse do grua të mrekullueshme dhe deve kualitative, kërkoi te (fisi) Benu Mudlixh. Duke mos i dhënë rëndësi fjalëve të tij rreth gruas, dhe meqë për një gjë të tillë nuk është shpallur Pejgamberllëku, Resulallahu u përgjigj:*

- **Vërtet, Allahu më ka ndaluar të marr çka do qoftë nga Benu Mudlixhët, sepse ata kujdesen për lidhjet e tyre familjare.**²⁶⁴

²⁶² Taberani dhe Bejhekiu, përcjellë nga Abdullah ibn Omeri. Te Buhariu gjendet i shënuar pa fjalët: ‘Lidhja e gjakut është e varur në Arsh.’ Hadithin e shënon Muslimi, përcjellë nga Aisha r.a.

²⁶³ Ibn Hibban, përcjellë nga Ebu Bekr, Haraiti në veprën **‘Mekarim-i Ahlak’** dhe Bejhekiu në veprën **‘Shuabu’l-Iman’**, përcjellë nga Abdurrahman ibn Avfa.

²⁶⁴ Haraiti në veprën **‘Mekarim-i Ahlak’**. Hadithi është mursel, me zinxhir të besueshëm të transmetuesve.

Esma, e bija e Ebu Bekr r.a., ka thënë: “Erdhi nëna ime, e i thashë Resulallahut s.a.v.s.:

- ‘Ka ardhur nëna ime, e ajo është idhujtare, a duhet të mbajë lidhjet me të?’ Resulallahu s.a.v.s., m’u përgjigj:

- **Po, mbaji lidhjet me të.**” Në version tjetër thuhet:

- *A t’i jap dhurata? Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:*

- **Po, jepi dhurata.**²⁶⁵

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Dhënia e sadakasë për fukaranë llogaritet si një sadaka, e dhënia e sadakasë për familjarin, llogaritet si dy të tilla.”²⁶⁶

Kur Ebu Talha deshi ta japë si sadaka vreshtën e tij që e donte shumë, e kjo duke iu nënshtuar fjalëve:

“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani nga ajo që e doni.” (3-Al ‘Imran: 92),

i tha Resulallahut s.a.v.s.:

- *O Resulallah, kjo është në rrugë të Allahut, e për të varfrit dhe të pastrehët.* Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- **Allahu do të të shpërblejë. Ndaje atë me akraballëkun tënd.**²⁶⁷

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Sadakaja më e vlefshme është ajo që i jepet akrabave të cilët të kanë kthyer shpinën.”²⁶⁸

Ky hadith vjen në kuptimin e hadithit në vazhdim:

²⁶⁵ Buhariu dhe Muslimi (muttefekun alejhi).

²⁶⁶ Tirmidhiu, i cili e vlerëson si hadith me zinxhir të mirë të transmetuesve (hasen), si dhe Nesai dhe Ibn Maxhe, përcjellë nga Selman ibn Amir ed-Dibbi.

²⁶⁷ Buhariu. Tashmë e kemi përmendur.

²⁶⁸ Ahmedî dhe Taberani, përcjellë nga Ebu Ejjub. Në zinxhirin e transmetuesve gjendet edhe Haxhxhaxh ibn Erta. Hadithin e shënon edhe Bejhekiu, përcjellë nga Ummu Kulsum bint Atebi.

“Sadakaja më e vlefshme është kur e viziton atë që ty nuk të viziton, t’i japësh atij që nuk ka dashur të të japë ty, dhe të pajtohesh me atë që të ka bërë padrejtësi.”²⁶⁹

Tregohet se hazreti Omeri r.a., u kishte shkruar guvernatorëve të tij:

“Urdhëroni akrobatë të vizitojnë njëri-tjetrin, por mos të jenë komshi njëri me tjetrin.”

Sepse, mos-respektimi i obligimeve ndaj komshiut bëhet shkak për ndërprerjen e lidhjeve mes akrobave.

²⁶⁹ Ahmedi, përcjellë nga Muadh ibn Enesi dhe Taberani, përcjellë nga Ebu Umame, tashmë e kemi përmendur.

OBLIGIMET E PRINDËRVE DHE FËMIJËVE

Dihet mirë që ekzistojnë obligimet (të drejtat) ndaj prindërve. Kjo është një lidhje më e veçantë. E Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Fëmija nuk mund t’i paguaj hakun (mundimin) e prindit, përpos nëse prindi bëhet skllav, e fëmija e blen dhe çliron.”²⁷⁰

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Sjellja e mirë ndaj prindit është më e mirë se falja e namazit, ndarja e sadakasë, agjërimi, haxhi, umreja, dhe xhahadi në rrugë të Allahut.”²⁷¹

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Kush zgjohet nga gjumi, e prindërit e tij janë të kënaqur me të, për të hapen dy dyer në xhennet, e kush bie në gjumë, e prindërit e tij janë të kënaqur me të, për të hapen dy dyer në xhennet. E nëse ka vetëm një prind në jetë, atëherë vetëm një derë. Qoftë edhe nëse prindërit bëjnë dhunë, qoftë edhe nëse prindërit bëjnë dhunë, qoftë edhe nëse prindërit bëjnë dhunë. E kush zgjohet nga gjumi, e prindërit e tij janë të hidhëruar me të, do t’i hapen dy dyer në xhehenem, e nëse bie në gjumë, e prindërit e tij janë të hidhëruar me të, do t’i hapen dy dyer në xhehenem. Nëse ka vetëm një prind në jetë, atëherë vetëm një derë. Qoftë edhe nëse prindërit bëjnë dhunë, qoftë edhe nëse prindërit bëjnë dhunë, qoftë edhe nëse prindërit bëjnë dhunë.”²⁷²

²⁷⁰ Muslimi nga Ebu Hurejre.

²⁷¹ Ebu Ja’la dhe Taberani, në veprat *‘Sagir’* dhe *‘Evsat’*, përcjellë nga Enesi r.a., me zinxhir të mirë të transmetuesve (*hasen*).

²⁷² Bejhekiu në veprën *‘Shuabu’l-Iman.’*

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Aroma e xhennetit ndjehet në largësi prej pesëqind vite ecje, por atë aromë nuk do ta ndjejë ai që është i padëgjueshëm ndaj prindërve, as ai që ndërpre në lidhjet familjare.”²⁷³

Resulallahu s.a.v.s., thotë edhe këtë:

“Bëji mirë nënës tënde, më pas babait, më pas motrës, më pas vëllait, më pas atij që të është më i afërmi, e më pas tutje, varësisht prej afërsisë.”²⁷⁴

Transmetohet se Allahu Teala i tha Musasë a.s.:

“O Musa, kush i bën mirë prindërve, e ndaj Meje është i padëgjueshëm, do ta shënoj si vepërmirë. E kush bën mirë ndaj Meje, por është i padëgjueshëm ndaj prindërve, do ta shënoj si të padëgjueshëm.”

Thuhet se, kur Jakubi a.s., hyri te Jusufi a.s., Jusufi a.s. nuk u ngrit nga vendi. Atëherë iu shpall:

“A kështu je i lartësuar, që të mos ngritësh për babanë tënd? Pasha fuqinë Time dhe madhësitinë Time, nuk je. Nuk do të nxjerri nga kurrizi yt pejgamber!”

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kurdo që dikush nga ju dëshiron të jap sadaka, le ta bëjë nijet për prindërit e vet, nëse janë myslimanë, dhe shpërblimi për atë sadaka le t’u shkojë prindërve, e edhe ai do të ketë shpërblim aq sa kanë prindërit, e asgjë nuk do t’u merret prindërve nga shpërblimi.”²⁷⁵

²⁷³ Taberani në veprën **‘Sagir’**, përcjellë nga Ebu Hurejre r.a. Në veprën **‘Evsat’**, e përcjellë nga Xhabiri r.a., me atë që aty thuhet: **“...në largësi prej njëmijë vite ecje.”**

²⁷⁴ Nesai, përcjellë nga Tarik el-Muharibi, Ahmedi dhe Hakimi, përcjellë nga Ebu Remsa.

²⁷⁵ Taberani në veprën **‘Evsat’**, nga Amr ibn Shuaibi.

Malik ibn Rebi tregon: “Ishim me Resulallahun s.a.v.s., kur iu afrua një person nga fisi Benu Seleme dhe e pyeti:

- O Resulallah, a kam mundësi të bëj ndonjë të mirë për prindërit e mi, pas vdekjes së tyre? Pejgamberi a.s., u përgjigj:

- Po, bëj istigfar dhe dua për ta, zbato fjalët të tyre, ndero miqtë e tyre, vizito familjarët me të cilët je i lidhur përmes prindërve.”²⁷⁶

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Njëra ndër veprat më të mira është që, pas vdekjes së babait, personi të vizitojë njerëzit të cilët babai i tij i ka dashur.”²⁷⁷

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Shpërblimi i mirësisë ndaj nënës është i dyfishtë.”²⁷⁸

Gjithashtu, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

- **Duaja e nënës më së shpejti pranohet.**

Dikush tha: “Pse, o Resulallah?” e Pejgamberi a.s., u përgjigj:

- **Ajo është më e mëshirshme se babai, e duaja e të mëshirshmit nuk refuzohet.**

Dikush e pyeti Resulallahun s.a.v.s.:

- O i Dërguar i Allahut, kujt t’i bëj mirë? Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:

- **Prindërve tu.** Personi tha:

- *Nuk kam prindër.* Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Bëji mirë fëmijës tënd, sepse – siç ke obligim ndaj prindërve, ke obligim edhe ndaj fëmijës.**²⁷⁹

²⁷⁶ Ebu Davudi, Ibn Maxhe, Ibn Hibban dhe Hakimi. Ka zinxhir të besueshëm të transmetuesve (*sahih*).

²⁷⁷ Muslimi nga Ibn Omeri.

²⁷⁸ Versioni i këtillë i hadithit është mjaft i vetmuar, i pazakontë (*garib-xhiden*). Më herët kemi përmendur transmetimin nga Behz ibn Hakim dhe hazreti Ebu Hurejre, e ai hadith (ma’nen) është i ngjashëm me këtë transmetim.

“Allah, mëshiro prindin i cili i ndihmon fëmijës së vet që t’i bëjë mirë.”²⁸⁰

Resulallahu a.s.v.s., thotë:

“Dhurojuni baras fëmijëve tuaj.”

Dikush ka thënë: *“Fëmija yt është si aromë e këndshme deri shtatë vjet. Pas kësaj ai të bën hizmet për shtatë vjet, pra deri katërbëdhjetë vjet. Pas kësaj e ke ose armik ose ndihmës.”*

Enesi r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Të porsalindurit i prehet kurban në ditën e shtatë pas lindjes, më pas i caktohet emri, dhe largohet nga ai ajo çka i pengon. Kur t’i mbushë gjashtë vjet, edukohet. Kur t’i mbushë nëntë vjet, i ndahet shtrati. Kur t’i mbushë trembëdhjetë vjet, goditet nëse nuk e kryen namazin në kohë. Me gjashtëmbëdhjetë vjet, babai e marton. Më pas e merr për dore dhe i thotë: “Të kam rritur, të kam edukuar dhe të kam martuar. Strehohem te Allahu nga sherri (që mund të bësh) në dynjallëk, dhe nga dënimi yt (që mund ta kesh) në ahiret.”²⁸¹

Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Në të drejtat e fëmijës që ka te prindërit llogaritet edhe ajo që prindërit ta rrisin në mënyrën më të mirë dhe t’i japin emrin më të mirë.”²⁸²

²⁷⁹ Ebu Amr et-Tevkani, në veprën *‘Kitabu Muashereti’l- Ehlejn’*, përcjellë nga Osman b. Affani. Kjo është një pjesë e hadithit. Hadithin në tërësi e shënon Taberani, përcjellë nga Ibn Omeri.

²⁸⁰ Ebu Shejh ibn Hibban në veprën *‘Kitabu’s-Sevab’*, nga Alia dhe Ibn Omerit r.a.

²⁸¹ Ebu Shejh ibn Hibban në veprën *‘Kitabu’z-Zahaja ve’l-Akika’*.

²⁸² Bejhekiu në veprën *‘Shuabu’l-Iman’* nga Ibn Abbas r.a., dhe Aisha r.anha.

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

"Secili fëmijë i porsalindur është i lidhur me kurbanin e vet akika. Kurbanin prehet në ditën e shtatë, dhe i prehen flokët."²⁸³

Katade ka thënë:

'Kur e prenë kurbanin akika, merr pak lesh nga ai dhe vendose në kokë të fëmijës sikur mbi të të bjerë pak, si pe. Më pas laji kokën fëmijës, e pas kësaj prehen flokët.'

Një person erdhi te Abdullah ibn Mubarek, dhe iu ankua në fëmijën e vet. Ibn Mubarek e pyeti:

- *A e ke mallkuar? Personi u përgjigj:*
- *Po. Ibn Mubareku i tha:*
- *Ti ke shkatërruar ahlakun (moralin) e fëmijës.*

Është mustehab të jesh i butë ndaj fëmijës. Akre ibn Habis e pa Muhammedin a.s., si e puthë Hasanin (nipin e vet). I tha:

- *I kam dhjetë fëmijë, asnjërin nuk e kam puthur.*
Atëherë, Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- **Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet.**²⁸⁴

Aisha r.anha., tregon: "Një ditë, Resulallahu s.a.v.s., tha:

- **Laja fytyrën Usames.** (fytyra e Usames ishte me gjak) Fillova t'ia lajë fytyrën me padëshirë, e Resulallahu s.a.v.s., duke shtyer dorën time, e mori dhe ia pastroi fytyrën, e puthi fëmijën në kokë, dhe i tha:

- **Po të ishte Usame skllav, do ta bleja, dhe më pas do ta liroja** (Usame ishte fëmija i personit të cilin Resulallahu s.a.v.s., e donte)."

²⁸³ Hadithin e shënojnë autorët e '*Sunen*'. Tirmidhiu këtë hadith e vlerëson si hadith me zinxhir të besueshëm të transmetuesve (*hasen-sahih*).

²⁸⁴ Buhariu nga Ebu Hurejre r.a.

Hazreti Hasani u rrëzua, e Resulallahu s.a.v.s. ishte në minberin e tij. Zbriti nga minberi, e mori hazreti Hasanin në krahë, dhe e lexoi ajetin:

Pasuria dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë për ju (64-et-Tegabun: 15)²⁸⁵

Abdullah ibn Sheddad tregon: *“Një herë, me Resulallahun s.a.v.s., ishim duke falë namazin, e kur Resulallahu ishte në sexhde, erdhi hazreti Hasani dhe i hipi në qafë. Meqë të gjithë ishim në sexhde, askush nuk e pa këtë. Resulallahu s.a.v.s., e zgjati sexhden, e njerëzit menduan se, ndoshta, e ka humbur abdesin. Kur e përfundoi namazin, njerëzit e pyetën:*

- Përse e zgjate sexhden, o Resulallah? Menduam mos e ke prishur abdesin. Resulallahu s.a.v.s., u përgjigj:

- Biri im hipi mbi mua. Nuk desha ta ngus, le të përfundojë atë që deshi.²⁸⁶

Ka disa porosi të dobishme në këtë hadith. Njëra nga to ka të bëjë me afërsinë ndaj Allahut Teala. Njeriu është më së afërti Allahut kur është në sexhde. Hadithi thekson edhe dhembshurinë ndaj fëmijës, mirëbërjen, si edhe mësimet e Resulallahut s.a.v.s. për ummetin e tij. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Aroma e fëmijës është një nga aromat e xhennetit.”²⁸⁷

²⁸⁵ Hadithin e shënojnë autorët e ‘*Sunen*’, Ebu Davud, Tirmidhiu, Nesai dhe Bejhekiu, përcjellë nga Burejdi. Tirmidhiu hadithin e vlerëson si *hasen-garib*.

²⁸⁶ Hadithin e shënon Nisai, përcjellë nga Abdullah ibn Sheddad, i cili e përcjellë nga babai i tij, i cili thotë: *“Nuk jam shumë i sigurt, a ishte hazreti Hasani, apo hazreti Huseini.”* Hadithin e shënon edhe Hakimi, dhe e vlerëson si hadith me zinxhir të besueshëm të transmetuesve (sahih), me kushtet e Buhariut dhe Muslimit.

²⁸⁷ Taberani në veprat e tij ‘*Sagir*’ dhe ‘*Evsat*’, si edhe Ibn Hibban në veprën e tij ‘*Dhuafa*’, përcjellë nga Ibn Abbas r.a.

Ahnef ibn Kajsin ka thënë: *‘Fëmijët janë fryt i zemrave tona dhe mbështetje për shpinën tonë. E ne jemi për ta si tokë e përulur nën këmbët e tyre, bëhemi hije mbi kokën e tyre dhe për ta durojmë çdo vështirësi. Çka do që kërkojnë u japim, nëse zemërohen mundohemi t’i qetësojmë. Duhet të jemi të lumtur për dashurinë e tyre ndaj neve. Nuk duhet t’i ngarkojmë shumë që të mos largohen.’*

Të gjitha transmetimet e përmendura tregojnë rëndësinë e obligimeve ndaj prindërve, dhe mënyrën e plotësisimit të të drejtave të tyre. Tashmë ti e di çfarë kemi thënë për të drejtat e vëllazërisë (detyrat ndaj vëllazërisë). E kjo lidhje është edhe më e fortë se lidhja e vëllazërisë. Aq më shumë, është më e fortë në dy çështje. Së pari, edhe pse nuk i dëgjojmë ata në çështje që janë qartazi haram, shumë dijetarë thonë që dëgjueshmëria ndaj prindërve është domosdoshëmeri (vaxhib) edhe në situata të dyshimta. Bile, nëse ata nuk dëshirojnë që ti të hash ndamas por duan të hash bashkë me ta, edhe nëse ushqimi është i dyshimtë, është detyrë të hash me ta. Sepse ruajtja nga e dyshimta është gradë e lartë e devotshmërisë, por të përfitohet kënaqësija e prindërve është vaxhib. E dyta: nuk e ke të lejuar që pa lejen e prindërve të udhëtosh për punë/çështje që nuk janë as të ndaluara as të rekomanduara (mubah) ose që janë vullnetare (nafile), e edhe puna e haxhit është kështu, sa do që haxhi është farz, mund të shtyhet (për më vonë).²⁸⁸ Udhëtimi me qëllim të kërkimit të diturisë gjithashtu është nafile, përpos nëse kërkon diturinë që është farz, siç është mënyra e faljes së namazit ose mënyra e agjërimit, e që në qytetin tënd të mos ketë asnjë person që është kompetent të të mësoj këtë, në atë rast mund të udhëtosh dhe kjo nuk hyn në të drejtat e prindërve.

²⁸⁸ Ky është mendimi sipas med’ dhebit shafi.

Ebu Seid el-Hudri r.a., tregon:

- *Një person u largua nga Jemeni që të vinte te Pejgamberi a.s., dhe deshi të niset për xhihad. Resulallahu s.a.v.s., i tha:*

- **A ke prindër në Jemen?**

- *Kam, u përgjigj personi.*

- **A të kanë dhënë leje ata?**

- *Jo, tha personi. Në këtë, Resulallahu s.a.v.s., i tha:*

- **Kthehu atëherë te prindërit e tu, dhe kërko prej tyre leje. Nëse të lejojnë, shko në xhihad. E nëse nuk të lejojnë, bëju hyzmet aq sa mundesh, sepse pas tehvidit kjo është vepra më e mirë që ty të afron tek Allahu.**²⁸⁹

Një person tjetër erdhi te Resulallahu s.a.v.s., t'i thotë se dëshiron të marrë pjesë në luftë. Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- **A ke nënë?** Personi tha:

- *Kam, e Resulallahu s.a.v.s., i tha:*

- **Rri me të. Vërtetë, xhenneti është nën këmbët e saj.**²⁹⁰

Herën tjetër, përsëri, një person erdhi te Resulallahu s.a.v.s., që të bëjë hixhret. I tha Resulallahut s.a.v.s.:

- *Të erdha, dhe i lashë prindërit në vaj. Resulallahu s.a.v.s., i tha:*

- **Kthehu te ta, dhe bëji të buzëqeshur, ashtu siç i ke bërë me vaj.**²⁹¹

²⁸⁹ Ahmedi dhe Ibn Hibbani.

²⁹⁰ Nisai, Ibn Maxhe dhe Hakimi nga Muavi ibn Xhahimi. Hakimi thotë që ky hadith ka zinxhir të besueshëm të transmetuesve (*sahih*).

²⁹¹ Hadithin e shënon Ebu Davudi, Nesai, Ibn Maxhe dhe Hakimi, përcjellë nga Abdullah ibn Omerit r.a. Hakimi e vlerëson si hadith me zinxhir të besueshëm të transmetuesve (*sahih*).

Resulallahu a.s., thotë:

“Të drejtat e vëllait më të vjetër ndaj më të riut janë si të drejtat e prindërve ndaj fëmijës së tyre.”²⁹²

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kur dikush nga ju të ketë telashe me bagëtinë e vet, ose i bëhet vrazhdësi në sjellje nga gruaja, ose nga dikush nga familja e tij - le t'i këndohet ezani në vesh.”²⁹³

OBLIGIMET NDAJ SKLLAVIT

Për ata të cilët janë martuar, për detyrat e tyre, kemi folur në librin mbi rregullat e jetës martesore. E ata që janë në pronësi të dikujt, gjithashtu i kanë të drejtat e veta, respektimi i të cilave është gjithashtu obligim.

Një nga porositë e fundit të Resulallahut s.a.v.s., ka qenë:

“Keni frikë Allahun në lidhje me ata që janë pronë e juaja (skllavët). Ushqeni me atë çka vet hani. Vishni me atë çka vet vishni. Mos i ngarkoni me punë që nuk mund të kryejnë. Ata që i doni mbani, e ata që nuk i doni – shitni. Mos i mundoni krijesat e Allahut sepse Allahu ka bërë që ata të jenë pronë e juaja, e nëse Ai do, mund të bëjë që ju të jeni pronë e tyre.”²⁹⁴

²⁹² Hadithin e shënon Ebu esh-Shejh ibn Hibban, në veprën *‘Kitabu’s-Sevab’*, përcjellë nga Ebu Hurejre r.a.

²⁹³ Hadithin e shënon Ebu Mensur ed-Dejlemi në veprën e vet *‘Musned-i Firdevs’*, përcjellë nga hazreti Alia r.a.

²⁹⁴ Ky hadith është përmbledhje nga disa hadithe. Një pjesë nga Ebu Davudi dhe një pjesë nga Buhariu dhe Muslimi, përcjellë nga Ebu Dherri r.a.

Resulallahu s.a.v.s, thotë:

“Ushqimi dhe veshmbathja e duhur është e drejtë e skllavit. Mos të ngarkohet me punë që nuk mund të bartë.”²⁹⁵

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Në xhennet nuk do të hyjnë: mashtruesi tinëzar, personi që është arrogant, personi që tradhton, dhe ai që sillt keq me skllavët që i ka në pronë.”²⁹⁶

Abdullah ibn Omer r.a., tregon: *‘Një njeri erdhi te Muhammedi a.s., dhe i tha:*

*- O i Dërguar i Allahut, deri në çfarë mase t’i falë hyzmeqarit tim? Pejgamberi pak heshti në pyetje, e më pas tha: “ Çdo ditë falja gabimet nga shtatëdhjetë herë.”*²⁹⁷

Hazreti Omeri r.a., shkonte çdo të shtunë afër Medines, në një vend (të quajtur Avali) me vreshta dhe hurma. E kur takonte atje ndonjë skllav në punë të vështirë, i ndihmonte.

Tregon Ebu Hurejre r.a., që e ka parë një person në kali, e skllavi vraponte pas tij. Ebu Hurejre i tha:

- O rob i Allahut, ule pas teje, e ke vëlla. Shpirti i tij është si i yti. Dhe personi e uli.

Një skllave i tha Ebu Derdasë:

- Të kam helmuar para një viti, por asgjë nuk të ndodhi.”

Ebu Derdaja e pyeti:

- Pse e bëre atë? Skllavja u përgjigj:

- Për të shpëtuar nga ti. Në këtë, Ebu Derdaja i tha:

- Shko atëherë, je e lirë.

²⁹⁵ Hadithin e shënon Muslimi, përcjellë nga Ebu Hurejre r.a.

²⁹⁶ Hadithin në tërësi e përcjellë Ahmedi. Një pjesë të hadithit e përcjellë Tirmidhiu. Ibn Maxhe e përcjellë në version të shkurtuar, nga Ebu Bekri r.a.

²⁹⁷ Hadithin e shënojnë Ebu Davud dhe Tirmidhiu.

Duhri ka thënë:

- *Kur i thua skllavit: 'Allahu të vraftë!', skllavi fiton lirinë."*

Ahnef b. Kajsain e pyetën:

- *Prej kujt e mësove ahlakun e bukur? Ai u tha:*

- *Prej Kajs b. Asim-it. E pyetën:*

- *Si ishte ahlaku i tij?, e ai u tha:*

- *I kishin ardhur mysafirë. Kërkoi nga shërbëtori ta sjell mishin që piqej në oxhak. Duke nxituar, shërbëtori kapi hekurin e nxehtë me mish dhe e rrëzoi mbi kokën e të birit të Kajsit dhe fëmija vdiq. Natyrisht që shërbëtori u frikësua shumë, e ai i tha:*

- *Nuk e mbyte me qëllim. Të liroj, tani je i lirë!*

Avn ibn Abdullah r.a., kur skllavi kryengritej, do të thoshte:

- *Sa i ngjashëm je me zotërinë tënd. Zotëria yt i kryengritet Rabbit të tij, e ti i kryengritesh zotërisë tënd.*

Një herë, shërbëtori e zemëroi. Avni tha:

- *Dëshiron të të godas! Por unë nuk do të godas. Tani shko, je i lirë!*

Mejmun ibn Mihranit i kishte ardhur një mysafir. Kërkoi nga shërbëtorja (skllavja) të sjell gjellë urgjent. E shërbëtorja, duke bartë gjellën në atë ngutje, mori në thua dhe e derdhi gjellën mbi Mejmuni. Mejmuni i tha:

- *Çfarë bëre, më dogje! Shërbëtorja tha:*

- *O mësoes i mirësisë, edukator i njerëzve, kujto atë që ka thënë Allahu Teala. Mejmuni pyeti:*

- *E çfarë ka thënë Allahu Teala?' Shërbëtorja tha:*

- *Allahu Teala kështu thotë:*

... e mposhtin zemërimin (3-Al 'Imran: 134)

Mejmuni tha:

- *E mposhta zemërimin. Shërbëtorja përsëri citoi:*

... dhe ua falin fajet njerëzve (3-Al 'Imran: 134)

Mejmuni tha:

- *Të kam falur. Shërbëtorja më pas tha:*

- *Shtojë (të mirën), sepse Allahu Teala ka thënë:*

...Allahu i do bamirësit. (3-Al 'Imran: 134)

Atëherë Mejmuni tha:

- *Atëherë edhe unë si bamirësi për Allahun, po të liroj.*

Ibn Munkedir tregon:

- *Një nga as'habët e Resulallahut s.a.v.s., filloi të rrahë skllavin e vet. Skllavi bërtiti:*

- *Pashë Allahun, pashë Allahun mos!, por, as'habi nuk deshë të dëgjojë, dhe aq e rrahu sa që Resulallahu s.a.v.s., dëgjoi zërin e skllavit, dhe shkoi te ai. Kur as'habi e pa Resulallahun s.a.v.s., e nderpreu rrahjen. Resulallahu s.a.v.s., tha:*

- Të luste në Emër të Allahut, e ti nuk deshe t'ia falësh gabimin, e kur më pe mua, e ndale dorën.

Personi, duke u penduar për atë që e bëri, tha:

- *Është i lirë, o Resulallah. Atëherë Resulallahu s.a.v.s., tha:*

- Po të mos kishe vepruar kështu, fytyrën do ta digjte Zjarri."²⁹⁸

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

"Kur skllavi sillet ndershëm me zotërinë e tij, dhe në mënyrën më të mirë e kryen ibadetin e vet, i ka dy shpërblime."²⁹⁹

Kur Ebu Rafi fitoi lirinë, qau, dhe tha:

- *I kisha dy shpërblime. Tash e humba njërin.'*

²⁹⁸ Ibn Mubarek në veprën '**Zuhd**', si hadith mursal. Versionin tjetër e shënon Muslimi, nga Ibn Mesudi.

²⁹⁹ Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Omeri.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Më janë treguar tre të parët që do të hyjnë në xhennet, dhe tre të parët që do të hyjnë në xhehnenem.

Sa u përket atyre që do të hyjnë në xhennet, të parët janë: shehidi, skllavi që e ka kryer bukur ibadetin e vet dhe është sjellë ndershëm me pronarin e tij, dhe njeriu i varfër por i ndershëm e familjar.

Kurse tre të parët që do të hyjnë në xhehnenem janë udhëheqësi zullumqar, pasaniku që nuk jep zeqatin, dhe fukaraja arrogant.”³⁰⁰

Ebu Mesud Ensari r.a., tregonte:

- *Një herë e godita skllavin tim. Dëgjova një zë pas meje:*

- *Ta dish, o Ebu Mesud!, dy herë. U ktheva, e pashë*

Resulallahun s.a.v.s., dhe e hodha kamxhikun nga dora. Resulallahu tha:

- **Vallahi, Allahu është më i fuqishëm ndaj teje, se ti ndaj këtij.”³⁰¹**

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Kur dikush nga ju merr hyzmeqar, së pari le ta ushqejë me ëmbëlsirë; sepse ajo për te bëhet kënaqësi.”³⁰²

Ebu Hurejre r.a., tregon: *“Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:*

“Kur dikujt nga ju shërbëtori t’i sjellë ushqimin, le ta ulë dhe le të hajë me të, e nëse këtë nuk e bën, së paku le t’i japë një pjesë.”³⁰³

³⁰⁰ Tirmidhiu, i cili e vlerëson si hadith me zinxhir të mirë të transmetuesve (hasen), dhe Ibn Hibban, nga Ebu Hurejre.

³⁰¹ Muslimi.

³⁰² Taberani në veprën *‘Evsat’*, dhe Haraiti, në veprën *‘Mekarim-i Ahlak’*.

³⁰³ Buhariu dhe Muslimi, me fjalë të ndryshme. Hadithin e shënon edhe Haraiti në veprën *‘Mekarim-i Ahlak’*, në këtë version.

Kurse në versionin tjetër:

“Kur dikujt nga ju shërbëtori i vet t’ia përgadisë ushqimin, le t’ia përgatisë të nxehtë dhe të butë. Më pas le ta ftojë dhe të ulet, e të hanë bashkë. E nëse këtë nuk e bën, le t’i japë një pjesë, ose le të merr një copë, ta ngjyey, (më pas bëri me dorë), le t’ia vendosë në gojë të shërbëtorit e t’i thotë: ‘haje këtë’.”

Një person erdhi te Selmani Farisi r.a., dhe e pa duke përzier brumë.

- *Çfarë është kjo, Ebu Abdullah?, pyeti personi. Selmani u përgjigj:*

- *E dërguam shërbëtorin të kryej një punë, e nuk do të donim ta ngarkojmë me dy obligime.*

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush ka një robëreshë, e mbron dhe sillet me të më së miri, e më pas i jep lirinë dhe e marton, do të ketë dy shpërblime.”³⁰⁴

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Secili prej jush është çoban, dhe secili do të pyetet për kopenë e vet.”³⁰⁵

Thënë saktësisht lidhur me të drejtat e skllavit, pronari duhet të hajë me ta dhe t’i veshë me atë që edhe vet veshë. Nuk guxon t’i ngarkojë me atë që nuk mund ta bartin. Nuk duhet të jetë mendjemadh dhe i pamëshirshëm ndaj tyre. Gabimet e tyre duhet falur. Kur të zemërohet, duhet kujtuar gabimet dhe gjynahet e veta karshi urdhrave të Allahut Teala. Nuk duhet kërkuar nënshtrim të tepërt. Duhet gjithmonë ditur që fuqia e Allahut është përmbi fuqisë së tij.

³⁰⁴ Buhariu dhe Muslimi, nga Ebu Musa.

³⁰⁵ Buhariu dhe Muslimi, nga Ibn Omeri.

Fedale ibn Ubejd tregon që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Për tre persona nuk pyetet: për atë që ndahet nga xhemati, për atë që kryengritet ndaj udhëheqësit të vet - e nëse këta vdesin si të tillë, gjendja e tyre është e tmerrshme. Për këta mos pyet. E as për gruan që burri i është larguar dhe i ka lënë mjaft furnizim, e ajo zbukurohet për dikë tjetër; as për të mos pyet. As për tre të tjerë mos pyet: për personin që e mban veten madhështor, personin që dyshon në Allahun, dhe personin që ka humbur shpresën në mëshirën e Allahut.”³⁰⁶

³⁰⁶ Taberani, si dhe Hakimi, i cili e vlerëson si hadith me zinxhir të besueshëm të transmetuesve (sahih).